

1 E mërkurë, 6 shtator 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 09.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare,  
7 mund të thërrisni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
9 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim  
10 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi  
12 të gjithëve.

13 Do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit 04408. Vërej  
14 për procesverbal që të akuzuarit janë të pranishëm fizikisht  
15 në sallën e gjyqit, me përjashtim të z. Krasniqi i cili na  
16 ndjek me videolidhje.

17 Asistente mund të sillni dëshmitarin. Për procesverbal,  
18 dua të them që do të jemi në seancë publike.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
22 mirëmëngjesi.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
25 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve

1 qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje mos  
2 hezitoni t'i kërkonit avokatit ta përsërisë ose palëve ta  
3 përsërisin, ose thjesht thoni që nuk e kuptoni dhe do ta  
4 sqarojnë. Gjithashtu na thoni cila është baza e njohurisë suaj  
5 lidhur me faktet dhe rrethanat për të cilat do të jepni  
6 përgjigje. Ju rikujtoj se jeni ende nën detyrimin për të thënë  
7 të vërtetën, siç e thatë vetë në deklaratën solemne.

8 Gjithashtu fol afër mikrofonit, prit 5 sekonda para se të  
9 japësh përgjigjen dhe fol ngadalë edhe për përkthyesit.

10 Nëse ke nevojë për pushime na njofto dhe të plotësojmë  
11 kërkesën.

12 Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga ana e ZPS-së.

13 Prokuror, fjala është për ju.

14 Z. TIEGER: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

15 DËSHMITARI: W04408 [Vijon]

16 Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit

17 Pyetje nga z. Tieger: [Vazhdim]

18 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitari.

19 PË. Mirëmëngjesi.

20 PY. Siç diskutuam edhe dje, sapo i shpjegoje Trupi Gjykses  
21 lidhur me mbërritjen e z. Thaçi dhe z. Limaj në takimin në  
22 Banjë dhe nga kjo pikë dua të filloj. A të kujtohet çfarë  
23 kishin veshur?

24 PË. Me uniforma ishin të dy. Ishte uniformë kamuflazhi, fiks,  
25 fiks nuk më kujtohet, por ishte një lloj kamuflazhi.

1 PY. Pasi u prezantuan, të thanë kush ishin ose emrat ose  
2 nofkat, ju dhe z. Bouckaert u prezantuat dhe u shpjeguat atyre  
3 se kush ishit?

4 PË. Po. Këtë bëmë edhe ne. U prezantuan ne si persona edhe  
5 pastaj prezantuar edhe organizatën Human Rights Watch.

6 PY. A e shpjeguat natyrën e punës së Human Rights Watch në  
7 Kosovë?

8 PË. Po, e bëmë. Ne punonim në Kosovë, kishim, domethënë,  
9 filluar punën në Kosovë qysh prej viteve '90 edhe sigurisht  
10 nga shkurti, pra, që prej ngjarjeve të shkurtit dhe marsit në  
11 '99-n e intensifikuar punën tonë edhe ua thamë këtë gjë; ua  
12 prezantuar punën tonë, me pak fjalë.

13 PY. A u shpjeguat më konkretisht se Human Rights Watch dhe ju  
14 dhe z. Bouckaert po monitoronit shkeljet e të drejtës  
15 ndërkombëtare në Kosovë?

16 PË. Po. Ua shpjeguar mandatin tonë; u thamë që jemi një  
17 organizatë ndërkombëtare Human Rights Watch për të monitoruar  
18 sesi zbatoheshin ligjet e luftës.

19 PY. A u thatë atyre që kjo vlente për të dyja palët në  
20 konflikt?

21 PË. Po, ua thamë.

22 PY. Z. Thaçi dhe Z. Limaj, a të thanë nëse e njihni në  
23 përgjithësi punën e Human Rights Watch?

24 PË. Po, e njihnin në përgjithësi punën tonë.

25 PY. A e ngritët çështjen e ndalimit të të dy gazetarëve

1 "Tanjug" të Tanjug-ut?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe si reagoi z. Thaçi apo z. Limaj, çfarë thanë ata?

4 PË. Më duhet të them që kur filloi biseda ne po flisnim për  
5 punën tonë që dokumentonim dhe mënyrën si i dokumentonim  
6 shkeljet që i kryenin serbët, forcat serbe dhe jugosllave dhe  
7 ua shpjeguem. Edhe u dhamë edhe disa hollësi edhe pastaj  
8 biseda u shtri edhe tek mandati ynë dhe kur thamë se si i  
9 monitoronim të gjitha palët e përfshira në konflikt. Dhe në  
10 këtë kontekst ngritëm edhe çështjen e dy gazetarëve të Tanjug-  
11 ut, që me sa kishim kuptuar ne ishin ndaluar dhe u kërkuan  
12 informacion për çështjen e tyre.

13 PY. Ju thanë gjë, çfarë, si reagues dhe çfarë ju thanë kur  
14 kërkuan informacion për çështjen?

15 PË. Na thanë se këta dy persona janë gjykuar dhe janë  
16 shpallur fajtorë; po vuanin dënimin. Pra, edhe se do të  
17 liroheshin pasi të përfundonin dënimin, pasi të kishin  
18 përfunduar vuajtjen e dënimit.

19 PY. Pasi të shpjeguan dhe të thanë që ka qenë një gjyq dhe  
20 janë dënuar këta gazetarët, ju bëtë pyetje shtesë? A u kërkuar  
21 më shumë hollësi lidhur me këtë?

22 PË. Po. U kërkuan informacion për gjyqin në vetvete,  
23 veçanërisht merakun yni ishte lidhur me çështjet në qoftë se  
24 procesi kishte qenë i rregullt. Për shembull, dy të akuzuarit  
25 a patën avokat, që ta kishin zgjedhur vetë; a ishin të

1 pranishëm gjatë procesit; a patën të drejtën ta apelonin  
2 vendimin?

3 PY. Dhe çfarë tha z. Thaçi dhe z. Limaj lidhur me këtë?

4 PË. Na thanë që jo nuk patën avokat të pranishëm. Në qoftë se  
5 më kujtohet saktë, thanë që ju ishte lejuar ta kërkonin një  
6 ose të paktën ishin përpjekur të gjenin një, por s'kishte  
7 ardhur asnjë avokat dhe se nuk ishin të pranishëm gjatë  
8 procesit ligjor, procesit gjyqësor.

9 PY. Ju personalisht e pyetët nëse mund t'i shihnit të  
10 ndaluarit?

11 PË. Po, u kërkuam leje që të vizitonim të ndaluarit.

12 PY. Dhe çfarë ju tha z. Thaçi dhe z. Limaj?

13 PË. Kërkesa jonë u refuzua.

14 PY. A ju dhanë arsye?

15 PË. Nuk më kujtohet saktë. Nuk më kujtohet në fakt, në qoftë  
16 se na dhanë një arsye, por nuk na lejuan.

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të më  
18 jepni leje t'i tregoj dëshmitarit një pjesë të deklaratës së  
19 mëparshme që ka dhënë për t'i rifreskuar kujtesën?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
21 çaktivizuar]

22 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Dëshmitar, dua të tërheq vëmendjen tuaj dhe të shohim  
24 paragrafin 93 të deklaratës që i keni dhënë Zyrës së  
25 Prokurorit në 2019 dhe 2020, veçanërisht paragrafin 93, pjesa

1 ku thuhet, citoj:

2 "I pyetëm nëse mund t'i vizitonim të ndaluarit, por  
3 kërkesa na u refuzua për shkak të 'sekretit ushtarak'".

4 Dëshmitar, a ju rifreskon kjo kujtesën sa i takon  
5 përgjigjes që keni marrë nga z. Thaçi dhe z. Limaj lidhur me  
6 kërkesën tuaj për të parë të ndaluarit?

7 PË. Po, më rifreskoi kujtesën. Ka qenë edhe një kërkesë  
8 tjetër dhe mbase i ngatërrova këto të dyja [e pakuptueshme] me  
9 njëra-tjetrën, sepse ata e përmendën kodin e etikës dhe ne i  
10 kërkuam ta shihnim këtë dokument dhe nuk na u lejua. Besoj kjo  
11 ndodhi mbase për shkak të sekretit ushtarak. Por sa i takon të  
12 ndaluarve, me sa më kujtohet mua, dhe bazuar në deklaratën  
13 time, dhe nuk kam asnjë arsye për të thënë që deklarata ime  
14 s'ka qenë e saktë asokohe.

15 PY. Sapo na thatë çfarë ju kishte thënë z. Thaçi dhe z. Limaj  
16 kur e kërkuat që të merrnit më shumë hollësi lidhur me  
17 procesin gjyqësor gjatë të cilit u dënua të ndaluarit. Edhe  
18 përgjigja e tyre ishte që nuk pati avokat dhe nuk kanë qenë të  
19 pranishëm në atë të ashtuquajtur gjyq.

20 Po ju, si reaguat ndaj këtij informacion; si reaguat ju  
21 për faktin që nuk kishte avokat dhe që s'kishin qenë të  
22 pranishëm?

23 PË. Në fakt, po. Kolegu dhe unë dhe kolegu dhamë mendimin  
24 tonë bazuar në informacionin që kishim marrë, ky proces nuk e  
25 përmbushte standardet e një procesi të rregullt ligjor, të

1 paktën standardet ndërkombëtare për një proces të rregullt  
2 ligjor.

3 PY. A i thatë ndonjë gjë lidhur me atë që duhet të ndodhte në  
4 të ardhmen, duke pasur parasysh faktin që procesi nuk kishte  
5 qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare?

6 PË. Po, u thamë që besojmë që dy gazetarët duhen liruar.

7 PY. Pasi i thatë z. Thaçi dhe z. Limaj që ndalimi nuk ishte  
8 në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe se duheshin  
9 liruar, ata çfarë thanë, nëse thanë ndonjë gjë?

10 PË. Nuk e pranuan. Nuk më kujtohet saktë se çfarë thanë; nuk  
11 thanë që nuk pajtohem; nuk më kujtohet saktë. Mbase thanë do  
12 ta shqyrtojmë këtë çështje, por me vlerësimin tonë nuk u  
13 pajtuan.

14 PY. A ju thanë nëse ishin ata në pozicion të lironin, të  
15 ndaluar apo jo; ju thanë diçka të tillë?

16 PË. Po. Ata thanë, kjo është çështje e gjyqësorit që është i  
17 pavarur dhe që nuk ishin ata personat e duhur që të ndërhyjnë  
18 në proceset ligjore, gjyqësore, se kjo do të dëmtonte  
19 autoritetin edhe besueshmërinë e institucionit të UÇK-së.

20 PY. A bënë ndonjë, a e përmendën ata, bënë ndonjë dallim ata  
21 mes kompetencave ushtarake dhe civile sa i takon proceseve  
22 ligjore?

23 PË. Ata thanë që çdo përpjekje e jona për të ndërhyrë do të  
24 cenonte autoritetin gjyqësor civil. Me sa më kujtohet ky ka  
25 qenë koment.

1 PY. Nëse e kuptova siç duhet përgjigjen tuaj, ju po thoni se  
2 ata ju thanë se nuk deshën të ndërhyjnë e nuk do të ndërhyjnë,  
3 sepse ishte çështje e gjyqësorit?

4 PË. Po këtu më --

5 PY. A të kujtohet nëse thanë ndonjë gjë lidhur me statusin e  
6 sistemin juridik të UÇK-së apo zhvillimin, apo me strukturat?

7 PË. E diskutuam këtë në gjerësi me sa kuptoj, me sa mbaj  
8 mend. Na shpjeguan që UÇK-ja ka qenë, ishte duke i krijuar  
9 institucionet e gjyqësorit. Më duket se thanë që është një  
10 ushtri e re e cila po punonte në kushte të vështira dhe se  
11 ishin duke i ndërtuar, duke i ngritur strukturat që të paktën  
12 e kuptova se e kishin fjalën për gjykata, për prokurori dhe  
13 institucione të tjera, mekanizma të tjera të fushës së  
14 gjyqësorit.

15 PY. Më herët thatë që gjatë pjesës së, kur u prezantuat në  
16 takim ju u thatë që HR - Human Rights Watch - ishte e  
17 përfshirë në monitorimin e shkeljeve të pretenduara të së  
18 drejtës ndërkombëtare nga të dyja palët. Gjatë takimit, a  
19 diskutuat për pretendime të tjera lidhur me shkeljen e të  
20 drejtave të njeriut nga UÇK-ja, përveç, përveç rastit të  
21 gazetarëve?

22 PË. Po. Filloi biseda me dy gazetarët, sepse ky rast ishte  
23 bërë goxha publik dhe kishte tërhequr shumë vëmendje; i  
24 shprehëm edhe shqetësimet tona lidhur me shkeljet e tjera që  
25 pretendohej se ishin kryer nga UÇK-ja, përfshirë ngacmime,



1 frikësime edhe pretendime për vrasje. Dhe iu rikujtuam  
2 detyrimin që kishin përkundrejt të drejtës ndërkombëtare në  
3 këtë fushë.  
4 PY. Si reagues?  
5 PË. Fillimisht u angazhuan gojarisht. Thanë që shumë qartë që  
6 UÇK-ja respekton Konventën e Gjenevës dhe se e kuptonin  
7 përgjegjësinë dhe detyrimin e tyre. Dhe po ashtu thanë që po  
8 në luftë ka dhe probleme, që në fakt besoj se, besoj se është  
9 e vërtetë, kështu ndodh e nuk e diskutoj fare këtë gjë, nuk e  
10 vë në diskutim këtë gjë. Dhe as nuk e vura në diskutim në atë  
11 kohë diçka të tillë. Po çështje shtrohej si trajtohen  
12 probleme, a hetohen, a disiplinohen njerëzit? Këto janë  
13 treguesit kryesorë që ne fokusohemi apo që ne kërkojmë si një  
14 organizatë për të drejtat e njeriut.  
15 PY. Procedurat, a u përmend, u përmend gjë çështja e  
16 proceseve disiplinore apo masave disiplinore dhe nëse po,  
17 çfarë ju thanë?  
18 PË. Po, na thanë që kemi kodin e sjelljes. Pra, kishin kodin  
19 e etikës apo të sjelljes për pjesëtarët e vet. U kërkuan që ta  
20 shihnim kodin, por nuk na e dhanë.  
21 PY. U kërkuan ndonjë shembull konkret të ndonjë rasti kur ata  
22 mund të kishin marrë masa disiplinore?  
23 PË. Kjo është një pyetje krejt normale që ne e bëjmë në  
24 situata të tilla. Në çdo situatë konflikti. Ne kërkojmë  
25 shembuj. Pra, nëse një qeveri apo grup i armatosur na thotë

1 që, pjesëtarët e forcova tona janë hetuar, janë disiplinuar ne  
2 u kërkojmë të na japin shembuj dhe kështu bëmë edhe në atë  
3 rast. Sepse na thanë, në fakt, që kishin disiplinuar persona;  
4 na u bë qejfi që e dëgjuam, e vlerësuam diçka të tillë, por  
5 gjithashtu ne nuk do kryenim siç duhet punën tonë në qoftë se  
6 do e merrnim për të mirëqenë diçka të tillë, prandaj ne u  
7 kërkuam shembuj.

8 PY. A jua dhanë ndonjë shembull?

9 PË. Jo, nuk na dhanë.

10 Z. TIEGER: [Përkthim] A mund të kërkoj të shfaqet në  
11 ekran materiali IT-03-66 P212.8.

12 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë dokument?

13 PË. E njoh.

14 PY. Çfarë është?

15 PË. Është një letër që e kam shkruar unë, ia kam drejtuar tre  
16 pjesëtarëve të UÇK-së pas takimit. Është një procedurë  
17 standarde për Human Rights Watch, së pari, për t'u thënë  
18 faleminderit për angazhimin tuaj dhe për të theksuar pikat  
19 kryesore edhe për të dhënë rekomandime të mëtejshme që kishim,  
20 por gjithashtu në përgjithësi për të vazhduar angazhimin.

21 PY. Kam disa pyetje lidhur me këtë. Fillimisht, në krye të  
22 letrës shohim treguesi 2, pastaj 3, pra, i është drejtuar  
23 Përfaqësuesit Politik të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare  
24 të Kosovës, pastaj Drejtorisë Politike të Shtabit të  
25 Përgjithshëm dhe pastaj Drejtorisë Juridike të Shtabit të

1 Përgjithshëm. Drejtuar këtyre.

2 Kush i mbante këto poste; kush ishin, pra, kujt i  
3 korrespondonin këto poste?

4 PË. I pari ishte Adem Demaçi, i dyti z. Hashim Thaçi dhe i  
5 treti z. Fatmir Limaj.

6 PY. Ku i morët vesh ju, si i mësuat ju këto tituj pozicioni?

7 PË. Z. Demaçi ishte përfaqësues publik, njihej publikisht,  
8 ishte i vendosur në Prishtinë. E diskutuam këtë edhe dje. Z.  
9 Thaçi dhe z. Limaj u prezantuan vetë. Kur i takuam na u  
10 prezantuan më 10 nëntor. Sigurisht që z. Limaj përdori nofkën.

11 PY. Që të jemi të qartë, kur u prezantuan, u prezantuan edhe  
12 me pozicionin që kishin edhe ishte pozicioni që shfaqet në  
13 këtë letër, pra, pozicioni që, rolin që kishin?

14 PË. Po, kështu u prezantuan.

15 PY. Thatë që letra pjesërisht synonte të theksonte disa  
16 aspekte të takimit që kishit pasur, ndërsa në paragrafin e 3-  
17 të thuhet se:

18 "Jemi të shqetësuar për dy gazetarët që nuk ishin të  
19 pranishëm gjatë gjykimit të tyre dhe se askush nuk ka pas  
20 mundësi t'i vizitojë gjatë ndalimit".

21 A janë këto dy pika që diskutuat në takim. Pra, këto janë  
22 gjëra që ju thanë në takim dhe të cilat ju më pas i pasqyruat  
23 në këtë letër?

24 PË. Po, kështu është.

25 PY. Po ashtu thuhet diku në mes të paragrafit që jemi në

1 dijeni që strukturat gjyqësore të UÇK-së janë duke u ngritur,  
2 duke u krijuar.

3 Këtë informacion, po ashtu e morët gjatë takimit?

4 PË. Po, kështu.

5 PY. Te paragrafi i fundit thotë, "Të vijojnë diskutimet sa i  
6 takon kodit të etikës së UÇK-së". A bëhet fjalë këtu për atë  
7 kodin e UÇK-së që përmendët, që e diskutuat gjatë takimit?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe në paragrafin e fundit, paragrafin e katërt [Sipas  
10 përkthimit] thuhet që "shpresojmë që të ndaluarit e tjetër të  
11 kenë mundësi të marrin vizitorë nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar  
12 (KKN) edhe organizatat e tjera për të drejtat e njeriut edhe  
13 organizata humanitare".

14 A u tha kjo pjesërisht, se lidhje me kërkesën që bëtë ju  
15 për të parë të ndaluarit, prandaj e thatë këtë gjë?

16 PË. Po, dhe dua të shtoj diçka shkurtimisht. Në atë kohë,  
17 besoj se ka qenë nëntorit i '98-s, Komiteti Ndërkombëtar i  
18 Kryqit të Kuq kishte folur publikisht për faktin që nuk u  
19 lejohej ose iu ishte kufizuar kontakti me të ndaluarit e UÇK-  
20 së. Për ne ishte diçka që duhej shqyrtuar ose duke e parë më  
21 tej. Duke para parasysh vështirësitë që ka kryqi i kuq edhe  
22 sigurisht që ata përgjithësisht mundohen të ruajnë  
23 konfidencialitetin e punë së tyre. Prandaj fakti që ata  
24 vendosën të flisnin publikisht lidhur me këtë çështje ne na  
25 tërhoqi shumë vëmendjen.

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
2 pranohet dokumenti si provë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
4 çaktivizuar]

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiale IT-  
9 03-66 P212.8 pranohet dhe do të marrë numrin e provës  
10 materiale.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
12 merr numrin e provës materiale P376.

13 Z. TIEGER: [Përkthim] A mund të vendosim tani në ekran  
14 materialin IT-03-66 P2012.4?

15 PY. Dëshmitar, dua t'ju pyes në qoftë se ka pasur takime të  
16 tjera në muajt e ardhshëm. Veçanërisht duam të shohim faqet  
17 00676493 dhe 00676494 në dokument që është raport i Human  
18 Rights Watch, Republika e Jugosllavisë, Ndalimet dhe Abuzimet  
19 në Kosovë.

20 Së pari, para se të shkojmë te faqja konkrete, dua t'ju  
21 pyes a e njihni raportin?

22 PË. Po, unë kam qenë hulumtuesi kryesor edhe autori kryesor i  
23 këtij raporti.

24 PY. Është dhjetor i '98-s, atëherë ka dalë?

25 PË. Po.

1 PY. Nëse shkojmë në fund të faqes, është faqja 24 në kopjen  
2 fizike të dokumentit, thuhet se "

3 "Në 18 tetor, Nebojsa Radosevic, një gazetar për një  
4 agjenci shtetërore "Tanjug" dhe Vladimir Dobricic, fotograf i  
5 Tanjug-ut humbën diku afër fshatit të Magurës. UÇK-ja më pas  
6 konfirmoi se ata ishin nën ndalimin e UÇK-së dhe po  
7 përballeshin me akuza si spiunë. Në fillim të nëntorit dy  
8 gazetarët u dënuan me 60 ditë në burgun numër 7 të UÇK-së pas  
9 një gjykimi që bazuar në vetë informacionet e UÇK-së nuk  
10 kishte përmbushur standardet ndërkombëtare për një proces të  
11 rregull ligjor. Ndonëse përfaqësuesit e Shtabit të  
12 Përgjithshëm të UÇK-së, pjesëtarët e Drejtorisë Politike dhe  
13 Gjyqësore i thanë Human Rights Watch se gjyqi ishte i drejtë  
14 dhe se të pandehurit nuk ishin keqtrajtuar; ata pranuan se të  
15 pandehurit në fakt nuk kishin pasur përfaqësim ligjor dhe se  
16 nuk kishin qenë të pranishëm në gjyqin e tyre. Kërkesa e Human  
17 Rights Watch për të vizituar të ndaluarit u refuzua për arsye  
18 të 'sekretit ushtarak'".

19 Vazhdojmë me paragrafin tjetër që përshkruhet lirimi i  
20 tyre. Dhe thuhet që dy aktivistë politikë nga LDK-ja, nga  
21 Malisheva, Jakup Kastrati dhe Cen Desku dhe pastaj vazhdohet  
22 në paragrafin e fundit, dhe thuhet që:

23 "Që dy gazetarët, të cilët mendohet që të jenë kidnapuar  
24 nga UÇK-ja akoma nuk dihet se ku janë".

25 Pra, është një person, Djuro Slavic, edhe shoferi i tij,

1 Ranko Perinic.

2 Dëshmitar, pjesa e këtij raporti e cila ka të bëjë me dy  
3 përfaqësuesit e Shtabit të UÇK-së, dy personat të cilët folët  
4 për ju, për procesin gjyqësor dhe që thanë që personat e  
5 ndaluar nuk kishin qenë të pranishëm dhe nuk kishin pasur  
6 përfaqësim ligjor ose avokat. A e keni pasur fjalën këtu për  
7 takimin që keni organizuar me datë 10 nëntor, për këtë e  
8 kishit fjalën kur përshkruat këtë gjë?

9 PË. Po.

10 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja që  
11 kjo faqe të pranohet në provë materiale.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
13 çaktivizuar]

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Për këto faqe nuk kemi kundërshtime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
16 çaktivizuar]

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim sa i takon  
18 përmbajtjes, thelbit, por shqetësimi im është se Prokuroria  
19 vazhdon që të bëjë të njëjtën gjë që ka bërë edhe më përpara.  
20 Dhe ndërkohë i lexon pjesët, paragrafët ashtu siç i lexoi edhe  
21 kësaj radhe.

22 E kemi dëgjuar Prokurorinë që në mënyrë të vazhdueshme  
23 kundërshton Mbrojtjen kur kërkon pranimin e dokumenteve në  
24 prova materiale gjatë kundërpjeteve. Thjesht, domethënë, po e  
25 them si parapri, por dua të them që kur ne bëjmë të njëjtën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Tieger (Vazhdim)

Faqe 16

1 gjë ka kundërshtim nga ZPS-ja.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Përderisa nuk ka kundërshtim do kërkoj që prova IT-03-66

4 P212.4 pranohet në provë materiale; faqet 00676493 dhe faqja

5 00676494.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës

7 këto faqe do të marrin numrin e provës materiale P376.

8 Të nderuar Gjykatës, nuk e di në qoftë se mund të më

9 konfirmoni klasifikimin, sepse në versionin në anglisht, në

10 sistemin e gjykatës *Legal Workflow*, klasifikimi është si

11 konfidencial. Duhet të vazhdojmë ta mbajmë si konfidencial apo

12 siç është në versionin në shqip që është publik?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

14 çaktivizuar]

15 Z. TIEGER: [Përkthim] Besoj se po, të nderuar Gjykatës

16 për klasifikimin e dokumenteve si publike?

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull

19 atëherë,

20 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja këshillohen]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Prova materiale duhet

22 të marrë numrin P377.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Vazhdoni më tej, Prokuror.

25 Z. TIEGER: [Përkthim]



1 PY. Dokumenti që sapo pamë bashkë i referohet dënimit me 60  
2 ditë ndalim në burgun numër 7 të UÇK-së.

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Lidhur me këtë pikë dua që të  
4 paraqitet në ekran prova materiale U003-8645 deri në U003-  
5 8645.

6 PY. Dëshmitar, ky është një dokument që ka titullin "Rebelët  
7 kosovarë lëshojnë një deklaratë mbi gazetarët e burgosur  
8 serbë". Data që mban dokumenti është 1 nëntor 1998. Dhe thotë  
9 që:

10 "Gjykata Ushtarake e Drejtorisë së Shtabit të

11 Përgjithshëm të UÇK-së deklaron në komunikatën e vet që:

12 "'Mbështetur në aktakuzën e ngritur nga gjykata merret ky  
13 vendim i Gjykatës Ushtarake:

14 "'Pra, në përputhje me normat e punës së saj në gjykimin  
15 e kryer kundër të pandehurve merret vendimi...".

16 Dhe drejt fundit të raportit jepet vendimi kundër dy  
17 gazetarëve të Tanjug-ut, të cilët "akuzohen për shkelje dhe  
18 mungesë respekti të rregullave të brendshme dhe ushtarake të  
19 UÇK-së...".

20 Më pas thuhet që:

21 "Të pandehurit dënohen secili me 60 ditë burgim dhe të  
22 pandehurit do të transferohen në burgun numër 7. Ata kanë të  
23 drejtë apelimi..." e vazhdon më tej.

24 "'Dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë", thuhet më poshtë.

25 Dëshmitar, së pari, dua t'ju pyes në qoftë se ju kujtohet

1 a e keni parë këtë dokument atëherë apo jo, në atë kohë ose ta  
2 them ndryshe pyetjen: këtë dokument e kishit parë përpara se  
3 të takoheshit me z. Thaçi dhe z. Limaj në Banjë?

4 PË. Nuk më kujtohet ta kem parë këtë dokument më herët, pra,  
5 përpara takimit. Nuk besoj se e kemi parë, sepse po ta kishim  
6 parë do të kisha pasur shumë gjasa që të kishit bërë pyetje më  
7 të hollësishme mbështetur në informacionin që jepet në këtë  
8 dokument.

9 PY. A e keni parë dokumentin përpara sesa të përgatisnit  
10 pjesët apo paragrafët që ju lexova pak më përpara që kanë të  
11 bëjnë me raportin mbi këtë takim e organizuar?

12 PË. Nuk jam shumë i sigurt. Më kujtohet që kam parë  
13 komunikatën lidhur me lirimimin e gazetarëve më 27 nëntor, por  
14 nuk më kujtohet ta kem parë ndonjëherë këtë dokument. Përsëri,  
15 ndoshta në raportet tona publike ka shumë të ngjarë që të  
16 ishim referuar, le të themi elementëve konkretë që jepen këtu,  
17 për shembull, akuzave konkretet me të cilat ngarkoheshin këta  
18 dëshmitar. Megjithatë, siç e thashë nuk besoj se do ta kem  
19 parë përpara botimit.

20 PY. Informacionin a është në të njëjtin drejtim, në të  
21 njëjtin linjë me pozicionin, me qëndrimin e UÇK-së në atë  
22 takim?

23 PË. Po.

24 Z. TIEGER: [Përkthim] Atëherë kërkoj pranimin e këtij  
25 dokumenti në provë materiale.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
2 çaktivizuar]

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
7 U003-8645 deri në dokumentin U003-8645, pranohet në provë  
8 materiale.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
10 të marrë numrin e provës materiale P378.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. TIEGER: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, z. Thaçi ka folur gjithashtu lidhur me takimin  
14 e nëntorit 1998. Dëshiroj t'ju pyes disa gjëra lidhur me  
15 gjërat që ka thënë ose nuk ka thënë z. Thaçi lidhur me këtë  
16 takim.

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Kështu që për këtë qëllim dëshiroj  
18 që të paraqitet në ekran dokumenti 076563-TR-AT faqja 1 e  
19 Pjesës 14.

20 PY. Z. Thaçi pyetet lidhur me takimin. Citoj:

21 "A ju pyeti z. Abrahams në qoftë se gazetarët serbë  
22 kishin kaluar në një proces ligjor ose proces gjyqësor?"

23 "PË. Nuk më kujtohet, por UÇK-ja nuk ka pasur ndonjë  
24 mekanizëm të procesit gjyqësor. Kjo nuk ka pas ndonjë proces  
25 gjyqi apo ndonjë proces juridik. Pra, nuk ka pasur UÇK-ja as

1 proces juridik, mekanizëm juridik dhe as gjyq”.

2 Pyetja ime është kjo: A ju ka thënë z. Thaçi apo z. Limaj  
3 që UÇK-ja nuk ka pas as proces juridik as mekanizëm juridik e  
4 as gjyq?

5 PË. Ata na thanë që ishin në procesin e ndërtimit të këtyre  
6 mekanizmave.

7 PY. Pastaj bëhet pyetja pasuese për z. Thaçi.

8 “Pra, me sa dini ju, nuk ka pasur një proces gjyqësor që  
9 përfshinin z. Radosevic dhe z. Dobricic?

10 “PË. Të vetmet gjyqe që kanë qenë në Kosovë...”.

11 Ju kërkojmë ndjesë, të kalojmë në faqen tjetër, është  
12 faqja e dytë e të njëjtit dokument.

13 “PY. Pra, ju nuk keni informacion sa i takon procesit  
14 gjyqësor që përfshinte z. Radosevic dhe z. Dobricic?”.

15 “PË. Të vetmet gjyqe që kanë qenë në Kosovë kanë qenë të  
16 Sllobodan Millosheviqit dhe nuk ka pas të tjera”.

17 Dëshmitar, z. Thaçi apo z. Limaj a ju kanë thënë që nuk  
18 ka pasur një proces gjyqësor që përfshinte z. Radosevic dhe z.  
19 Dobricic, nuk ka pasur faqe asnjë lloj procesi gjyqësor, jua  
20 ka thënë këtë gjë?

21 PË. Siç pasqyrohet në raportet tona publike ata kanë thënë që  
22 këta dy persona kishin kaluar në proces gjyqësor.

23 PY. Nga fundi i faqes dhe vazhdojmë te faqja 3, pyetja që i  
24 bëhet z. Thaçi është:

25 “Me sa ju kujtohet a keni diskutuar me z. Abrahams në

1 goftë se ishin dënuar dy gazetarët?”.

2 “PË. Nuk më kujtohet; nuk më kujtohet, sepse unë as nuk  
3 kam pas dijeni që ata kanë qenë ndaluar. Aq më pak kanë qenë  
4 për ta është marrë një vendim dënimi. Nuk ka pasur proces  
5 gjyqësor. I vetmi proces gjyqësor që ekzistonte asokohe ka  
6 qenë ai kundër Millosheviqit”.

7 Dëshmitar, a ju ka thënë z. Thaçi në atë kohë se ai nuk e  
8 dinte fare nëse ishin ndaluar apo jo dy gazetarët?

9 PË. Jo. Ata të dy konfirmuan që dy gazetarët ishin të  
10 ndaluar.

11 Z. TIEGER: [Përkthim] Do kërkoja tani të paraqitej prova  
12 materiale K022-5096 deri në K022-5119.

13 PY. Dëshmitar, ky është një dokument që mban emrin e Human  
14 Rights Watch. Titulli është “Abuzimet kundër serbëve dhe  
15 romëve në Kosovën e re”. Data është gusht 1999. A e njeh këtë  
16 dokument?

17 PË. Po, e njoh.

18 PY. Çfarë është ky dokument?

19 PË. Është një raport publik i Human Rights Watch i nxjerrë në  
20 gusht të vitit 1999, mbështetur në hulumtime dhe hetime në  
21 Kosovë pas datës 12 qershor të atij viti.

22 PY. [Mikrofoni çaktivizuar] Dëshmitar, e ke luajtur ti  
23 ndonjëherë rol në shkrimin e këtij materiali?

24 PË. Po, kam pasur rol. Nuk kam qenë autori kryesor por kam  
25 luajtur edhe unë rolin tim.

1 PY. A mund të na përshkruani shkurtimisht se çfarë temash  
2 përfshinte raporti, me çfarë merrej raporti?

3 PË. Po. Ishte raport që përfshinte gamën e shkeljeve të cilat  
4 shënjestronin serbët etnikë dhe popullsinë rome. Pra,  
5 popullsinë që nuk ishin shqiptarë në Kosovë. Pas fundit të  
6 luftimeve dhe pas mbërritjes në Kosovë të forcave  
7 ndërkombëtare, të forcave të NATO-s në Kosovë më datë 12  
8 qershor.

9 PY. A përfshin ky raport pjesë të caktuara lidhur me vrasjet  
10 dhe grabitjet, kidnapimet, abuzimet e romëve dhe të serbëve të  
11 cilët dërgoheshin në pika ndalimi nga UÇK-ja?

12 PË. Po, mbulon raste të cilat janë mbështetur në hulumtime të  
13 zgjeruara. Kolegët e mi dhe unë vetë kemi shkuar dhe vizituar  
14 shumë vendndodhje, kemi investuar shumë njerëz, kemi biseduar  
15 me ta lidhur me rastet e tyre të kërcënimeve, dhunës fizike,  
16 plaçkitjeve dhe dëbimeve të jo të shqiptarëve, por të pakicave  
17 të tjera në Kosovë.

18 PY. Raporti a bëri rekomandime apo tha ndonjë gjë se çfarë  
19 duhet të bënte UÇK-ja duke pasur parasysh rrethanat?

20 PË. Po, më duhet që të shikoj pjesën e rekomandimeve në  
21 mënyrë që të jem i saktë dhe konkret. Megjithatë, në  
22 përgjithësi ne konstatuam se shkeljet e asaj kohe arrinin një  
23 nivel që kërkonin vëmendje të menjëhershme nga institucionet e  
24 Kosovës së asaj kohe. Domethënë nga qeveria e përkohshme e  
25 asaj kohe apo nga strukturat e UÇK-së të cilat ende ishin të

1 pranishme ose në aspektin formal ose joformal. Pra, ishte e  
2 nevojshme nga këto institucione që të merrnin hapa për të  
3 ndaluar për t'i dhënë fund këtij modeli të gjerë, do thoja  
4 unë, të abuzimeve ose të shkeljeve.

5 PY. A ju dhatë palëve të ndryshme atyre që ishin në  
6 udhëheqësi kopje të këtij raporti?

7 PË. Po.

8 PY. A patët mundësi që të takoheshit me dikë lidhur me këtë  
9 raport?

10 PË. Po. Jam takuar me drejtuesin e qeverisë së përkohshme në  
11 atë kohë në mënyrë që t'i jepja një kopje të raportit.

12 PY. Kush ishte ky person?

13 PË. Ky person ishte z. Hashim Thaçi.

14 PY. A i dhatë z. Thaçi një kopje të këtij raporti?

15 PË. Po.

16 PY. Ku ka ndodhur ky takim?

17 PË. Takimi ka ndodhur në zyrën e tij; zyra e tij ndodhej në  
18 qendër të Prishtinës. Ishte takim ndërmjet ne të dyve; vetëm  
19 ne të dy ishim në takim. Sigurisht që ishte hera e parë që ne  
20 takoheshim pas përfundimit të konfliktit. E njihnin njëri-  
21 tjetrin, sepse ishim takuar në këtë takim që diskutuam më  
22 herët dhe unë ngrita shqetësimet tona lidhur me situatën. Në  
23 atë kohë kishte dhjetëra mijëra serbë të cilët ishin larguar  
24 nga Kosova. Dhe në raport dokumentoheshin shkelje, duke  
25 përfshirë këtu edhe vrasje, persona të zhdukur. Pra,

1 përfshinte informacion për këto çështje dhe këto janë pika të  
2 cilat unë i ngrita gjatë takimit me shpreson që ato do të  
3 trajtoheshin më pas.

4 PY. Në çfarë gjuhe u zhvillua takimi?

5 PË. Në gjuhën shqipe.

6 PY. A i shpjeguat z. Thaçi se për çfarë fliste raporti, çfarë  
7 përmbante raporti?

8 PË. Po. Ja përshkrova raportin në pika të gjëra. Nuk është se  
9 u futëm në rast pas rasti, por ngrita me të shqetësimet  
10 kryesore dhe i bëra me dije konstatimet kryesore dhe  
11 përfundimet e raportit që këta abuzime ishin mjaftueshmërisht  
12 të vazhdueshme dhe të rënda që kërkonin veprim të  
13 menjëhershëm.

14 PY. Çfarë ju tha z. Thaçi në përgjigje të shqetësimeve të  
15 ngritura?

16 PË. Ai e pranoi se kishte probleme. Sigurisht që kishte  
17 dhjetëra mijëra serbë që ishin larguar, ndoshta edhe më tepër  
18 në atë pikë kohe. Kështu që nuk mund të mohohet diçka e tillë.  
19 Kishte pasur edhe incidente të dhunshme; sulme të dhunshme të  
20 cilat z. Thaçi i kishte dënuar publikisht disa prej këtyre  
21 sulmeve; vrasje besoj të fermerëve të bujqve serbë në korrik,  
22 në mos gabohem. Ai e pranoi se po ndodhnin krime. Mospajtimi  
23 ose të paktën pika që unë nuk pajtohesha me vlerësimin e tij  
24 ishte që këto ishin veprime të individëve, të personave të  
25 izoluar. Dhe me fjalën të tjera që çdokush mund të vishte



1 uniformën e UÇK-së edhe të kryente krime në emër të UÇK-së.  
2 Edhe se kjo po ndodhte dhe që nuk kishte një politikë të  
3 koordinuar të bashkërenduar për të kryer apo për të mbështetur  
4 një sjellje të tillë kriminale.

5 PY. Po mundohem ta kuptoj pak çfarë thatë tani së fundi. A e  
6 pranoi ai se anëtarët e UÇK-së i kishin kryer këto krime apo  
7 si e kuptuat ju përgjigjen që ju dha ai? E pranoi apo nuk e  
8 pranoi që pjesëtarët e UÇK-së ishin të përfshirë në krime, në  
9 këto lloj krimesh?

10 PË. Mënyra sesi e kuptoj unë ishte se ai i kundërshtonte këto  
11 pretendime edhe thoshte që ishin krime të kryera nga persona  
12 të izoluar, përfshirë edhe persona që maskoheshin me uniformën  
13 e UÇK-së.

14 PY. A mund t'ju pyes shkurtimisht lidhur me këtë pikë. Me aq  
15 sa dini ju, a ishte e saktë se njerëz mund të blinin uniforma,  
16 mund të merrnin uniforma ose distinktiv të UÇK-së?

17 PË. Po, pa diskutim.

18 PY. A kishte faktorë që në rrethanat që njerëzit me gjasa  
19 mund të merrnin uniforma të UÇK-së, mund të kryenin krime --?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] E kundërshtojmë këtë pyetje. Nuk ka  
21 bazë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
23 kundërshtimi.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë nuk kisha pikë dyshimi në atë  
25 kohë dhe besoj edhe sot e kësaj dite se një individ nëse donte

1 mund të merrte një uniformë të UÇK-së, e gjente një uniformë  
2 të UÇK-së ose thjesht kishte një mund të merrte një distinktiv  
3 mund ta vendoste që të mund të tregonte që ai ishte anëtar i  
4 UÇK-së. Dhe besoj se është e vërtetë që ka pasur raste kur  
5 krimet janë kryer nga individë nga personat të caktuar që  
6 kishin gjet uniforma diku dhe që pretendonin se ishin  
7 luftëtarë të UÇK-së, por në fakt nuk ishin.

8 Në të njëjtën kohë nuk e besoja atëherë dhe nuk e besoj  
9 as sot --

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo është absolutisht opinion. Thotë  
11 që nuk e besoj as atëherë, nuk e besoj as sot.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai ka dhënë  
13 bazë të mjaftueshme për të dhënë opinionet e veta duke  
14 përfshirë këtu hulumtimet, konsultimet, përvojat, intervistat  
15 etj. E rrëzojmë kundërshtimin.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë nuk e besoj mbështetur në  
17 hulumtimet tona kryesore, intervistimin e viktimave, të  
18 dëshmitarëve të këtyre incidenteve dhe krimeve, se shpjegimi i  
19 individëve që vishnin uniforma rastësisht, pra, uniforma të  
20 UÇK-së ishte i saktë apo që ishte përshkrues i situatës në  
21 tërësinë e vet. Pra, në të gjithë situatën. Ndërkohë që mund  
22 të kishte raste apo incidente të tilla madhësia e incidenteve  
23 të tilla ose modeli i përsëritur i këtyre incidenteve,  
24 vazhdimësia e raporteve që merrnin në mënyrë të drejtpërdrejtë  
25 nga viktimat e shkeljeve të tilla, neve të paktën na tregonte

1 dhe të paktën mua më krijonin përshtypjen që kishte më shumë  
2 sesa kaq. Nuk ishte e gjithë historia kaq. Nuk mund të bëhej  
3 fjalë vetëm për persona të caktuar.

4 Më lejoni të shtoj, nëse mundem, se asokohe UÇK-ja kishte  
5 shumë reputacion, kishte shumë fuqi në Kosovë. Ata kishin,  
6 pra, kishin luftuar, disa prej tyre kishin vuajtur shumë,  
7 kishin vdekur; ata konsideroheshin me shumë respekt nga shumë  
8 vetë në Kosovë. Pra, shiheshin nga shumë vetë si çlirimtarë të  
9 Kosovës dhe mendoj se do ishte e pazgjuar në atë kohë për  
10 individë të caktuar që të hiqeshin sikur ishin ushtarë të UÇK-  
11 së në masë të madhe. Megjithëse mund të kishte raste  
12 sporadike, sepse një gjë e tillë nuk do të tolerohej, nuk do  
13 të pranohej nga persona që vërtetë i kishin veshur ato  
14 uniforma dhe e kishin ekspozuar veten ndaj një rreziku kaq të  
15 madh kundër armikut serb.

16 Unë nuk e mendoja atëherë që kjo shpjegonte gjithë  
17 situatën plotësisht, ky shpjegimi i marrë.

18 Z. TIEGER: [Përkthim]

19 PY. Pas takimit, Dëshmitar, z. Thaçi a ju, a u angazhua me ju  
20 sa i takon, a patët kontakte të vazhdueshme të tjera sa i  
21 takon konstatimeve ose rekomandimeve?

22 PË. Jo. Ne kishim këtë takim dhe unë i dhashë raportin dhe  
23 takimi u bë në mirëbesim në interes të informimit dhe  
24 inkurajimit dhe të respektimin të mëtejshëm të politikave për  
25 të drejtat e njeriut, respektimin e të drejtave të njeriut. Ne

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Tieger (Vazhdim)

Faqe 28

1 nga ana jonë kërkonim që të merreshin masa. Edhe pse në një  
2 takim të tillë, ti nuk pret që të ketë rezultate të prekshme  
3 të menjëhershme, unë nuk mora ndonjë angazhim, nuk m'u tha që,  
4 "Po, do i shikojmë këto çështje dhe do japim një përgjigje  
5 dikur". E vërteta është që kjo nuk ndodhi asnjëherë. Unë nuk u  
6 kontaktova më asnjëherë nga qeverisja e përkohshme ose nga  
7 dikush tjetër për të thënë që le t'i shohim këto çështje.  
8 Raste njëri pas tjetrit shohim rekomandimet të diskutojmë me  
9 njëri-tjetrin se si mund të trajtohen këto probleme, si mund  
10 të gjendet një zgjidhje.

11 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që  
12 raporti të pranohet në provë materiale.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
14 çaktivizuar]

15 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dëgjova  
17 që të ketë kundërshtime. Dokumenti K022-5096 deri në K0022  
18 deri në 5110 pranohet në provë materiale.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
20 merr numrin e provës materiale P379.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. TIEGER: [Përkthim] A mund të kërkoj që të paraqitet në  
23 ekran prova materiale IT-05-87.1 P00741.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është pranuar  
25 në provë materiale kjo?

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk besoj. Është referenca e numrit  
2 të provës materiale një çështje të mëhershme.

3 Z. TIEGER: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar e keni parë më herët këtë raport edhe a keni  
5 marrë pjesë në shkrimin e këtij raporti.

6 PË. Po. Kam qenë hulumtuesi kryesor dhe shkruesi kryesor i  
7 këtij raporti.

8 PY. Në qoftë se do shohim faqen K0364789, që duhet të jetë  
9 pasqyra e lëndës, a përmban raporti një pjesë për shkeljen e  
10 rregullave të luftës nga UÇK-ja?

11 PË. Po. Pjesa kryesore e këtij raporti, pjesa dërrmuese e  
12 këtij raporti përfshin shkelje të rënda të ligjeve të luftës  
13 nga forcat serbe dhe jugosllave. Ka edhe një kapitull të  
14 dedikuar për UÇK-në që është kapitulli 10.

15 PY. Për të qenë i qartë, kjo pjesë, domethënë, mbështetet në  
16 burime parësore ose dytësore?

17 PË. Kjo pjesë e raportit mbështetet më shumë dhe kryesisht në  
18 burime dytësore.

19 PY. U bindët që konstatimet ishin të mjaftueshme për të  
20 paraqitur këto publike në raport.

21 PË. Po, dhe mund të shpjegoj metodologjinë dhe arsyetimin, në  
22 qoftë se kjo mund të ndihmojë Gjykatën.

23 PY. Më lejoni të përfundoj me pyetjet fillestare pastaj e  
24 shohim në qoftë se është e nevojshme kjo gjë. Vazhdoni  
25 ndoshta, jepni sqarimet apo shpjegimit që deshët të jepnit.

1 PË. Sigurisht. Atëherë kurdo që ishte e mundur ne përpiqeshim  
2 të hetonim burimet e dorës së parë, dëshmitarë, viktima dhe  
3 kështu me radhë. Në këtë rast, për sa u përket shkeljeve të  
4 UÇK-së, kjo ka qenë e vështirë të bëhet për një sërë arsyesh.  
5 Arsyeya kryesore ishte siguria edhe fakti i thjeshtë, thjesht  
6 që t'i afroshim një individ për sa u përket këtyre  
7 shkeljeve. Ishte shumë e ndjeshme, kjo nuk është vetëm për  
8 Kosovën. E shohim sot edhe në luftën në Ukrainë ku jam i  
9 përfshirë personalisht.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kundërshtim. Është shumë  
11 interesante, me shumë respekt që po dëgjojmë për  
12 metodologjinë, por konkretisht për sa i përket pjesës të cilën  
13 z. Tieger po e përmend, në këtë raport që është thjesht  
14 referencë e përsëritur, përsëritet. Ajo që duhet të  
15 përcaktojmë do të vërtetojmë fillimisht nga dëshmitari është  
16 nga kanë ardhë këto informacione lidhur me UÇK-në, që janë  
17 publikuar pastaj në raport. Dhe përgjigja është një organizatë  
18 tjetër ndërkombëtare.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
20 çaktivizuar]

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po. Kundërshtimi lidhur me  
22 pyetjet, pyetja që është pyetur, që u parashtrua është sesi  
23 janë përpiluar informacionet dhe përgjigje [e pakuptueshme].

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i jap  
25 mundësinë Prokurorisë që të bëjë pyetje siç do, sepse nuk

1 është radha juaj për të bërë pyetje; nuk është dëshmitari  
2 juaj.

3 Vazhdoni, z. Prokuror.

4 Z. TIEGER: [Përkthim]

5 PY. Z. Dëshmitar, ndoshta mund të shkojmë me pyetjen e  
6 radhës: A u përpoqët t'u jepnit burimet e informacioneve mbi  
7 të cilat kjo pjesë e raportit është bazuar me qëllim që  
8 lexuesit t'i shohin bazën dhe kufizimet vetë?

9 PË. Po, më lejoni të shpjegoj dhe jam në mospajtim të plotë  
10 me për kufizimin apo [e pakuptueshme] referencë që përsëritet  
11 nga të tjerët.

12 Në këtë rast burimet tona ishin si në vijim: organizata  
13 ndërkombëtare të besueshme qoftë joqeveritare siç është Qendra  
14 Juridike Ndërkombëtare, Amnesty International, janë deklarata,  
15 për shembull, nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Përmenda që janë  
16 bërë publike, mungesa e qasjes. Këto janë raporte të mediave  
17 dhe është e rëndësishme që kombinim.

18 Pra, nuk kemi marrë asnjëherë vetëm një pretendim  
19 individual dhe që ta pohojmë atë si të vërtetë përfundimtare.  
20 Kemi parë modelet dhe kjo është dallim kyç që dua të bëj këtu.  
21 Hetime që kanë shqyrtuar raste individuale dhe hetime që kanë  
22 bërë lidhjen mes këtyre. Shkeljeve për të paraqitur pastaj një  
23 gamë shkeljesh për të që përbën një rast të plotë pastaj.

24 Në këtë situatë rastet që kemi paraqitur në këtë kapitull  
25 tregojnë historinë se si lidhen me burime të shumta. Burime

1 dytësore për raste individuale dhe kjo na çon në një prag ku  
2 jemi në pragun në nivelin ku ne ndihemi që mund të kemi  
3 arritur atë nivel ku mund të bëjmë pohime dhe theksoj pikën që  
4 Human Rights Watch nuk është gjykatë. Ne thjesht mbledhim  
5 prova që të paraqesim raste të besueshme për publikun dhe  
6 politikëbërësit dhe besoj se kjo është ajo që ne kemi bërë  
7 këtu.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara --

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Z. Gjykatës, po përpiqem --

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dëshmitari iu përgjigj pyetjes  
11 dhe tani mund të parashtrojë kundërshtimin bazuar në  
12 informacion që mbi të cilin dëshmoi dëshmitari. Kundërshtimi  
13 është që kjo është provë e papranueshme në sipas kompetencës  
14 së Gjykatës, sepse siç e përmendi në dëshminë e tij vetë  
15 dëshmitari, ai nuk e përmend burimin e informacionit mbi të  
16 cilën është bazuar kjo pjesë.

17 Kjo është përpiluar, siç e tha vetë dëshmitari, për të  
18 prezantuar, për të ndërtuar një rast, pra, është konceptuar që  
19 të paraqesë një argument që rastësisht përputhet edhe me atë  
20 të Prokurorisë. Pra, kjo nuk është provë e pranueshme. Mbi  
21 këtë bazë asgjë Gjykata nuk mund të vlerësojë asgjë lidhur me  
22 besueshmërinë e kësaj prove. Fakti që dëshmitari thotë "ne  
23 besonim, menduam që ishte e besueshme", kjo është punë e  
24 Gjykatës për të bërë, këtë e bën Gjykata nuk e bën Human  
25 Rights Watch. Për të lexuar raportet e përpiluara nga palë të



1 treta, pa intervistuar asnjëherë vetë burimet.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi  
3 refuzohet. Dëshmitari sqaroi metodologjinë, mënyrën sesi janë  
4 mbledhur dëshmitë. Ai është duke u marrë në pyetje nga  
5 Prokuroria. Mund të merret në pyetje nga Trupi Gjygues në këtë  
6 fazë dhe e bëra të qartë, do ta lejoj pyetjen Prokurori.

7 Z. TIEGER: [Përkthim]

8 PY. Dhe përfundimisht u nxor ky raport pas zyrës së krijimit  
9 të zyrës së z. Demaçi në Prishtinë dhe pasi keni filluar t'i  
10 dorëzoni këto raporte të kësaj, të Human Rights Watch, kësaj  
11 zyre pra.

12 PË. Kërkoj ndjesë. Përgjigjen nuk e mora vesh pyetjen.

13 PY. A ishte ky raport njëri prej atyre që ju keni nxjerrë pas  
14 hapjes së zyrës së z. Demaçi dhe pas asaj periudhe kohore kur  
15 ju i keni dhënë raportet e Human Rights Watch asaj zyre.

16 PË. Po.

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Z. Gjykatës, dorëzoj raportin si  
18 provë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
20 çaktivizuar]

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Pjesë të raportit që gjenden në  
22 faqen 75 deri në 86 të dokumentit.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] E kam një kundërshtim. Natyrisht e  
24 papranueshme. Këto vijnë nga burime dytësore dhe është një  
25 vlerësim i pavarur i dikujt që është lidhur me atë që ka thënë

1 një burim dytësor.

2 Ne kemi në këtë dokument, komente që bëri z. Emmerson. Në  
3 qoftë se qëllimi është që të paraqitjen e një krimi individual  
4 e mund ta bëjmë këtë dhe e kanë edhe herë të tjera me  
5 dëshmitarë të tjerë që kemi nën Rregullin 154. Por këtu janë  
6 informacione që nuk janë marrë nga viktimat por nga burime  
7 dytësore. Pastaj janë përpiluar, 13, 14 faqet e këtij raporti  
8 që Prokuroria paraqet, do që t'i paraqesë provë thelbësore.

9 Në qoftë se ne duhet të bëjmë pyetje kush janë këta  
10 burime dytësore, nga vinin këto, ku janë këto nivele dytësore,  
11 nivelit të tretë e të tjerë.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në qoftë se mund të shtoj. Po të  
13 shikoni shënimet, poshtëshënimet, z. Gjykatës, në këtë pjesë  
14 do të shihni se pretendimet thelbësore siç janë aty janë  
15 tërhequr ose nga raporti i Qendrës Juridike Ndërkombëtare i  
16 publikuar pak përpara këtij raporti dhe kjo është i pari nga  
17 këto raporte. Dhe pyetja ime është, sa, si është kjo ndryshe  
18 nga fakti që të sillet këtu një komentator nga i marrëdhënieve  
19 ndërkombëtare duke thënë, kam lexuar të gjitha këto gjëna dhe  
20 kjo është ajo që mendoj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
22 çaktivizuar]

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Ajo që dua të them është kontrasti  
24 nga qëndrimi i Prokurorit sot, krahasuar me raportet e tjera  
25 lidhur me ndalimin dhe abuzimet në Kosovë. Dëshmitari është

1 orientuar tek disa paragrafë konkretisht që janë të bazuara në  
2 njohurinë e tij personale dhe pastaj janë bazuar, janë pranuar  
3 mbi atë bazë. Ndërsa tani kemi një kapitull të tërë të cilin  
4 dëshmitari tha që bazohet në burim dytësore dhe po paraqitet  
5 si provë, pra, ky. Ne e kundërshtojmë këtë.

6 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova 75, 76  
8 pranohet. Këtë e kemi biseduar disa herë. Këto janë, rregullat  
9 tona nuk e parashtrojnë pranimin e këtij. Është e qartë që do  
10 të vlerësohet pesha që ka ky raport nuk do të thotë që ajo që  
11 është shkruar aty është e vërtetë. Jemi të vetëdijshëm që se  
12 si gjithë të tjerët. Është raporti i autentifikuar.

13 Z. TIEGER: [Përkthim] Vazhdon në faqen 77, 86. Pra është  
14 nga 75 deri në 87.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Diçka tjetër,  
16 z. Prokuror, a mund të konsiderojmë që të gjitha këto  
17 dokumente që keni paraqitur janë publike, përveçse në rastin  
18 që e thoni ndryshe.

19 Z. TIEGER: [Përkthim] Po, të gjitha janë publike.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pjesët e pranuar do të  
21 shënohen me numrin P380.

22 Z. TIEGER: [Përkthim] Këtu përfunduar marrjen në pyetje  
23 të dëshmitarit nga ana jonë. Faleminderit.

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

25 Z. KEHOE: [Përkthim]

1 PY. Mirëmëngjesi, z. Abrahams. Unë quhem Kehoe dhe përfaqësoj  
2 Presidentin Thaçi dhe do doja t'ju bëj disa pyetje lidhur me  
3 atë që thatë dje. Po ashtu edhe atë që thatë sot. Në qoftë se  
4 nuk kuptoni ndonjë nga pyetjet më thoni dhe gjithashtu po jua  
5 ndërpreva përgjigjen tuaj kërkoj ndjesë paraprakisht, në qoftë  
6 se e bëj këtë gjë.

7 Dua të filloj paraprakisht me disa nga komentet tuaja që  
8 kanë të bëjnë me Ademin Demaçin, z. Demaçi të cilin besoj për  
9 të cilin besoj thatë që e keni takuar një herë, saktë?

10 PË. Jo, jemi takuar më shumë se një herë.

11 PY. Sa herë jeni takuar me të?

12 PË. Keni fjalën gjatë kohës mbante pozitën e përfaqësuesit --

13 PY. Po, kur ishte përfaqësues i UÇK-së.

14 PË. Të paktën dy herë, por nuk e di saktësisht.

15 PY. Dhe keni konstatuar në faqen, më duket se është 140  
16 rreshti 3-4 në transkriptin e djeshëm dhe ju mendoni që  
17 ndikimi i z. Demaçi në vendimmarrje ishte i kufizuar?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Më shpjegoni pak dje thatë që z. Demaçi kishte një zyrë,  
20 kishte te rreth 12 këshilltarë?

21 PË. Nuk mund ta di saktë sa këshilltarë kishte.

22 PY. E dini ju nëse ndonjë nga këshilltarët ishte gjeneral në  
23 ushtrinë jugosllave?

24 PË. Nuk e di këtë.

25 PY. Dhe a e dini që ka dhënë konferenca për shtyp të

1 rregullta nga shtatori i '98?

2 PË. Ka komunikuar rregullisht me mediat, është e saktë.

3 PY. E dini që ka përfaqësuar UÇK-në - kërkoj ndjesë - në  
4 Kosovë dhe në vendet e tjera, është e saktë?

5 PË. Me sa di unë, po. Nuk besoj që ka qenë përfaqësues në  
6 bisedimet në Rambuje.

7 PY. Ka shkuar në Shqipëri, ka qenë në Maqedoni, Slloveni si  
8 përfaqësues i UÇK-së apo jo?

9 PË. Me sa më kujtohet, po.

10 PY. Dhe konstatuat në deklaratën tuaj se Z. Demaçi ishte ai  
11 që nënshkruante apo jepte leje udhëtimi për njerëz si ju apo  
12 të tjerë që të shkonin në territoret e mbajtura nga UÇK-ja,  
13 saktë?

14 PË. E saktë.

15 PY. Dhe këto leje udhëtimi janë respektuar në gjithë Kosovën?

16 PË. Saktë. Domethënë nga shqiptarët e Kosovës.

17 PY. Përgjigje e drejtë. Shqiptarët e Kosovës. Dhe në pikat e  
18 kontrollit, në postblloqet, pjesëtarët e UÇK-së e kanë  
19 respektuar këto leje udhëtime të firmosura të nënshkruara nga  
20 zyra e Adem Demaçit?

21 PË. Për pjesën më të madhe të tyre, po.

22 PY. Kanë lëshuar deklarata komunikata në emër të UÇK-së po  
23 ashtu?

24 PË. Nuk jam i sigurt për këtë, por është plotësisht e mundur.

25 PY. Është e mundur sipas jush.

1 PË. Ka folur publikisht në emër të UÇK-së, kjo është e  
2 vërtetë.

3 PY. Përpiqemi që të mos flasim njëkohësisht që se përkthyesit  
4 duhet të bëjnë punën e tyre.

5 Dhe në fakt ka vepruar si ndërmjetës. Të kthehemi pak më  
6 mbrapa te udhëtimet ndërkombëtare, ju kujtohet që ai ka qenë i  
7 përfshirë në Akordet e Oslos ku UÇK-ja dhe FARK-u përpiqeshin  
8 të bashkoheshin dhe kjo ka ndodhur në maj të '98-s.

9 PË. Nuk jam, nuk kam dijeni për këtë dhe për hollësitë e  
10 kësaj.

11 PY. Keni dijeni për udhëtimin e tij në Stamboll, lidhur me  
12 këtë çështje?

13 PË. Jo.

14 PY. Keni dijeni se në fakt ai ka lëshuar, bërë komente në  
15 shtyp kur për në rastin e daljes së marrëveshjes mes  
16 Holbrooke-ut dhe Millosheviçit ku thuhej që Ushtria Çlirimtare  
17 e Kosovës duhet të tregonte vetë përmbajtja, ju tregohet kjo?

18 PË. A mund të më thoni saktësisht për të cilat Akorde e keni  
19 fjalën?

20 PY. Është bërë një armëpushim apo është përpjekur të bëhet  
21 një armëpushim në tetor të '98-s me Millosheviçin dhe  
22 ambasadorin Holbrooke?

23 PË. E saktë.

24 PY. Dhe personi i cili publikisht ka shpallur vetëpërmbajtjen  
25 në emër të UÇK-së ishte Adem Demaçi apo jo?

1 PË. Nuk më kujtohet deklarata, por pranoj që është e mundur  
2 dhe ai ta ketë dhënë, të ketë bërë një deklaratë të tillë.

3 PY. Me përjashtim disa rasteve të vogla UÇK-ja i është  
4 përmbajtur, ka respektuar këtë vetëpërmbajtje nga tetori dhe  
5 në muajt në vijim të '98-s apo jo?

6 PË. Është e saktë.

7 PY. Nëse më lejoni ju përmendët po ashtu dhe tani duhet të  
8 nxjerr fjalët e tua saktësisht që, citimin tuaj të saktë. Ju  
9 thoni gjithashtu, kjo është në faqen 140, rreshtat 21 dhe 22.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Fatkeqësisht z. Gjykatës nuk e kam  
11 transkriptin e plotë të djeshëm. Është i përkohshëm ky që kam  
12 këtu. Kërkoj ndjesë. Në qoftë se po i referohem në mënyrë jo  
13 të duhur.

14 PY. Ju konstatuat lidhur me z. Demaçi, gjithmonë kam dalë në  
15 këto bisedime duke kuptuar që ndikimi i tij mbi ata që ishin  
16 të përfshirë në luftën e armatosur ishte i kufizuar, ju  
17 kujtohet që e thatë këtë dje?

18 PË. Po, më kujtohet.

19 PY. Më lejoni t'ju lexoj një pjesë të transkriptit në një  
20 transkript në këtë gjykim.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Faqe 5611, rreshtat 23, 5612,  
22 rreshti 24.

23 PY. Dhe këto janë pyetje --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje të  
25 kujt, kush i ka bo këto pyetje dhe kujt.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Këto janë pyetje që Prokuroria i ka  
2 bërë z. Rrustem Mustafa. Është vetidentifikues.

3 PY. Pra, pyetja që iu bë z. Mustafa, të cilin me nofkën e  
4 luftës ka pas, është njohur si komandant Remi. Pyetja, pra, të  
5 bëra nga Prokuroria dhe po citoj këtu:

6 "Mirëmëngjesi, z. Mustafa. Keni përmendur Adem Demaçin  
7 disa herë në dëshminë tuaj. Cila ka qenë pozita e tij zyrtare  
8 në UÇK

9 "PË. Ai ishte drejtor i Drejtorisë Politike të Ushtrisë  
10 Çlirimtare të Kosovës, por mbi të gjitha ishte udhëheqësi i  
11 shqiptarëve, i popullit shqiptar për edhe kjo për shumë vite  
12 kur ishim nën pushtimin serb.

13 "PY. A e keni fjalën për Drejtorinë e Përgjithshme  
14 Politike të UÇK-së apo i referoheni ndonjë zyre politike të  
15 veçantë?

16 "PË. Për mua kjo ka qenë drejtoria më e madhe e UÇK-së  
17 politike.

18 "PY. E kuptoj, prapë për ju ka qenë më e rëndësishmja, po  
19 cila ishte kjo?

20 "PË. Zyra e udhëhequr nga Adem Demaçi në Prishtinë ishte  
21 zyra më e rëndësishme.

22 "PY. Pra, ishte zyra politike e UÇK-së në Prishtinë kjo  
23 që ai udhëhiqte?

24 "PË. Po.

25 "PY. Keni thënë që është ka qenë person shumë i



1 rëndësishëm për juve; e keni njohur shumë mirë.

2 "PË. Po, e kam njohur shumë mirë.

3 "PY. Dhe ka pasur ndikim në çështjet politike?

4 "PË. Po. Në përgjithësi kam bashkëpunuar shumë me mësues  
5 Demaçin.

6 "PY. A mund të thoni edhe më shumë që edhe më shumë kjo  
7 vlen edhe për pjesëtarët e tjerë të UÇK-së?

8 "PË. Ai ka qenë në përgjithësi për popullin shqiptar dhe  
9 për UÇK-në në tërësi. Por për mua ka qenë edhe më shumë, për  
10 mua ka pas edhe ka qenë edhe më i rëndësishëm se për të  
11 tjerët".

12 Pra, kjo ishte deklarata e z. Rustem Mustafa të cilin ju  
13 e dini që ka qenë komandanti i zonës operative të UÇK-së në  
14 zonën e Llapit?

15 PË. Po, jam në dijeni për këtë. E di këtë.

16 PY. A do ta vlerësonit që z. Mustafa, komandant Remin si  
17 njërin prej atyre që ishte i përfshirë në luftën e armatosur?

18 PË. Po.

19 PY. Pra, është e qartë për ju që në fakt, Adem Demaçi kishte  
20 në fakt, ndikim në personat që ishin përfshirë në luftën e  
21 armatosur, siç është rasti i z. Remi, komandant Remi - kërkoj  
22 ndjesë?

23 PË. Nuk mund të komentoj pikëpamjet e z. Mustafa. S'e kam  
24 takuar asnjëherë, s'kam biseduar me të asnjëherë. Pra, nuk jam  
25 në gjendje të jap komente mbi mënyrën se si ai e ka parë apo

1 konsideruar z. Demaçi apo dikë tjetër. Qëndroj, pra,  
2 pikëpamjes sime që kur bëhej fjalë për çështje ushtarake apo  
3 vendime strategjike, për çështje konkrete që lidhen me  
4 sigurinë, unë s'kam parë asnjëherë prova që lenin të kuptojnë  
5 që z. Demaçi kishte ndonjë ndikim.

6 PY. Duke qenë se ju nuk e dini çfarë ndikimi kishe z. Demaçi  
7 mbi komandant Remin, Rustem Mustafa, më lejoni të dhe dua të  
8 baj të qartë, të qartësoj përgjigjen tuaj të fundit lidhur me  
9 këtë.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo ishte dëshmia e z. Mustafa më 14  
11 korrik 2023, faqet 5752, rreshti 22 deri në 5753, rreshti 5.

12 PY. Pyetja e z. Mustafa:

13 "PY. A ju kujtohet, a ka bërë përpjekje Shtabi i  
14 Përgjithshëm i UÇK-së që t'ju kërkonin juve që të tërhiqeshit  
15 nga kjo vijë komunikimi?".

16 Ju kuptoni se linja e komunikimit ka qenë rrugë në fakt.  
17 Është terminologji ushtarake për të përshkruar një rrugë që  
18 shkon nga një vend në një vend tjetër, komunikim, pra, në  
19 kuptimin fizik.

20 PË. Kërkoj ndjesë. Besoj që do duhej të kisha qasje materiali  
21 që t'i përgjigjem saktësisht. Kjo është pyetje që është bërë  
22 z. Mustafa?

23 PY. Po. Më lejoni t'ju lexoj pyetjen në tërësi.

24 "A ju kujtohet që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka bërë  
25 përpjekje duke ju kërkuar ju që të tërhiqeshit nga kjo rrugë

1 komunikimi?

2 "PË. Po. E di që janë bërë përpjekje, por u kam thënë  
3 atyre që të mos merrem me këtë çështje më larg, më tej. Unë  
4 nuk do të, jua bëra të qartë që nuk do t'u bindesha atyre  
5 lidhur me këtë pikë".

6 Kjo është dëshmia e dhënë nga zoti nga komandant Remi në  
7 këtë Gjykatës, ku thoshte që nuk do u bindej Shtabit të  
8 Përgjithshëm, a është e qartë kjo?

9 PË. E kuptoj atë që po thoni.

10 PY. Pyetje përsëri z. Mustafa:

11 "Dhe arsyeja që nuk do t'i bindeshe Shtabit të  
12 Përgjithshëm ishte sepse autoriteti më i lartë në zonën e  
13 Llapit ishit ju dhe komanda jua, është kështu?

14 "PË. Po, kështu është. Dhe kam pasur një marrëveshje me  
15 shefin e zyrës politike, z. Adem Demaçi".

16 Pra, në këtë shembull, në këtë rast konkret kemi një  
17 person që është i përfshirë në luftën e armatosur i cili ka  
18 marrëveshje me Adem Demaçin për të bërë diçka që është ndryshe  
19 nga ajo që i kërkohej të bënte nga Shtabi i Përgjithshëm i  
20 UÇK-së. E kuptoni çfarë po them apo jo?

21 PË. Kështu duket nga deklarata apo dëshmia që ju cituat të z.  
22 Mustafa. Unë nuk kam njohuri të drejtpërdrejta të raportit mes  
23 tyre.

24 PY. E kuptoj. Po përpigem të eksploroj deklaratën tuaj ku  
25 thoni që Demaçi s'ka pasur ndikim tek lufta e armatosur dhe ju

1 thoni pa patur informacion, ndërsa unë sapo ju lexova dëshminë  
2 e z. Mustafa.

3 PË. Gjithçka që unë kam kuptuar nga konflikti është që s'kam  
4 parë ndonjë provë që z. Demaçi kishte ndikim në forcat në  
5 terren. Por edhe këtu kam konstatuar që ai nuk ishte  
6 përfaqësues, nuk merrte pjesë në marrëveshjen në Rambuje. Nuk  
7 e di nëse z. Demaçi, mendimi i z. Demaçi, është marrë mendimi  
8 i z. Demaçi apo është konsultuar kur është kthyer z. Thaçi. Sa  
9 i përket nënshkrimit të Marrëveshjes së Rambujesë nuk kam  
10 përgjigje për këtë. Por në qoftë se ka ndonjë lidhje me z.  
11 Demaçi dhe z. Mustafa është diçka për të cilën nuk mund të bëj  
12 komente. Mund të referohem këtu thjesht dëshmisë që ju sapo  
13 përmendët, cituat.

14 PY. Edhe unë thjesht po i referohem dëshmisë tuaj, por  
15 pajtoheni me mua se për të dhënë një deklaratë që ndikimi, ku  
16 thuhet që ndikimi i z. Demaçi tek personat që bënë luftë të  
17 armatosur ishte i kufizuar. Do dua që ju të kuptoni mirë  
18 raportin e z. Demaçi me komandantët e zonave apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. E dini ju cila ka qenë marrëdhënia e z. Demaçi me, për  
21 shembull, me Ramush Haradinaj që ka qenë komandant i zonës së  
22 Dukagjinit?

23 PË. Jo, nuk e di.

24 PY. Keni ndonjë ide, për shembull, po marr edhe një tjetër,  
25 rastësisht çfarë lloj, cilat ka qenë marrëdhëniet e z. Demaçi

1 me z. Sylejman Selimi që ka qenë komandant i zonës së  
2 Drenovcit [Sipas përkthimit] që pastaj u bë komandant i  
3 përgjithshëm i UÇK-së, a e dini për këtë?

4 PË. Nuk e di për marrëdhëniet e tyre.

5 PY. A e dini cila ka qenë marrëdhënia e tij me, çfarë  
6 marrëdhënie ka pas ai me këdo prej cilindo prej komandantëve  
7 të zonave në Kosovë gjatë '98-s dhe '99-së?

8 PË. Vlerësimi im është bazohet në rolin dhe profilin që  
9 kishte z. Demaçi në atë kohë dhe veprimet në terren. Unë nuk  
10 kam ardhur në dijeni të as lidhjeve apo që ai kishte ndonjë  
11 ndikim tek ata që luftonin dhe që ishin nga një brez tjetër  
12 apo marrëdhëniet e drejtpërdrejta me individë, komandantë,  
13 këto janë gjëra për të cilat nuk kam dijeni.

14 PY. Duke pasur parasysh faktin që nuk keni dijeni dhe nuk  
15 mund të na jepni një përgjigje të plotë, sa i takon influencës  
16 së Demaçit, në qoftë se kishte ndonjë influencë, mbi persona  
17 të përfshirë në konflikt të armatosur, sepse ju nuk e dini.

18 PË. Nuk pajtohem.

19 PY. Atëherë na thuaj marrëdhënien që kishte ai me komandantë  
20 të zonës. Këtë pyetje kisha unë. Çfarë marrëdhënie kishte me  
21 Haradinaj, çfarë marrëdhënie kishte me Sylejman Selimin apo  
22 këdo tjetër? Zgjidhe vetë komandantin e zonës.

23 Z. TIEGER: [Përkthim] Ë kundërshtojmë. Është bërë pyetja  
24 dhe e ka marrë përgjigjen.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ai të tha

1 që nuk e njoh marrëdhënien. Vetëm në qoftë se ka ndonjë  
2 përgjigje tjetër mund ta japi.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, kjo është përgjigja ime.

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Fole për Rambujenë. A e dini se z. Thaçi gjatë Rambujesë,  
6 shkoi në Slloveni me avion të takohej me z. Demaçi për të  
7 diskutuar marrëveshjen e Rambujesë. A e dini këtë?

8 PË. Jo, nuk e di.

9 PY. A e dini ju që gjatë negociatave të Rambujesë - më fal,  
10 do ta tërheq këtë pyetje, do ta riformuloj - a e dini, ju e  
11 dini me siguri që gjatë negociatave të Rambujesë komandanti i  
12 UÇK-së i atëhershëm, Azem Syla, ndërkohë që po vazhdonin  
13 negociatat e Rambujesë z. Syla ishte në Rambuje, komandantët e  
14 zonës e zëvendësuan komandantin Syla në Kosovë?

15 PË. Më fal se nuk e kuptova. Kush u zëvendësua, z. Syla?

16 PY. Më fal ë, do ta riformuloj, se ndonjëherë i bëjnë kështu  
17 pyetjet e vështira. Ndonjëherë është më e qartë në mendjen  
18 tonë dhe s'e artikulojmë siç duhet. Edhe një herë: A jeni në  
19 dijeni se gjatë negociatave të Rambujesë, gjatë bisedimeve,  
20 pra, në vitin 1999 në shkurt, Azem Syla, atëherë ishte  
21 komandant i përgjithshëm i UÇK-së. Edhe Azem Sylën e  
22 zëvendësuan në Kosovë komandantët e zonës. Ndërkohë që Thaçi,  
23 Syla dhe pjesa tjetër e delegacionit ishin në Rambuje. A jeni  
24 në dijeni të kësaj?

25 PË. Jo, as nuk e kam ditur madje që z. Syla paska qenë

1 komandant i përgjithshëm. Kështu që s'mund të them gjë për  
2 këtë.

3 PY. Po a e dini se z. Demaçi ishte një nga pjesa kryesore apo  
4 kyçe të bisedimeve me komandantët e zonës për të emëruar  
5 Sylejman Selimin, në fund të shkurtit, fillimi i marsit '99?

6 PË. S'e kam dëgjuar asnjëherë. Nuk mund të them a është a  
7 s'është e vërtetë.

8 PY. Folët, na treguat, pra, folët për lirin e dy gazetarëve  
9 të pretenduar të Tanjug-ut. A e dini ju që në fakt ka qenë  
10 Demaçi ai, e bëri të mundur atë lirim, që e orkestroi këtë  
11 lirim?

12 PË. Detajet e lirit në nëntor, 27 nëntorit nuk i di. Por ne  
13 kemi shprehur shqetësimet tona me z. Demaçi dhe në fakt ai  
14 kontaktoi me një sërë organizatash ndërkombëtare të cilat  
15 punonin në atë zonë në atë kohë.

16 PY. Do të kërkoj që të vendoset në ekran materiali  
17 SPOE00225229. Kjo është një komunikatë, komunikata numër 63  
18 edhe thuhet, është data 27 nëntor '98 dhe thuhet: Me lirin,  
19 për nder të festave të nëntorit Ushtria Çlirimtare e Kosovës  
20 vendosi të amnestojë një numër të burgosurish në mesin e tyre  
21 dy gazetarëve të Tanjug-t dhe dy aktivistë të LDK-së. Edhe u  
22 ndërpre vuajtja e dënimit të tyre.

23 Dhe më duket se njëra nga provat materiale është thënë  
24 që, besoj se e dini që është diku e dokumentuar. Pra, që 27-28  
25 nëntori janë ditë të mëdha se janë Dita e Flamurit.

1 PË. Po, kështu është.

2 PY. Dhe më duket se është edhe ditëlindja e Adem Jasharit?

3 PË. Nuk e di këtë gjë.

4 PY. Por ju e dini që ka ndodhur kjo gjë dhe që ka lëshuar  
5 këtë komunikatë UÇK-ja.

6 PË. Po, jam në dijeni.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet ky dokument si  
8 provë.

9 Z. TIEGER: [Përkthim] S'kemi kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali  
11 SPOE00225229 pranohet.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës  
13 materiale 1D47.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani do kërkoj që të shfaqet në  
15 ekran SPOE00225737, është një faqe edhe në anglisht edhe në  
16 shqip.

17 PY. Ky është shënim me shkrim dore. Nuk është se po pres që  
18 ta lexosh në shqip. Po nëse shkojmë nga fundi i faqes thuhet:

19 "Kjo është porosi e Adem Demaçit".

20 Dhe poshtë është Albin Kurti. Besoj se e njihni Albin  
21 Kurtin?

22 Në atë kohë Albin Kurti ishte asistent i z. Demaçi,  
23 kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Shohim paragrafin 5 të këtij dokumenti dhe thuhet:



1 "Është mirë që t'i lironi gazetarët e Tanjug-ut pa e  
2 vuajtur komplet dënimin, sepse nëse e vuajnë komplet do të  
3 dalin si heronj. Do ishte mirë që lirimi të bëhet për festën e  
4 28 Nëntorit. Lirimin ta bëni ju vetë ose edhe me Adem Demaçin,  
5 por jo me KDOM-in, sepse po duket thujse se KDOM-i i liroi  
6 ata".

7 Në fakt kështu ka ndodhur. Mund të ketë qenë mbase një  
8 ditë më përpara, por kjo ka ndodhur me porosi të Adem Demaçit,  
9 kështu?

10 PË. Para se të përgjigjem dua të kuptoj burimin e këtij  
11 dokumenti. A mund të shkojë pak më lart ta kuptoj nga ka dalë  
12 ky dokument?

13 PY. Patjetër. I është dërguar Shtabit të Përgjithshëm dhe ne  
14 na e ka dhënë Prokuroria këtë dokument.

15 PË. Dërgohet Shtabit të Përgjithshëm. Janë shënime, është  
16 procesverbali i një takimi.

17 PY. Është shënim i Albin Kurtit për Shtabin e Përgjithshëm.

18 Z. TIEGER: [Përkthim] A mund të shohim pjesën e  
19 dokumentit ku thuhet saktësisht kjo gjë?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Saktësisht, çfarë?

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Dokumenti është tregues në vetvete.  
22 E kuptojmë. Po ju thatë se dokumenti ka një pjesë që tregon ku  
23 është dërguar, kujt i është drejtuar. Por unë s'po e shoh.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Po besoj se kështu na ka thënë ZPS-  
25 ja kur na dha ne dokumentin. Po të shihni tek numri 6, thotë,

1 tek pika 6 thotë:

2 "Që duhet të caktoni një komandant të shtabit".

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk po e ve në diskutim argumentet  
4 që bëni ju për përmbajtjen e dokumentit. Unë thjesht dua të  
5 kuptoj burimin.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Po ky është një dokument që ZPS-ja  
7 na e ka dhënë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por në qoftë  
9 se nuk e tregon kujt i është drejtuar, çfarë, e shihni ju,  
10 kujt iu dërgua ky dokument.

11 Duhet të vërtetohet autenticiteti i këtij dokumenti.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirë, po e tërheq për momentin dhe  
13 të shohim, të shoh pastaj çfarë elementesh autenticiteti do  
14 gjej. Ne kemi marrë një numër të konsiderueshëm materialesh  
15 nga ZPS-ja.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë do thoj  
17 që është një shënim nga Albin Kurti dhe në bazë të kësaj më  
18 pas do t'i bëja pyetjet.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Ke të drejtë, ke të drejtë. Kështu  
20 do ta bëj.

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 PY. Pra, ky është një shënim nga Albin Kurti ku përmendet  
23 lirimi në periudhën kur thuhet se u liruan të ndaluarit.

24 PË. Bazuar në këtë dokument, po. Megjithëse, nuk e shikoj,  
25 ndonëse nuk e shikoj datën në dokument.

1 PY. Për të qenë i sigurtë nuk mendoj se ka datë dokumenti.

2 PË. Po atëherë s'mund ta them cila periudhë.

3 PY. Po sigurisht, pra, që bëhet fjalë për dy gazetarë të  
4 Tanjug-ut gjatë kohës që ishin të ndaluar, por ama s'ishin  
5 akoma të ndaluar, por akoma të liruar.

6 PË. Po, duket që kjo të jetë periudha përkatëse.

7 PY. Atëherë, pasi bën këtë sqarimin kërkojmë që ky dokument  
8 të pranohet si provë.

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00225737,  
11 një faqe e vetme në shqip dhe në anglisht pranohet.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës  
13 materiale 1D47 edhe të keni parasysh që dokumenti 1D47 është i  
14 klasifikuar si konfidencial. A duhet ta mbajmë publik apo  
15 konfidencial?

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Publik, publik i nderuar Gjykatës.

17 Gjithashtu do të marr më shumë informacion për këtë  
18 dokument, nuk është se ka metadata për këtë dokument. Ne me sa  
19 dimë ky është një dokument i cili ka buruar nga z. Krasniqi.  
20 Është një nga dokumentet që është sekuestruar nga z. Krasniqi.  
21 Megjithatë, do kërkoj më shumë informacione sapo ta marrim dhe  
22 t'ia japin Trupit Gjykses.

23 PY. Ditën që u liruan këta dy persona. E dini që zyra e z.  
24 Demaçi kontaktoi Sokol Bashotën që t'i lironte?

25 PË. Jo. Nuk e di hollësitë se si u organizua.

1 PY. Po a e dini kush është Sokol Bashota?

2 PË. Më duket emër i njohur, por nuk më kujtohet çfarë pozite  
3 ka pasur.

4 PY. A mendoni se ka qenë zëvendëskomandanti i UÇK-së, pra,  
5 ushtarak?

6 PË. Po, po i UÇK-së, po. Por nuk e di pozitën.

7 PY. Po a e dini ju Ademi, Adem Demaçi tha t'i lironi këta  
8 persona?

9 PË. Jo.

10 PY. Sa i takon influencimit që kishte që mbi vendimmarrjen.  
11 Unë dua të tregoj një artikull tjetër lidhur me këtë që do të  
12 jetë, që është materiali DHT1457.

13 Është një artikull gazete, është Koha Ditore. Mbase unë  
14 në anglisht nuk e shqiptoj siç duhet dhe jam e sigurt që s'e  
15 kam shqiptuar siç duhet në anglisht.

16 Është një konferencë shtypi i sekretarit të zyrës së  
17 përfaqësuesit të përgjithshëm politik të UÇK-së ku thuhet,  
18 asnjë vendim politik pa pëlqimin e Adem Demaçit, në  
19 kryetitull. A ju, ju mund ta lexoni, mund t'i hidhni një sy ku  
20 thuhet është nga, është thënë nga z. Kurti kjo:

21 "Asnjë vendim politik pa pëlqimin e Përfaqësuesit Politik  
22 të UÇK-së, Adem Demaçi".

23 A nuk ju tregon kjo ju se z. Demaçi, në fakt ishte një  
24 person që kishte autoritet, sa i takon vendimmarrjes dhe  
25 ushtronte këtë autoritet?

1 PË. Nuk pajtohem. Dhe unë mund t'jua shpjegoj dhe pse nuk  
2 pajtohem.

3 Së pari, kishte interesa dhe përpjekje që konkurronin me  
4 njëra-tjetrën. Kush, për të, kush do të ishte përfaqësimi  
5 politik në këto kohë, për të mos folur për Ibrahim Rugovën dhe  
6 për të tjerët. Nuk kam asnjë dyshim që kjo pasqyron dëshirën  
7 dhe synimin e z. Demaçi dhe të z. Kurti për të ushtruar  
8 autoritet.

9 Po ashtu, nuk them, dhe nuk po them që z. Demaçi nuk  
10 kishte autoritet, nuk besoj se e thashë diçka të tillë. Në  
11 qoftë se e kam thënë nuk kam dashur ta shpreh këtë formë. Z.  
12 Demaçi kishte autoritet moral edhe deri diku autoritet  
13 politik. Mendimi im dhe sigurisht që unë nuk e ndryshoj  
14 mendimin tim është ky: Ai nuk ushtronte autoritet të  
15 konsiderueshëm mbi çështjet ushtarake apo të sigurisë, apo mbi  
16 forcat e angazhuar në luftime. Unë edhe sot e kësaj dite e  
17 besoj se kështu është.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të pranohet si  
19 provë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
21 kundërshtime?

22 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT01457  
24 pranohet.

25 Z. KEHOE: [Përkthim]

1 PY. Do të doja të flisnim për një temë tjetër.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni një  
3 sekondë.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës  
6 materiale 1D49.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë edhe një herë.

8 PY. Z. Abrahams, të ndryshojmë pak temën dhe të flasim për  
9 metodikën që zbatonte apo përdorte organizata juaj. Besoj se  
10 dje na treguat më me hollësi në lidhje me këtë. Besoj se ju  
11 theksuar rëndësinë e metodikës që zbatonte organizata Human  
12 Rights Watch?

13 Më duket se i thatë po ashtu Trupit Gjykues dhe për  
14 referencë është faqja 113 e transkriptit të djeshëm, rreshtat  
15 22 dhe 23. Thatë:

16 "Unë jam përgjegjës për mbikëqyrjen e trajnimit të stafit  
17 që merret me hulumtimet dhe u mësoj metodikat e reja,  
18 metodikat tona".

19 A ju kujtohet?

20 PË. Po, më kujtohet.

21 PY. Pra, një nga funksionet kryesore që keni pasur ju tek  
22 Human Rights Watch ishte të dokumentonit shkeljet për të  
23 drejtat njeriut në gjithë botën?

24 PË. Po, kështu është.

25 PY. Dje - më falni një çast sa ta gjej në transkript - dje në

1 transkriptin e djeshëm, në faqen 118, rreshtat 1 deri në 10,  
2 ju thatë se puna kryesore, në fakt është rreshti 9, dhe thatë,  
3 puna kryesore e Human Rights Watch ishte të intervistonte  
4 dëshmitarët dhe kryesit e pretenduar aty kur ishte e mundur,  
5 saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Metodologjia, dhe më korrigjo në qoftë se e kam gabim, po  
8 kështu e kam kuptuar unë të paktën nga dëshmia juaj e djeshme.  
9 Si e kam kuptuar unë është që ju dokumentonit punën e hetuesve  
10 të Human Rights Watch, çfarë kishin parë dhe çfarë kishin  
11 dëgjuar ata. Ju merrnit shënime nga dëshmitarët në terren edhe  
12 kryesit e pretenduar kur ishte e mundshme, kështu?

13 PË. Po, kështu.

14 PY. Prandaj është shumë e rëndësishme kur dokumenton për këta  
15 persona me shënime me raporte për t'i përdorur si referenca në  
16 të ardhmen. Kjo është një punë e rëndësishme.

17 PË. Po.

18 PY. Arsyeja pse është kjo e rëndësishme është që ju të  
19 krijoni një dokumentacion dhe t'u jepeni informacion mbase  
20 gjykatave apo çdo organi tjetër që mund të ketë nevojë për  
21 informacion të tillë, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Dje në transkriptin e ditës së djeshme në faqen 123 ju  
24 thatë, në fillim të faqes 123 ju thatë se kishte raste ku kam  
25 bërë intervista me viktimat dhe dëshmitarët të cilët kishin

1 shprehur se ishin të frikësuar, kishin frikë të flisnim me ju  
2 për krimet e pretenduara të UÇK-së, ju kujtohet kjo?

3 PË. Po.

4 PY. Tani që jemi këtu dhe mund të kalojmë dhe në seancë  
5 private në qoftë se është nevoja. Tani këtu mund të na japësh  
6 emrat e këtyre dëshmitarëve dhe viktimave?

7 PË. Sot, këtu jo.

8 PY. Duhet të keni marrë shënime këtyre takimeve kur shprehët  
9 këto frikërat që kishin dëshmitarët?

10 PË. Po, kam marrë shënime.

11 PY. A u hodhe një sy këtyre shënimeve kur po përgatiteshe për  
12 intervistë me ZPS-së?

13 PË. Jo.

14 PY. A i pe edhe një herë këto shënime kur po përgatiteshe për  
15 të dhënë dëshmi përpara këtij Trupi Gjykues?

16 PË. Jo.

17 PY. Pra, ju po thoni që kishte frikë, viktimat ishin të  
18 frikësuar apo persona të caktuar dhe sot këtu thoni që unë  
19 nuk i pashë edhe një herë shënimet për t'u përgatitur për  
20 intervistën e ZPS-së. Pra, s'i keni parë edhe një herë, s'u  
21 keni hedhur një sy këtyre shënimeve për t'u përgatitur për  
22 dëshminë tuaj dhe nuk mund të na thoni kush janë këto viktima  
23 të pretenduara, kështu?

24 PË. Pjesa e parë po, e komentit tuaj, e parashtrimit tuaj apo  
25 e deklaratës tuaj, është e saktë, është e drejtë. Por më



1 kujtohet dhe jam i sigurt për këtë që disa persona më shprehën  
2 shqetësimet e tyre dhe për këtë s'kam asnjë dyshim.

3 PY. A pajtohesh me mua z. Abrahams që është e rëndësishme të  
4 kuptojmë kush i shprehte këto shqetësime, kur janë shprehur  
5 këto shqetësime dhe ku janë shprehur këto shqetësime, a nuk  
6 pajtohesh me mua?

7 PË. Unë po të jap, po të them çfarë më kujtohet nga  
8 hulumtimet në tërësinë e tyre. Jam i bindur si në intervistat  
9 zyrtare dhe në ato që unë quaj biseda joformale në atë gjashtë  
10 vite pune. Pra, gjatë këtyre intervistave dhe bisedave kishte  
11 dhe komunikime të këtij lloji ku personat shprehën ose lanë të  
12 kuptoheshin, nënkuptoheshin frikërat e tyre kur flisnin për  
13 krimet. Për këtë s'kam asnjë hezitim.

14 PY. Me gjithë respektin nuk të bëra pyetjen, unë mund ta bëj  
15 edhe një herë pyetjen, do ta lexoj edhe një herë pyetjen që të  
16 bëra pak më herët:

17 "...a pajtohesh me mua z. Abrahams që është e rëndësishme  
18 të kuptojmë kush i ka shprehur këto shqetësime, kur janë  
19 shprehur këto shqetësime dhe ku apo jo?"

20 PË. Pajtohem me ju që është e rëndësishme t'i dimë këto  
21 hollësi, por për çfarë qëllimi?

22 PY. Nëse jep dëshmi për këtë frikën, për të cilën po flet,  
23 për ne është e rëndësishme të kuptojmë kush janë këta persona,  
24 kur e kanë dhënë këtë deklaratë dhe ku e kanë dhënë këtë  
25 deklaratë?

1 PË. Po.

2 PY. Po ne as dje, as sot s'kemi marrë asnjë informacion të  
3 tillë?

4 PË. Po keni raporte tona kur përmenden hetimet.

5 PY. Zotëri, ku janë shënimet e këtyre intervistave?

6 PË. Shënimet nga puna në Kosovë i kam të shpërndara në vende  
7 të ndryshme, kryesisht në Shtetet e Bashkuara.

8 PY. Ende punoni për Human Rights Watch, keni qasja në këto  
9 shënime apo jo?

10 PË. Në qoftë se do më duheshin do t'i gjeja.

11 PY. Po duke u përgatitur për këtë dëshmi apo për intervistën  
12 me ZPS-në ju nuk i gjetët, nuk i kërkuar, kështu e kam  
13 kuptuar.

14 PË. Për këtë dëshminë absolutisht jo. Me sa më kujtohet as  
15 për deklaratën që kam dhënë. Nuk jam 100% i sigurt nëse i  
16 pashë edhe një herë kur do jepja deklaratën, se po e rishikoj  
17 edhe një herë përgjigjen që dhashë pak më herët. Nuk besoj,  
18 por për paraqitjen sot e sigurt që jo.

19 PY. Po ZPS-ja gjatë intervistës me Prokurorinë të pyeti  
20 ndonjë moment t'ua tregoje shënimet?

21 PË. Nuk më kërkuan t'ua tregoja dhe nuk do ta kisha, nuk do  
22 ta kisha pranuar këtë gjë.

23 PY. Po mirë, Prokuroria i kërkoi Human Rights Watch t'jua  
24 jepte shënimet?

25 PË. Jo. Edhe organizata as nuk do t'ua jepte.

1 PY. Po organizata, ti e the edhe më herët që i ka rishikuar  
2 këto drejtoria juridike, do ta rishikonte drejtoria juridike e  
3 zyrës suaj për të vendosur përgjigjen përkatëse,

4 PË. Çfarë doni të thoni?

5 PY. Në qoftë se ZPS-ja do të kishte kërkuar shënimet e Human  
6 Rights Watch dhe intervistat me viktimat drejtoria juridike e  
7 Human Rights Watch do ta kishte analizuar këtë kërkesë apo jo?

8 PË. Ne themi zyra e këshillit të përgjithshëm.

9 PY. Po, okej, zyra e këshillit të përgjithshëm.

10 PY. Po ama kjo nuk ka ndodhur sepse nuk është bërë ndonjëherë  
11 kërkesa?

12 PË. Me sa më kujtohet nuk është bërë ndonjëherë kërkesë e  
13 tillë.

14 PY. Folëm për bashkëpunëtorët edhe dje u bë një shkëmbim në  
15 lidhje me këtë.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Më duhet të gjej pak faqen e saktë  
17 ku përmendet kjo gjë, kështu që do ju lutesha të më jepnit  
18 vetëm një moment. Është në, më fal se jam dileksik, por është  
19 faqja 131 e transkriptit të djeshëm.

20 PY. Dhe këtu filloni të flisni për bashkëpunëtorët dhe ju  
21 kanë bërë pyetje z. Tieger ju bërë pyetje, a ke marrë  
22 informacion për faktin që UÇK-ja shënjestronte apo damkoske  
23 personat si kolaboracionistë dhe më duket se në faqen 132 keni  
24 thënë se:

25 "Dhe ne si organizatë kemi bërë intervista me pjesëtarë

1 të familjes, familjeve të cilëve pretendohej si iu ishte marrë  
2 një i afërm, kidnapuar një i afërm apo shënjestruar sepse  
3 perceptohej si bashkëpunëtor. Ju kujtohet?

4 PË. Nuk më kujtohet saktësisht, por po e marr për të mirëqenë  
5 që është e saktë.

6 PY. Unë besoj që po lexoj pjesën e saktë nëse dikush mendon  
7 që nuk është e saktë mund ta shohë në rreshtin 14, faqja 17 e  
8 transkriptit të djeshëm.

9 A i keni bërë këto intervista me pjesëtarë të familjes?

10 PË. Pjesëtarët e familjeve të personave që pretendohet se  
11 janë kidnapuar akuzuar si bashkëpunëtorë këto po thoni?

12 PY. Po, kjo është pyetja.

13 PË. Nuk mund ta them këtë sepse unë personalisht nuk e kam  
14 pas, nuk kam parë diçka të tillë. Për kolegët e mi është e  
15 sigurt që po.

16 PY. Pra, sot, këtu a e di ti kush janë këta pjesëtarë të  
17 familjes, kush janë këta pjesëtarët e familjes që i kanë dhënë  
18 intervista Human Rights Watch?

19 PË. Nëse u rikthehem raporteve mund të zbuloj diçka më shumë  
20 në lidhje me këtë.

21 PY. Po sot, këtu mund të na japësh ndonjë emër se mund të  
22 kalojmë në seancë private?

23 PË. Sot, këtu në këtë bankë nuk mund t'jua jap emra.

24 PY. Me sa kuptoj unë nga këto dhe gjatë këtyre intervistave  
25 janë marrë shënime?

1 PË. Po.

2 PY. Njësoj si pyetjet që të bëra më herët, a i pe edhe  
3 njëherë këto shënimet lidhur me këta personat që kanë dhënë  
4 dëshmi për bashkëpunëtorët, a i pe edhe një herë përpara se  
5 t'i jepje deklaratën ZPS-së?

6 PË. Përpara se i kam dhënë, përpara se t'i jepja deklaratën  
7 nuk më kujtohet në qoftë se i pashë edhe një herë shënimet se  
8 ka kaluar kohë. Por për paraqitjen këtu sot e sigurt që jo.

9 PY. Këto shënime janë të Human Rights Watch apo jo?

10 PË. Këto shënime janë të miat, janë në zotërimin tim, po nuk  
11 i ndajmë me Prokurorin apo me askënd tjetër, sepse është  
12 material i klasifikuar.

13 PY. Pra, shënimet personale i keni ju, s'i keni hedhur një sy  
14 përpara se të bënit intervistën me Prokurorinë dhe as para se  
15 të vinit këtu për të dhënë dëshmi, saktë?

16 PË. Po, po jam i sigurt që nuk i kam parë para se të jepja  
17 dëshminë.

18 PY. Po kur atëherë i ke parë këto shënime? Ku dhe kur?

19 Z. TIEGER: [Përkthim] Më duket se ka një keqkuptim. Ka  
20 thënë dy-tri herë që nuk i kujtohet.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka të drejtë.  
22 Nuk tha që nuk i ka bërë. Thotë që nuk i kujtohet, nuk i  
23 kujtohet.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Keni të drejtë.

25 PY. Sa u takon këtyre shënimeve, ZPS-ja a ju kërkoi t'ju

1 jepnit këto shënime ose ju personalisht ose organizata Human  
2 Rights Watch?

3 PË. Jo. Dhe do ta kishim informuar Prokurorinë që është  
4 informacion i klasifikuar dhe nuk do ta jepnim.

5 PY. Dhe ky nuk ishte vendimi juaj, sepse ju keni dëshmuar më  
6 herët që ky është një vendim i cili merrej përmes këshillit të  
7 përgjithshëm, më duket sikur e quajtet ju, të Human Rights  
8 Watch. Pra, ishte vendimi i këtij departamenti?

9 PË. Është politikë e organizatës të mos ndajë informacion të  
10 klasifikuar.

11 PY. Do ta bëj edhe një herë pyetjen. Në qoftë se do vinte  
12 kërkesa duhej të kalonte përmes këshillit të Human Rights  
13 Watch, pra, do vendoste këshilli pranë organizatës në qoftë se  
14 do nxirrnin ndonjë pjesë lidhur me këto shënime, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Por kjo pyetje nuk t'u bë asnjëherë nga ZPS-ja apo jo?

17 Z. TIEGER: [Përkthim] U bë kjo pyetje më përpara dhe u  
18 përgjigj.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni dhe  
20 përgjigjuni.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Me sa di unë kjo nuk është kërkuar  
22 nga ZPS-ja.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të bëjmë  
24 pushimin.

25 Z. Abrahams, do bëjmë pushimin për gjysmë ore. Sekretarja

1 do t'ju nxjerrë nga salla dhe do kthehemi përsëri në orën  
2 11.30.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 --- Pauza fillon në orën 11.02.

5 --- Seanca rifillon në orën 11.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zonja  
7 sekretare, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

10 Do të vazhdojmë me dëshminë tuaj, z. Abrahams, se z.  
11 Kehoe e ka fjalën që të vazhdojmë me kundër pyetjet për ty.

12 Z. KEHOE: [Përkthim]

13 PY. Z. Abrahams, mirë se erdhët. Shpresoj që të keni pushuar  
14 ndopak. Do të vazhdojë me pyetjet e tjera të cilat kanë të  
15 bëjnë me atë çfarë i ke treguar Trupit Gjykues dje dhe sot.  
16 Dua që të vazhdoj me takimin që keni pasur me z. Thaçin dhe z.  
17 Limaj, të cilin e diskutuam më herët.

18 Besoj që na ke thënë dje, dhe për procesverbal kjo jepet në  
19 faqen 141, rreshtat 1 dhe 2, që keni kërkuar një takim me  
20 përfaqësuesit e UÇK-së, për të diskutuar dy gazetarët e  
21 Tanjug-ut dhe çështje të tjera. A është e vërtetë kjo?

22 PË. Po, atë dhe çështje të tjera.

23 PY. Dhe kjo çoi në takimin që ju e cekët dje dhe sot.

24 Domethënë, takimin e datës 10 nëntor të vitit 1998. Kështu? a

25 PË. Po.

1 PY. Z. Thaçi dhe z. Limajn, e a i keni konsideruar ju si  
2 kryes potencialë përpara, gjatë apo pas takimit?  
3 PË. Përpara takimit, sigurisht që jo. Nuk është se i njihja  
4 as emrat e tyre dhe as gjatë takimit nuk m'u krijua kjo  
5 përshtypje sepse qëllimi i takimit ishte të ishim aty, të  
6 shprehnim shqetësimet tona, të dëgjonim prej tyre, dhe u  
7 larguam nga takimi të inkurajuar nga përfshirja dhe fakti që  
8 kishim krijuar tashmë një urë komunikimi dhe kishim mundësi që  
9 të kishim ngritur çështje shqetësuese për sa i takon aspekteve  
10 të të drejtave të njeriut, me shpresë që do të mbroheshin më  
11 mirë të drejtat e njeriut me kalimin e kohës.

12 PY. Kjo intervistë ndërmjet të tjerash, u kërkua prej jush.  
13 Domethënë, nga Human Rights Watch. Domethënë, ishin ju dhe z.  
14 Bouckaert, në qoftë se nuk gabohem.

15 PË. Po.

16 PY. Ka qenë i pranishëm edhe një përkthyes aty, apo jo?

17 PË. Po, kështu ka qenë.

18 PY. Përkthyesi ka qenë [REDAKTUAR], apo jo?

19 PË. Nuk dua që ta konfirmoj ose ta mohoj këtë gjë, pa marrë  
20 pëlqimin e tij. Nuk dua të shprehem.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
22 seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA I GJYKATËS: [Përkthim] Kaluam në seancë publike, të  
2 nderuar Gjykatës.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të kërkoja që të paraqitet edhe  
4 një herë ky dokument në ekran. Është dokumenti IT-03-66  
5 P212.7. Besoj se është caktuar një numër prove materiale për  
6 këtë dokument.

7 SEKRETARJA I GJYKATËS: [Përkthim] Po, është prova  
8 materiale P375.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Të lutem, paraqite në ekran  
10 shkurtimisht.

11 PY. Kjo është prova materiale P375. Sigurisht, z. Abrahams,  
12 mund ta lexoni, por besoj që e dini se çfarë përmban ky  
13 dokument. Është dokumenti të cilin e diskutuat me z. Tieger  
14 dje. Mban datën 24 tetor të vitit 1998, dhe ky është një  
15 dokument i cili shpreh shqetësime lidhur me ndalimin e  
16 gazetarëve. A është e saktë kjo?

17 PË. Po.

18 PY. Besoj se na thatë dje në përgjigje të disa pyetjeve të  
19 bëra nga Prokurori se metodologjia e Human Rights Watch është  
20 që të shpërndante informacion në sa më shumë burime të jetë e  
21 mundur. Për shembull, media ose persona të cilët potencialisht  
22 ishin të përfshirë, apo jo.

23 PË. Po, kjo është e saktë. Në varësi të kontekstit dhe të  
24 situatës.

25 PY. Në këtë njoftim për shtyp besoj që metodologjia jua ishte

1 që të shpërndahej në sa më shumë media, organe mediatike  
2 në Kosovë. Të paktën në Kosovë, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Përpara takimit tuaj në datën 10 nëntor të vitit 1998  
5 besoj se pranoni ose pajtoheni me atë çfarë po them unë që  
6 kishte shumë informacion që qarkullonte lidhur me ndalimin e  
7 gazetarëve të Tanjugut. Kjo ishte diçka që ishte e njohur nga  
8 komuniteti ndërkombëtar se kishte ndodhur, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Kur shkuat në takim me z. Thaçi dhe me z. Limaj, ky ishte  
11 informacion që e dinit, pra ju shkuat atje dhe thatë që e duam  
12 të diskutojmë për një temë për të cilën kishte dijeni pjesa më  
13 e madhe e njerëzve.

14 PË. Nuk e di për pjesën më të madhe të njerëzve, por ishte  
15 një çështje që dihej nga personat që ndiqnin çështje të  
16 konflikteve të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të të  
17 drejtave të njeriut.

18 PY. Në rregull. Besoj se gjatë bisedave me z. Limaj dhe  
19 Presidentin Thaçi dëshironit që të dinit, të merrnit vesh se  
20 çfarë po ndodhte, apo jo?

21 PË. Po. Dhe në qoftë se kishte shqetësime që lidheshin me  
22 shkeljen e të drejtave të njeriut në këtë rast konkret.

23 PY. Besoj se keni marrë shënime në atë takim lidhur me çfarë  
24 ka thënë President Thaçi dhe z. Limaj, apo jo?

25 PË. Nuk jam i sigurt. Besoj se po, por nuk jam i sigurt.

1 PY. Pra nuk jeni i sigurt se keni marrë shënime?

2 PË. Praktika e zakonshme ishte që të merreshin shënime.

3 Megjithatë, ajo çfarë më kujtohet shumë qartë është që kam  
4 shkruar një memo për shefat e mi pas takimit, duke u shpjeguar  
5 bisedën e ndodhur.

6 PY. Besoj që pajtoheni me mua se arsyeja se pse duhen mbajtur  
7 shënime gjatë intervistës është për të siguruar që ke një lloj  
8 baze, mbështetur në të cilën mund të bëni raporte të tjera  
9 pasuese, apo jo?

10 PË. Unë nuk e quaj këtë takim intervistë. Takimi që  
11 organizuam ne është i ndryshëm nga intervista, se intervistat  
12 i mbledh të dhënat, dëshmi nga viktimat, nga dëshmitarët,  
13 ndërsa në këtë rast konkret nuk më kujtohet në qoftë se kemi  
14 mbajture shënime apo jo, por nuk kemi mbajtur shënime gjatë  
15 takimit. Mbase pas takimit, besoj mbase takimit kam mbajtur  
16 shënime.

17 PY. Z. Abrahams, përpara se të vije sot këtu, a i ke  
18 rishikuar këto shënime?

19 PË. E keni fjalën për kur?

20 PY. E kam fjalën për kohën kur po jepni dëshmi përpara Trupit  
21 Gjykues, për datën 5 shtator dhe 6 shtator.

22 PË. Jo, jo.

23 PY. Pyetjen e kisha për shënimet, a i patë shënimet, a i  
24 rishikuat shënimet përpara se të vinit këtu.

25 PË. Jo.

1 PY. Këto shënime që mund të keni marrë ndërkohë që qëndronit  
2 i ulur dhe po bisedonit me z. Thaçi dhe z. Limaj, për këto  
3 shënime e ke fjalën?

4 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

5 PY. E kam fjalën për shënime që mund të keni marrë gjatë  
6 takimit me këta dy individë.

7 Meqenëse ra fjala, a e kemi parë këtë memon, këtë  
8 raportin që keni shkruar më pas?

9 PË. Jo.

10 PY. Po a ekziston ky dokument?

11 PË. Që ekziston, ekziston, por nuk jam i sigurt që e kam  
12 parë, e kam gjurmuar më pas.

13 PY. Pra, nuk keni kërkuar në qoftë se keni pasur shënime  
14 gjatë atij takimi dhe nuk keni parë apo rishikuar edhe  
15 raportin apo memon që ju thoni që keni shkruar pas takimit,  
16 apo jo?

17 PË. Kam rishikuar materialet e botuara.

18 PY. T'i kthehemi çështjes së shënimeve. Megjithatë, ta lemë  
19 këtë mënjane. Le të shohim pak për këtë raportin, këtë memon  
20 që keni shkruar. Ku e keni kërkuar këtë?

21 PË. Kam kërkuar në arkivin tim digjital, por fatkeqësisht  
22 kërkimi nuk ka shkuar deri në atë kohë sepse kemi përditësuar  
23 sistemet, kanë kaluar thuhetse 25 vjet nga koha kur është  
24 mbajtur takimi dhe besoj që është përmendur edhe këtu që kam  
25 kontaktuar me shefin tim që ka qenë z. Holly Cartner në atë



1 kohë. Ajo ka qenë zonjë dhe e pyeta edhe atë në qoftë se mund  
2 ta gjente këtë raport. Fatkeqësisht me tha që jo.

3 PY. Pra, nuk kemi as shënime, as raportin dhe nuk jeni as i  
4 sigurt në qoftë se keni marrë apo jo shënime gjatë takimit në  
5 fjalë, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. A do ju befasonte po të thosha -- megjithatë ta lë këtu  
8 këtë pyetje. Dua që të shikojmë pak deklaratën e z. Bouckaert  
9 për TPNJ-në.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal, është dokumenti  
11 U0081334 deri në U0081346. Të shohim paragrafin 7 të kësaj  
12 deklarate. Ju kërkoh ndjesë, paragrafi 7, jo 36, mbase e  
13 thashë gabim.

14 PY. Z. Bouckaert thotë si më poshtë. Ai i thotë TPNJ-së, nuk  
15 e di se çfarë date mban dokumenti, pra në vitin 2004 i thotë.

16 Që:

17 "Nuk janë mbajtur shënime me shkrim gjatë takimit..."

18 E shikoni? E lexoni? Pra ai thotë, kolegu juaj thotë që  
19 nuk janë mbajtur shënime dhe këtu përfshihen shënime, apo  
20 dokumentacion që do të vërtetonte këtë takim, sipas kolegut  
21 tuaj, z. Bouckaert.

22 Z. TIEGER: [Përkthim] E kundërshtoj. Transkriptimi është  
23 i qartë, jo domosdoshmërisht është në përputhje me  
24 interpretimin që bëri avokati.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

1 Z. KEHOE: [Përkthim]

2 PY. A pajtoheni me atë çfarë ka thënë kolegu juaj që nuk janë  
3 mbajtur shënime me shkrim gjatë këtij takimi?

4 PË. Kjo është në përputhje me pikëpamjen time. Ju thashë edhe  
5 më herët, që nuk më kujtohet nëse kemi mbajtur shënime apo jo.

6 I vërej komentet e z. Bouckaert. Nuk konfirmoj dot që kemi  
7 mbajtur shënime gjatë atij takimi.

8 PY. Dhe pajtoheni me mua se viti 2004 pa diskutim që është më  
9 pranë ngjarjeve që kanë ndodhur atëherë se sa viti 2023, ku  
10 jemi sot, apo jo?

11 PË. Po, pajtohem me ju.

12 PY. Megjenëse ra fjala, këtë raport, këtë memo, kujt ja  
13 drejtuat?

14 PË. Me siguri do ja kemi shkruar mbikëqyrësit tonë, shefit  
15 tonë, që ishte zonja Cartner, që thashë më përpara, dhe të  
16 cilën e kam kontaktuar siç e thashë. Mund të ketë pasur  
17 mundësi që të kemi kopjuar edhe persona të tjerë, pra persona  
18 të cilët kanë qenë pjesë e organizatës në atë kohë, por nuk më  
19 kujtohet kjo.

20 PY. A i ke pyetur këta njerëzit e tjerë në qoftë se kishin  
21 këto një kopje të këtij raporti?

22 PË. Jo.

23 PY. Këtu thuhet se nuk është marrë asnjë shënim me shkrim.

24 Këtu besoj që përfshihet edhe ky raporti ose memoja për të  
25 cilën ju po flisni, apo jo?

1 PË. Jo, besoj se këtu ai e ka fjalën për shënimet e marra  
2 gjatë takimit.

3 PY. Ajo çfarë thuhet këtu është që nuk është marrë asnjë  
4 shënim me shkrim, nuk është marrë asnjë lloj procesverbali me  
5 shkrim për këtë takim dhe nuk përmendet asnjë raport, nuk do  
6 të përfshihej këtu asnjë raport apo memo që ju thoni që ja  
7 keni dërguar shefit, drejtuesit të institucionit?

8 PË. Kjo pjesë besoj që ka të bëjë me shënimet, por unë e mbaj  
9 mend që kam shkruar një raport, i kam raportuar shefes sa i  
10 takon takimit, përmbajtjes së tij.

11 PY. Këtë raport apo këtë memo që ju pretendoni që ja keni  
12 shkruar shefes tuaj, e keni kërkuar në arkivin e Human Rights  
13 Watch për këtë?

14 PË. Po.

15 PY. Po nuk e gjetët? Nuk e gjetët? Çfarë ndodhi?

16 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk doja që të ndërprisja, por tani  
17 avokati po bën pyetje për të cilat i mori përgjigjet.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është pyetje  
19 që u bë dhe mori përgjigje.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Po e përdor si lidhje me temën  
21 tjetër.

22 Më kujtuan kolegët për një pyetje të fundit. Dua që ta  
23 sqaroj pak pyetjen time. Ju kërkoj leje, në qoftë se më lejoni  
24 që të bëj një pyetje sqaruese.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

1 vazhdoni, ta shohim se si do tingëllojë.

2 Z. KEHOE: [Përkthim]

3 PY. Kur kërkuat në arkiv, kërkuat në arkivin tuaj personal?

4 PË. Po.

5 PY. Pra kërkuat arkivin tuaj personal dhe kërkuat edhe

6 arkivin e Human Rights Watch, kështu? Të dyja?

7 PË. Kryesisht janë një të dyja sepse çdo gjë që unë kam  
8 mbajtur nga puna ime në Kosovë, ose ka trajtuar një mesazh  
9 elektronik, një email, është pjesë e arkivit tim digjital. Dhe  
10 këtu kam kërkuar unë sepse unë kam qenë hulumtuesi kryesor,  
11 përgjegjës për Kosovën në atë kohë.

12 PY. Pra çdo gjë që ti ke pasur është në versionin digjital  
13 tani dhe gjërat që ke pasur në kompjuter nuk i ke më? Kështu i  
14 takon?

15 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

16 PY. Në qoftë se ju thoni që ja keni dërguar të tjerëve, mund  
17 të ndodhë për shembull që të jetë në arkivin e Nju Jorkut.

18 PË. Po, mund të ishte në postën elektronike të njerëzve që ua  
19 kam dërguar, sepse -- që siç thash pra, kam kontaktuar me znj.  
20 Cartner. Unë e pyeta znj. Cartner dhe ajo tha që nuk kishte  
21 gjurmë të këtij dokumenti.

22 PY. Më lejoni që të sjell në vëmendjen tuaj disa tema për të  
23 cilat dhatë dëshmi paradite. Dëshiroj që të shihni dokumentin  
24 që mban numrin e provës materiale P376, që është një raport i  
25 Human Rights Watch.

1           Z. KEHOE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që ta  
2 paraqiste këtë raport në ekran. Prova materiale 376, mbase e  
3 kam gabim unë, por nuk e kam fjalën për këtë raport. Pra,  
4 bëhet fjalë për raportin prej dy faqesh që kolegu kërkoi që të  
5 regjistrohej në provë materiale. Mbase e kam gabim numrin e  
6 provës materiale. Më jepni një çast sa ta kontrolloj, ju  
7 lutem.

8           Është prova materiale 377.

9           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ky është  
10 dokumenti me dy faqe.

11          Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Mendova që ishte  
12 376, por qenka 377.

13          PY. [Mikrofoni çaktivizuar]

14          PË. Ju lutem ndizeni mikrofonin.

15          PY. Faleminderit, unë dhe Gjykatësi Smith e bëjmë herë pas  
16 here këtë gjë. Në këtë raport përfshihet informacion dhe do të  
17 doja që të shfaqet në ekran.

18          Z. KEHOE: [Përkthim] Atë paragrafin për të cilin po  
19 fliste z. Tieger sot paradite. Shfaqeni të plotë në ekran nëse  
20 mundeni. Mendoj se është në faqen 2 të këtij dokumenti. Ky  
21 është dokumenti i saktë, në faqen e dytë në se s'gabohem. Edhe  
22 pak më pas, një faqe më përpara. Në fund, në fund. Këtu, shumë  
23 mirë.

24          PY. Në këtë faqe, pra kjo është faqja, ku ju thoni se:

25          "Në këtë takim UÇK-ja konfirmoi me pas që ata ishin në

1 qendër ndalimi të UÇK-së dhe që ishin akuzuar për spiunazh. Në  
2 fillim të nëntorit dy gazetarët u akuzuan me një dënim prej 60  
3 ditësh në burgun numër 7 të UÇK-së pas një procesi gjyqësor.  
4 Por sipas informacionit të vetë UÇK-së, nuk ishin standardet  
5 ndërkombëtare të procesit të rregullt ligjor...”

6 Atëherë në qoftë se do të shikojmë poshtëshënimin, kam  
7 përshtypjen që është 65 me numër, nëse s'gabohem --

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, jo, në faqen më herët.

9 PY. Ja ku qenka poshtëshënimi 65. Këtu thuhet është  
10 intervista e Human Rights Watch me z. Thaçi dhe z. Limaj më  
11 datë 10 nëntor të vitit 1998. Kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Z. Tieger ju tregoi gjithashtu edhe provën materiale  
14 P378, që është njoftimi për shtyp, ose komunikata e lëshuar  
15 nga UÇK-ja më datë 1 nëntor të vitit 1998.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem, Sekretare, paraqiteni në  
17 ekran këtë dokument.

18 PY. Ky dokument që mban datën 1 nëntor [Sipas përkthimit], që  
19 është dhjetë ditë pasi keni bërë ju takimin me z. Limajn dhe  
20 z. Thaçi, informacioni është i ngjashëm me atë çfarë keni  
21 raportuar ju dhe thuhet që të burgosurit do të transferohen në  
22 burgun numër 7, dhe që të pandehurit dënohen secili me 60 ditë  
23 burgim.

24 Ju mbani mend besoj që në përgjigje të pyetjes së  
25 Prokurorit, ju thatë që nuk e keni parë këtë dokument përpara

1 se të botohej. Besoj se e kishit fjalën për raportin e Human  
2 Rights Watch që pamë në provën materiale 377. Kjo, për  
3 procesverbal përmendet në transkriptimin e ditës së sotme,  
4 rreshtat 20 deri në 21. Ti në përgjigje thua:

5 "Jo, nuk besoj se e kam parë përpara botimit të tij..."

6 A ju kujtohet komunikata?

7 PË. Po.

8 PY. Pra, ju nuk e keni parë këtë dokument përpara botimit të  
9 atij raporti dyfaqësh që pamë më herët, kështu?

10 PË. E thashë, nuk më mbahet mend, nuk e mbaj mend në qoftë se  
11 e kam parë botim apo jo.

12 PY. Dua t'ju tregoj dëshminë e Buckhaer në çështje kundër  
13 Limajt.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal, është dokumenti  
15 DHT01827 deri DHT01940. Dua që të fillojë në faqen 01898. Dhe  
16 nëse mund të fillojmë në rreshtin 3.

17 PY. Kjo është dëshmia e z. Bouckhaert në gjykimin e z.  
18 Limajn, ku thotë:

19 "Përpara se të vazhdojmë të, të kthehemi te ajo që na  
20 thatë ju lidhur me bisedimin për dy gazetarët. Ju thatë "ata",  
21 ata u përgjigjën, po flisnit për dy përfaqësuesit e UÇK-së.  
22 Nëse mundeni na tregoni më qartë, kush po fliste?

23 "PË. Me sa më kujtohet, ata të dy kanë marrë pjesë  
24 aktivisht në këtë bisedë. Të dy kishin njohuri për hollësitë e  
25 gjykimit. Kishim kërkuar konkretisht ndërmjetësit tonë që të

1 organizojë një takim me UÇK-në për të biseduar lidhur me këtë  
2 rast. Besoj që z. Çeliku ishte pjesë e delegacionit të UÇK-së  
3 në këtë takim, sepse ishte përgjegjës Prizreni departamentin  
4 ligjor.”

5 Tani të ndalojmë këtu për një çast. Pajtoheni me z.  
6 Bouckhaert, që z. Çeliku i ka thënë që ishte përgjegjës i  
7 departamentit ligjor dhe jo z. Thaçi. Saktë?

8 PË. Çeliku.

9 PY. Shqiptohet?

10 PË. Po. Ai u prezantua si shefi i departamentit ligjor, apo  
11 gjyqësor. I konsideroj të jenë si të njëjta këto të dyja.

12 PY. Vazhdon pyetja më tej:

13 “Dhe ju thoni që u përmendën akuza dhe më të rënda sesa  
14 spiunimi. A kuptojmë që spiunimi ishte akuza për të cilën këta  
15 persona u shpallën fajtorë?

16 “PË. Po”

17 PË. A mund ta shfaqim më ekran pak më qartë që ta lexoj?

18 PY. Kërkoj ndjesë, unë po e lexoj transkriptimin. Kërkoj  
19 ndjesë do të përpiqem ta mbaj parasysht këtë z. Abrahams.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, vazhdoj të lexoj. Këtu jemi  
21 shumë mirë.

22 PY. Pra, po lexoj nga rreshti 12. Në qoftë se mund ta lexoni  
23 edhe ju, duke filluar prej aty.

24 “Pra, ju thoni që u përmendën potencialisht edhe akuza më  
25 të rënda sesa spiunimi. A kuptojmë nga jo që spiunimi ishte



1 akuza për të cilën këta persona i shpallën fajtorë? Apo është  
2 shpjeguar apo është trajtuar kjo çështje?"

3 "PË. Po. Përmes burimeve tona ne e dinim më parë që këta  
4 të dy persona ishin shpallur fajtorë për spiunim dhe dënuar me  
5 60 vite [Sipas përkthimit] në burgun numër 7 të UÇK-së, që  
6 është burgu për të cilin nuk kishim dijeni dhe nuk -- dhe  
7 vendndodhjen e të cilit nuk e dinim."

8 "PY. Në qoftë se mund të jeni pak më i qartë, ju lutem...  
9 që të jemi pak më të qartë për këtë, kush u tha, kush ju tha  
10 që ata po mbaheshin është burg? Në burgun numër 7?"

11 "PË. Aty ishin. Ne e morëm këtë informacion përmes  
12 gazetarëve në Koha Ditore. Nuk jam i sigurt nëse UÇK-ja lëshoi  
13 deklaratë zyrtare duke konfirmuar këtë gjë apo jo."

14 "PY. --

15 Z. TIEGER: [Përkthim] Z. Avokat, nuk u lexua saktësisht.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Harruat  
17 fjalën "UÇK."

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Më lejoni

19 PY. Pra:

20 "Ne e morëm këtë informacion përmes gazetarëve të Kohës  
21 Ditore. Nuk jam i sigurt nëse UÇK-ja lëshoi deklaratë zyrtare,  
22 duke pohuar po jo këtë gjë."

23 "PY. Që të jemi të qartë, a u përmend në këtë takim burgu  
24 numër 7:"

25 "PY. Nuk jam i sigurt nëse vendndodhja u diskutua.

1 Megjithatë, ne kërkuam pastaj -- do të vazhdoja sipas  
2 kronologjisë së takimit."

3 Tani ju pajtoheni me z. Bouckaert që juve ju treguan  
4 gazetarët nga Koha Ditore që dy gazetarë, të ashtu quajtur  
5 gazetarë, mbaheshin në burgun numër 7.

6 PË. Nuk është se pajtohem apo nuk pajtohem. Nuk kam të  
7 njëjtën kujtesë. Nuk mund të komentoj atë që ka thënë z.  
8 Bouckhaert këtu. Nuk më kujtohet nëse kemi shkuar në atë takim  
9 duke ditur që gazetarët mbaheshin të ndaluar në burgun 7 apo  
10 jo. Më kujtohet që kemi kërkuar të kemi qasje, por nuk më  
11 kujtohet nëse kishim këtë informacion përpara takimit.

12 PY. Faleminderit, por edhe ju ashtu si z. Bouckhaert, jeni i  
13 pasigurt nëse transferimi i të ashtu quajturve gazetarë në  
14 burgun numër 7, është biseduar, diskutuar gjatë këtij takimi.  
15 A është kështu?

16 PË. Nuk më -- është e saktë, nuk më kujtohet që të jetë  
17 biseduar çështje e një burgu numër 7.

18 PY. Nëpër raportet e të drejtave të njeriut të botuar --

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse mund të kthehemi te prova P377.

20 PY. Edhe këtu kalojmë te poshtëshënim 65. Nëse kalojmë në  
21 faqen vijuese, poshtëshënimi 65, është e qartë në këtë  
22 informacion për dënimin me 60 ditë dhe trans -- 65 ditë dhe  
23 transferimin në burgun numër 7, këtë informacion sipas  
24 poshtëshënimit tuaj, thuhet ta keni marrë gjatë takimit me z.  
25 Thaçi dhe z. Limaj.

1 PË. Është pak e vështirë për mua sepse po shoh poshtëshënimin  
2 65 pa pjesën korresponduese të tekstit.

3 PY. --

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse mund të kthehemi te  
5 poshtëshënimi ku është -- poshtëshënimi 65, në faqen  
6 paraprake.

7 PY. Informacionet që kishim ne se:

8 "Përmes përfaqësuesve të UÇK-së gjatë gjykimit ka qenë i  
9 drejtë, të pandehurit nuk janë keqtrajtuar, nuk kanë pasur  
10 përfaqësim ligjor dhe nuk kanë qenë të pranishëm në gjykim.  
11 Kërkesa e Human Rights Watch për t'i vizituar të ndaluarit  
12 është refuzuar për arsye të sigurisë ushtarake, sekretit  
13 ushtarak."

14 Pra poshtëshënimi 65 ka të bëjë me këtë.

15 PË. Nuk jam i sigurt që është e saktë. Poshtëshënimi 65  
16 është.

17 PY. Kthehemi atëherë te faqja paraardhëse. Kthehemi në fund.

18 "UÇK-ja pastaj konfirmoi se ata ishin në ndalim nga UÇK-  
19 ja , përballëshin me akuzat për spiunim. Në fillim të nëntorit  
20 dy gazetarët u akuzuan, u dënuan me 60 ditë burg në burgun e  
21 UÇK-së numër 7, mbas gjykimit i cili sipas informacionit të  
22 UÇK-së nuk plotësonte standardet ndërkombëtare."

23 Nga vinte ky informacion?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë përkthyesve.

25 PY. Në qoftë se mund ta lexoj edhe një herë që përkthyesit

1 t'i kuptojnë e t'i përkthejnë të gjitha.

2 "UÇK-ja pastaj konfirmoi se ata ishin në ndalim të UÇK-  
3 së, përballëshin me akuzat për spiunim. Në fillim të nëntorit  
4 dy gazetarët u dënuan me 60 ditë burg në burgun e UÇK-së numër  
5 7, mbas një gjykimit i cili sipas pranimit nga vetë UÇK-ja,  
6 nuk plotësonte standardet ndërkombëtare të procesit të duhur."

7 Pra, këto informacione nga erdhën? Përgjithshëm e tërheq  
8 këtë. Nga erdhën këto?

9 PË. Kjo fjali nuk është e poshtëshënuar. Ka dy pjesë për t'ju  
10 përgjigjur pyetjes tuaj. Pjesa e dytë bazohet -- ku thuhet se  
11 "bazuar në informacionet e dhëna nga vetë UÇK-ja", kjo mund të  
12 ketë -- duhet të ketë dalë nga takimi, sepse janë informacione  
13 që na janë dhënë neve lidhur me mbrojtjen, të drejtën për  
14 apel, shqetësime të ngritura. Për sa i përket referencës për  
15 burgun 7 të UÇK-së, nuk jam i sigurt. Me sa më kujtohet, nuk  
16 është përmendur në takim dhe pra është e mundur që kjo të ketë  
17 ardhur -- të ketë dalë nga komunikata publike, nga deklarata,  
18 a, nuk më kujtohet saktësisht nga ku e kemi marrë këtë  
19 informacion.

20 PY. Pra është deklarata juaj, qëndrimi juaj që ata nuk e  
21 biseduan për burgun 7 gjatë takimit?

22 PË. Jo. Përgjigja, deklarata ime është që nuk më kujtohet të  
23 kemi biseduar për këtë.

24 PY. Pra pajtoheni me mua për këtë poshtë shënim, që rreshti  
25 që ky nuk përmbushte standardet ndërkombëtare, komunikata

1 pretendohet të ketë dalë nga takimi?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Ju keni përpiluar këtë raport me poshtëshënimet

4 përkatëse, i përgatitur në bazë të atyre gjërave që ju

5 kujtoheshin, sepse gjërat që nuk i dinit në kohën e takimit --

6 a është kështu?

7 PË. Unë do ta përkufizoja ndryshe. Z. Bouckhaert dhe unë kemi

8 biseduar menjëherë pas takimit mbi përmbajtjen e takimit. Ka

9 qenë ngjarje e rëndësishme kjo, s'ka dyshim, dhe -- se më

10 kujtohet deri sot, ka qenë moment i rëndësishëm, relevant.

11 Takohesha me figura të rëndësishme, relevante të UÇK-së dhe

12 kam përgatitur shënimin tim për mbikëqyrësit e mi.

13 Pra, informacionet nga ky takim kam besim dhe -- që

14 gjërat janë kujtuar ashtu siç janë kujtuar dhe siç janë

15 raportuar në raport.

16 PY. Na treguat sesi i keni bërë të gjitha. A është metoda e

17 duhur për Human Rights Watch të dokumentojë takimet duke

18 raportuar pa pasur një vend ku ruhen shënimet?

19 PË. Kjo është në përputhje me praktikën tonë për individët e

20 përfshirë dhe në këtë rast dy, nga hulumtuesit tanë. U është

21 kujtuar takimi në mënyrën siç e kanë vlerësuar të saktë sipas

22 tyre.

23 PY. A është e mundur, z. Abrahams, që ju nuk doni që këto

24 shënime të bëhen të ditura, a të hapta?

25 PË. Arsyerja që i konsideroj shënimet tona të -- si komunikim

1 i privilegjuar, që ndonjëherë nuk mund të ndahet me të tjerë,  
2 është që të na japë mundësi neve që të bëjmë punën në  
3 konflikte dhe në vende rreth botës në mënyrë të sigurt dhe të  
4 saktë, duke respektuar konfidencialitetin e burimeve tona.  
5 Kurdo që kjo kërkohet.

6 PY. Individët në fjalë, për të cilët folët --

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se mund të nxjerrim provën  
8 300 në ekran.

9 PY. Nëse më lejoni, të bëj një pyetje të fundit që del nga  
10 përgjigja juaj paraprake. Meqë ra fjala, a i ke dërguar këtë  
11 shënimin edhe z. Bouckhaert? Atë që ke përpiluar?

12 PË. Nuk më kujtohet.

13 PY. Që të përfundojmë me këtë, tani kemi një raport që po  
14 shohim në vitin 2023. Ku është interesi që të dokumentosh  
15 shkelje nga Human Rights në qoftë se s'ke dokumente për t'i  
16 mbështetur ato?

17 PË. Nuk më kujtohet -- nuk e kuptoj pyetjen. Në vitin 2023?

18 PY. Ju keni një dokument mbi të cilin po jepni dëshmi në këtë  
19 sallë gjyqi duke bërë -- ngritur pretendime për klientin tim.  
20 Pyetja ime është: si është e mundur që Human Rights Watch  
21 hulumton këto gjëra, prodhon raporte për to, pa pasur prova  
22 për ta mbështetur?

23 Z. TIEGER: [Përkthim] Kundërshtim. Këto pyetje janë bërë,  
24 dhe përgjigja është marrë për këtë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] --

1 Z. KEHOE: [Përkthim]

2 PY. Cili është qëllimi, ku është qëllimi?

3 PË. Qëllimi është që të kuptohen fakte dhe të promovohen dhe  
4 të [e pakuptueshme] dhënien, llogaridhënien për krime të  
5 rënda.

6 PY. Dhe kjo përballë paaftësisë tuaj për të gjetur dokumente  
7 që mbështesin këto pretendime? Është e saktë?

8 PË. Është raportimi jonë është publik, dhe kjo bazohet në  
9 këtë raportim publik, për përvojën time profesionale dhe  
10 kujtesën time.

11 PY. Më lejoni të kaloj te ndalimi, pra mbajtja në ndalim dhe  
12 do të kërkoja që të paraqitet prova P300 në ekran, 300. Është  
13 dokument që ka të bëjë me dy gazetarët e pretenduar të Tanjug-  
14 ut. Këtu është shënuar se:

15 "Pasi u dha shenjë atyre që të ndalonin, ata ndaluan pak  
16 me vonesë, duke ju mundësuar atyre që të fshihnin identitetet  
17 e tyre. Kjo çoi -- ngriti dyshime për sa i përket identitetit  
18 të tyre dhe duke mos besuar që ishin gazetarë, pra për  
19 qëllimet e tyre ishte për spiunim."

20 Tani përpara takimit të datës 10 nëntor të vitit 1998, a  
21 ishit në dijeni të -- i njihnit këta individë, në veçanti - që  
22 konkretisht që z. Dobricic ishte në fakt i përfshirë në  
23 aktivitete që kishin të bëjnë me luftën në Republikën e  
24 Krahinës Serbe, dhe zonës së -- krahinës së -- zonës së  
25 Benkovacit, ku janë bërë vrasjet e shumta dhe shumë persona

1 janë shpallur fajtorë. Kishit dijeni për këtë?

2 PË. Kisha -- s'i kisha dëgjuar këto pretendimet dhe nuk e  
3 dija sa ekzistojnë, a janë të vërteta.

4 PY. Ju keni dëshmu -- duke biseduar me personat e tjerë të  
5 vendit e kam fjalën, a ju ka thënë dikush që ka ndërkombëtarë  
6 për krime lufte në ish-Jugosllavi, se personat e konsideruar  
7 kanë -- persona të caktuar kanë menduar se z. Dobriceci ishte  
8 çetnik, fanatik dhe jo vetëm ishte i përfshirë në krimet në  
9 Benkovac, por edhe që ishte i përfshirë në -- transportonte  
10 armë në Bosnjë në vitin 1992.

11 PË. S'kam pasur dijeni për këtë. Nuk e kam dëgjuar këtë.

12 PY. A e keni -- përpara se të bënit bisedime me z. Thaçi e z.  
13 Limajn, a jeni përpjekur të merrni informacione lidhur me  
14 këtë?

15 PË. Ne kemi shkuar në takim pikërisht për të mësuar më shumë  
16 për këtë rast.

17 PY. Shënimi juaj, kolegu juaj ka përmendur atë që kishte  
18 lexuar në artikull gazete lidhur me këto ngjarje për të cilat  
19 po flasim. Artikull më duket që ishte nga i datës 1 nëntor.

20 Z. TIEGER: [Përkthim] Kundërshtim i lehtë por nuk besoj  
21 që kjo gjendet në transkriptim. E ka marrë vesh nga gazetarë.

22 Z. KEHOE: [Përkthim]

23 PY. Kolegu juaj ka shënuar -- ka thënë në dëshminë e tij që  
24 kishte marrë vesh për burgun numër 7 dhe ndalimin aty nga  
25 gazetarë, nga gazetarë të tjerë. Tani, ju a keni ndërmarrë



1 diçka për të mësuar se kush ishin këta dy persona, duke  
2 biseduar me gazetarë apo persona të tjerë.

3 PË. Ne kemi shkuar në takim duke shfrytëzuar mundësinë për  
4 t'u përpjekur për të marrë vesh më shumë se kush ishin këta.

5 PY. Nuk keni pyetur asnjë person tjetër. Për shembull nga ana  
6 serbe apo nga ana shqiptare e Kosovës. Kush ishin këta  
7 persona?

8 PË. Ne kemi pyetur dy personat që morën pjesë në takim.

9 PY. E kam fjalën përpara takimit, përpara se të shkonit në  
10 takim. A keni pyetur, biseduar me dikë. Le të fillojmë me këdo  
11 nga pjesa serbe. Nga agjencia Tanjug, për t'i pyetur kush  
12 ishte Dobrocici.

13 PË. Nuk -- jo, nuk më kujtohet të kemi bërë biseda lidhur me  
14 të kaluarën apo historikun e individëve.

15 PY. Pra nuk keni bërë asnjë telefonatë, për shembull  
16 gazetarët e tjerë, për t'i pyetur, për të zbuluar kush ishin  
17 këta persona.

18 PË. Jo, nuk më kujtohet ta kem bërë.

19 PY. Pra keni shkuar në këtë takim, keni biseduar me këta  
20 persona, dhe nuk e kishit idenë se Dobreçiçi ishte --

21 pretendohej nga Gjykata Ndërkombëtare të ishte i përfshirë në  
22 krime.

23 PË. Në atë moment jo.

24 PY. Dhe pajtoheni me mua që dyshimet që ka këta persona ishin  
25 të përfshirë në krime do të kishin justifikuar mbajtjen e tyre

1 në ndalim?

2 PË. Duhet të bëj një dallim mes akuzave kundër tyre dhe  
3 provave për të mbështetur ato akuza. Besoj që është pikë e  
4 rëndësishme.

5 Ka një dallim në punën time mes akuzave dhe provave për  
6 të mbështetur këto akuza dhe procesit të duhur gjyqësor.  
7 Shqetësimi ynë ishte ky i fundit.

8 PY. Ju kuptoni që kur dikush është i dyshuar, autoritetet që  
9 e mbajnë të ndaluar kanë një periudhë të caktuar kohore për të  
10 vërtetuar kush janë këta persona dhe çfarë po bëjnë.

11 Pajtoheni?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe po ashtu kuptoni, le të themi kur keni udhëtuar ju në  
14 zonat e kontrolluara nga -- UÇK-së, keni marrë një lejkalimi  
15 nga z. Demaçi.

16 PË. E saktë.

17 PY. Sipas asaj që dinit ju, këta dy personat që udhëtonin nuk  
18 kishin udhëzim nga z. Demaçi?

19 PË. Nuk kam pasur informacion lidhur me këtë, nuk na është  
20 thënë neve por pranoj që mund të mos kenë pasur.

21 PY. A keni pyetur ju njerëzit e tjerë përveç z. Thaçit dhe z.  
22 Limaj? Me sa duket nuk keni bërë një gjë të tillë, nëse këta  
23 persona kishin një autorizim nga z. Demaçi për të lëvizur në  
24 zonat e UÇK-së.

25 PË. Nuk kundërshtoj që ata mund të mbaheshin të ndaluar për

1 akuza spiunimi apo të tjera.

2 PY. Keni në këtë shënuar që z. Limaj u identifikua si një  
3 përfaqësues ligjor.

4 PË. Shefi i drejtorisë ligjore.

5 PY. Ndërsa z. Thaçi nuk u identifikua përveç si përfaqësues  
6 politik.

7 PË. Jo besoj që ka qenë shefi i drejtorisë politike.

8 PY. Do ta shohim saktësinë e kësaj më vonë, por është fakt,  
9 zotëri, që ju thonë që gjatë bisedimeve ai ka qenë -- mbajtur  
10 qëndrimin e tij që kjo ishte çështje civile, apo jo?

11 PË. Ka disa -- ka pak ngatërresë lidhur me këtë, sepse termi  
12 civil dhe ushtarak përdoret në të dyja anët pak a shumë. Me sa  
13 më kujtohet mua, në një moment të caktuar ata thanë që nuk  
14 mund të ndërhyjnë në procesin gjyqësor civil. Por nga ana  
15 tjetër, u përmendën gjykata ushtarake, procedura ushtarake dhe  
16 deklaratat në vijim pastaj u lëshuan nga me referenca  
17 ushtarak. Pra ishte pak e ngatërruar kjo.

18 PY. Saktësisht dhe z. Thaçi ju tha juve që nuk do të  
19 përfshiheshin në çështje civile. Pra është e saktë?

20 Dhe në qoftë se nxjerrim provën P378 në ekran, që është  
21 një artikull i datës 1 nëntor i vitit 1998. Ju lutem. Ju e  
22 keni lexuar këtë apo jo?

23 PË. Po, e kam lexuar sot këtu.

24 PY. Në qoftë se lexoni rreshtin e parë, thotë:

25 "Gjykata Ushtarake e Drejtorisë së Shtabit të

1 Përgjithshëm të UÇK-së...”

2           Është fakt që z. Thaçi nuk e dinte nëse kjo ishte  
3 procedurë ushtarake apo civile, apo jo?

4 PË. Nuk mund të prononcohem nëse e dinte apo jo.

5 PY. A ju përmendi juve çështje civile dhe në këtë dokument që  
6 është paraqitur nga Prokuroria bëhet fjalë për çështje  
7 ushtarake, apo jo?

8 PË. Siç e thashë, mendoj që e ka pasur një ngatërresë dhe  
9 mesazhe të ngatërruara, të -- kundërthënëse, sepse nga njëra  
10 anë bisedohej, përmendej fakti që UÇK-ja mund t'i mbante të  
11 ndaluar këta individë, dhe nga ana tjetër që thuhej që këta --  
12 UÇK-ja nuk mund të merrte të ndërmernte hapa apo të ndërhynte  
13 në një proces civil. Pra kishte një lloj kundërthënie,  
14 kundërshtimi këtu.

15 PY. Po flas për z. Thaçi, thatë që ju tha -- ju thoni që ai  
16 ju tha nuk do të përfshihej në çështje gjyqësore civile. Thaçi  
17 e tha këtë.

18 PË. Po, për të respektuar pavarësinë e gjyqësorit. Kjo është  
19 ashtu siç më kujtohet mua.

20 PY. Dhe kjo P378, këtu në këtë dokument flitet për gjykatë  
21 ushtarake, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe tani që jeni këtu, është e qartë se pavarësisht temës  
24 për të cilën po bisedonit me Thaçin, duke u nisur nga parimi  
25 që ajo -- supozuar që ajo që po thoni ju është e saktë, ai nuk

1 e dinte nëse kjo ishte gjykatë ushtarake apo civile.

2 PË. Është -- nuk mund ta di a dinte apo nuk e dinte.

3 PY. Me sa -- e ka folur për këtë në hollësi lidhur me këtë?

4 PË. Nuk më kujtohet që kjo ishte çështje më e rëndësishme e  
5 bisedës

6 PY. Kthehemi pak te ky dokument.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Prova 378, nëse mund ta shfaqni në  
8 ekran.

9 PY. Ju dhe z. Bouckhaert, a e pyetët z. Thaçin pse po  
10 përmendte gjyqësorin civil ndërkohë që UÇK-ja e kishte 10 ditë  
11 më parë qartësisht që kjo ishte çështje ushtarake? A ju  
12 kujtohet?

13 PË. Nuk më kujtohet të kem pyetur për këtë gjë në veçanti,  
14 por më kujtohet që kemi pasur bisedë të hollësishme për sa i  
15 përket procedurave gjyqësore. Se këta të -- dhe këta të dy  
16 persona kishin informacione të hollësishme konkrete për këtë  
17 çështje.

18 PY. z. Abrahams, a pajtoheni që çështja ju janë -- vetë e  
19 pranuat që janë dy versione, ku është zhvilluar këto  
20 procedura, ky proces. Është ushtarak apo civil dhe qëndrimi i  
21 Thaçit është që është civil?

22 PË. Ashtu siç e kam kuptuar unë atëherë, ata ishin të ndaluar  
23 në ndalim ushtarak dhe komunikata e lëshuar pastaj është në  
24 përputhje me këtë.

25 PY. Dhe klienti im në bisedën me ju nuk e dinte që ata ishin

1 në ndalim ushtarak, të ndaluar nga ushtria.

2 Z. TIEGER: [Përkthim] Kundërshtim, besoj që mund të themi  
3 që pyetja është bërë tashmë dhe i është dhënë përgjigje disa  
4 herë.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Do kaloj te një pjesë tjetër.

6 PY. Në mes të kësaj bisede për të cilën ju s'keni shënime,  
7 është përmendur, keni diskutuar për gjërat që kanë ndodhur  
8 gjatë luftës, që ka përmendur z. Thaçi, saktë?

9 PË. Saktë.

10 PY. Ai po ashtu tha se strukturat e gjyqësorit kërkojnë kohë  
11 që të krijohen. Ta tha, apo jo?

12 PË. Një ose dy prej tyre mbase e thanë.

13 PY. Po kush e tha?

14 PË. Po nuk më kujtohet saktësisht. Po e tha dikush dhe pastaj  
15 u pajtuam të dy.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirë, shohim atëherë deklaratën e  
17 Bouckhaert. Është paragrafi 36.

18 PY. Në këtë moment Thaçi shpjegon që UÇK-ja ishte ushtri e  
19 re, po formatizonte strukturën e vet. Këtë ka qenë z. Thaçi,  
20 pra?

21 PË. Pajtohem.

22 PY. Dhe ai madje ua vuri në dukje sa e vështirë është të  
23 krijosh struktura gjatë luftimeve që ishin në vazhdimësi e  
24 sipër me serbët. Kështu?

25 PË. Saktë.

1 PY. Flasim për dhjetorin e vitit 1998.

2 PË. Nëntor.

3 PY. Po, nëntor, nëntori i vitit 1998. Dhe të jemi të  
4 singertë, UÇK-ja kishte pasur një situatë shumë të vështirë  
5 nga korriku e gushti, shtatori, tetori deri në momentin që u  
6 arrit armëpushimi Holbrooke-Milosheviç.

7 PË. Po.

8 PY. Nga pikëpamja ushtarake situata është shumë e vështirë  
9 për një grup ushtarak që është duke luftuar.

10 PË. E pranoj që situata ka qenë e vështirë, kushtet kanë qenë  
11 të vështira.

12 PY. A e dini sa, sesa shumë dhe sa kohë duhet që të krijosh  
13 sisteme gjyqësore.

14 PË. Përvojë personale nuk jap dot për krijimin e mekanizmave  
15 të gjyqësorit në një mjedis të tillë, por ama e pranoj që  
16 është e vështirë.

17 PY. Ju e dini këtë se ju bëni -- punoni në gjithë botën, ju e  
18 dini që në një lëvizja siç ishte UÇK-ja duke u krijuar, pra u  
19 krijuar në vitin 1997, 1996 mbase. U forcua edhe më tej pas  
20 vrasjes së familjes së Jasharit. Pra po flasim për një  
21 periudhë të shkurtër kohore. Është shumë e vështirë të krijosh  
22 një strukturë siç duhet në një kohë kaq të shkurtë dhe ajo çka  
23 ndodh zakonisht gjatë luftimeve, e lemë mënjanë tani ato që  
24 kanë ndodhur në ICTY. Këto lloj gjyqe ndodhin pasi ka mbaruar  
25 lufta, apo jo?

1 PË. Vështirësia e krijimit të mekanizmave të gjyqësorit  
2 padyshim që është e konsiderueshme, dhe sigurisht që kjo nuk i  
3 zhvesh palët nga detyrimi që kanë për të respektuar të drejtat  
4 e të burgosurve. Këtë kemi dashur të theksojmë.

5 PY. Dakord, është marrë parasysh, por po flasim që ndonjëherë  
6 është e vështirë gjatë një lufte, dhe është -- po ndodhte --  
7 dhe këto zakonisht ndodhin, këto kryhen pasi përfundojnë  
8 luftimet, kështu?

9 PË. Do të thosha, do të përgjigjesha ndryshe. Kur thua  
10 kryesisht, varet nga konteksti. Situata ku disiplina  
11 respektohet nga grupe të caktuara menjëherë, dhe sigurisht që  
12 ka rrethana ku bëhen disa tolerime, por ne jemi një organizatë  
13 e të drejtave të njeriut. Ajo që shohim ne është -- ne duam të  
14 shohim përpjekje që grupet po ecin në drejtimin e duhur, ku  
15 përfshihen hetimi apo heqja e personave nga funksionet e tyre  
16 apo të merren hapa për të garantuar që këta persona nuk do të  
17 jenë në pozicion për të abuzuar me detyrën.

18 PY. Flasim për periudhën kohore kur keni pasur bisedën me z.  
19 Thaçi dhe z. Limaj, që ka qenë në nëntor i vitit 1998, që  
20 ishte gjatë luftës. Pajtohemi që s'kishte ligje, as prokurori,  
21 as gjykata, as një lloj strukturë civile asokohe që ta  
22 përdorte UÇK-ja, përveç institucioneve të Milosheviçit,  
23 gjykatave të Milosheviçit, për të gjykuar personat që  
24 dënoheshin për vepra penale.

25 PË. Po me këtë pajtohem.



1 PY. A mendoni ju se UÇK-ja në fakt -- apo thoni ju -- më  
2 falni pra, a po thoni ju që UÇK-ja kishte ligje ku mund të  
3 mbështeste hetimet dhe ndjekjet penale dhe nëse po, cilat  
4 ligje qenkan këto?

5 PË. Po, nuk pajtohem --

6 PY. Jo nuk ke si të mos pajtohesh, sepse unë po të bëj  
7 pyetje. Përgjigju.

8 PË. Informacioni që kemi marrë ne në atë takim përfshinte  
9 edhe faktin -- na thanë që ekzistonte një kod etik. Për  
10 shembull, ne i thamë na e tregoni, se kodi sipas informacionit  
11 që na dhe ne ishte baza mbi të cilën mund të disiplinoheshin  
12 pjesëtarët e UÇK-së e mund të trajtoheshin shpërdorimet e  
13 detyrës.

14 PY. Z. Abrahams, keni ndonjë ide se çfarë hapash kishte marrë  
15 Shtabi i Përgjithshëm për të krijuar një sistem të gjyqësorit  
16 në vitin 1998 dhe 1999?

17 PË. Ky është një informacion që e kemi kërkuar në takim dhe  
18 thjeshtë na thanë që është duke u krijuar.

19 PY. Po them me sa dini ju, keni kaluar kohë në Kosovë dhe në  
20 Shqipëri. Sot, këtu në vitin 2023, a e ke idenë çfarë hapash  
21 ka ndërmarrë Shtabi i Përgjithshëm për të krijuar sisteme  
22 gjyqësore në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore. Çfarë hapash  
23 ka ndërmarrë?

24 PË. Kam disa informacione.

25 PY. Çfarë hapash?

1 PË. Ata si fillim hartuan kodin e etikës. Unë s'e kam parë,  
2 pro konfirmoj -- dhe nuk mund të konfirmoj që ka ekzistuar,  
3 dhe gjithashtu, ata kishin krijuar gjykata ushtarake, sipas  
4 deklaratave të tyre. Ekzistonte një drejtori juridike, apo  
5 departament ose drejtori juridike pranë Shtabit të  
6 Përgjithshëm. Pra nga sa kuptova unë, bazuar në informacion që  
7 na dhanë ata është se ekzistonin gjykata dhe po ashtu  
8 ekzistonte policia ushtarake. Sepse unë u ndesha me disa prej  
9 tyre, u takova me disa prej tyre gjatë udhëtimeve të mia.

10 PY. Pra kishin ndërmarrë hapa në vitin 1998, për të trajtuar  
11 disa nga këto problematika.

12 PË. Hapat që sapo përmenda janë ato që më thanë. Se si  
13 funksionin nuk mund të flas, nuk mund të them asgjë.

14 PY. Fiks, fiks. Dhe po flasim për komandantët e zonave  
15 operative që duhet t'i bindeshin atyre që lëshonin Shtabi i  
16 Përgjithshëm. Ky është aspekti fundamental.

17 PË. Po.

18 PY. Pra, në qoftë se komandantët e zonave operative  
19 ndonjëherë nuk i respektonin urdhrat që vinin nga Shtabi i  
20 Përgjithshëm, kjo e bënte edhe më të vështirë krijimin e një  
21 sistemi gjyqësor.

22 PË. Pajtohem.

23 PY. Dhe kur ke një person si Rrustem Mustafa, komandant Remi,  
24 dhe kemi dëshminë e tij në 5752, 22 deri në 5753, deri në 5 --  
25 kur ai tha që "Unë i thosha që të mos i trajtonin këtë çështje

1 se unë nuk do ju bindesha lidhur me këtë aspekt.”

2 Pra kur ke një komandant të zonës operative që refuzon t'i  
3 bindet Shtabit të Përgjithshëm, apo diçkaje, një dokumenti që  
4 vinte nga Shtabi i Përgjithshëm, situata bëhet problematike. A  
5 nuk bëhet problematike? Pastaj ndonjëherë kjo e bën të  
6 vështirë të kesh një sistem gjyqësori funksional?

7 PË. Pajtohem.

8 PY. Tani flasim për takimin që keni pasur me z. Thaçin. Besoj  
9 në gusht të vitit 1999?

10 PË. Besoj se po.

11 PY. Atij i dhatë një dokument lidhur me diçka që ju e  
12 perceptonit abuzime lidhur me ato që po ndodhnin në Kosovë pas  
13 luftës.

14 PË. Abuzime që ne i kishim dokumentuar përmes hulumtimeve të  
15 thelluara.

16 PY. Gjatë kësaj periudhe kohore. Jo e tërheq pyetjen. Është  
17 fakt, dhe ju e dini rezolutën e OKB-së 1244.

18 PË. Po.

19 PY. Jam i sigurt. Jam i sigurt, dhe subjekti që ishte bërë  
20 përgjegjës për hetimet arrestimin, ndjekjen penale dhe  
21 arrestimin e keqbërëseve, apo atyre që -- kryesve ishte UNMIK-  
22 u. Asnjë organ tjetër nuk kishte përgjegjës të hetonte, të  
23 ndiqte penalisht apo të burgoste persona, kështu?

24 PË. E saktë.

25 PY. Kështu që kur shkove te ata dhe ju dhe këtë raportin,

1 përgjegjësitë e tij për qeverinë e përkohshme të Kosovës ishte  
2 thjeshtë e UNMIK-ut, pra ishte UNMIK-u që e kishte  
3 përgjegjësinë? Përgjegjësinë ligjore.

4 PË. Periudha kohore ishte e vështirë ishte e komplikuar dhe  
5 ke të drejtë. Është Rezoluta 1244 i jepte UNMIK-ut  
6 përgjegjësinë që të kryente hetime, ndjekje penale, burgime, e  
7 kështu me radhë. Por ne shkuam te z. Thaçi sepse ishte kreu i  
8 Qeverisë së Përkohshme, duke pasur parasysh autoritetin që  
9 kishte ai dhe kompetencat që kishte marrë në këtë pozicion të  
10 përkohshëm që pati.

11 PY. Okej, të flasim pak për këtë. Në gusht të vitit 1999  
12 Qeveria e Përkohshme e Kosovës nga pikëpamja ligjore s'ka  
13 pasur asnjë kompetencë, saktë?

14 PË. Nga pikëpamja ligjore jo.

15 PY. Pra, në gusht, po e përsëris edhe një herë, i vetmi  
16 autoritet ligjor, i vetmi, ishte UNMIK-u. Kështu?

17 PË. Kështu. Edhe ne ishim shumë më të rinj se ç'jemi tani në  
18 vitin 1999.

19 PY. Dhe z. Thaçi s'kishte asnjë përgjegjësi ligjore  
20 përkundjet jush?

21 PË. Askush s'ka përgjegjësi ligjore për mua si individ apo  
22 për organizatën time, që është një OJQ. Po ne thjesht - kam  
23 përgjegjësi përballë të drejtës vendase dhe ndërkombëtare.

24 PY. Me sa dini ju, z. Thaçi e mori raportin tuaj dhe a dha  
25 UNMIK-ut apo KFOR-it?

1 PË. S'e di këtë.

2 PY. Në qoftë se ai e mori këtë raport dhe ja dha UNMIK-ut apo  
3 KFOR-it, atëherë ata duhet të merrnin masa.

4 PË. Po, por edhe ne ja kemi dhënë një kopje të raportit  
5 UNMIK-ut dhe KFOR-it.

6 PY. Po ju pyes diçka tjetër. Gjatë kohës që keni qenë në  
7 Kosovë e keni ndeshur edhe Ambasadorin Kouchner? Ka qenë një  
8 përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm, Ambasador Covey?  
9 Asistentin?

10 PË. Emrin e kam dëgjuar por s'e kam takuar ndonjëherë.

11 PY. Edhe Gjeneralin Mike Jackson, që ka qenë përgjegjës për  
12 KFOR-informacion?

13 PË. Po.

14 PY. Gjatë kohës që keni qenë atje, a morët ndonjë  
15 informacion, ndonjë indicie në qoftë se z. Thaçi është kërkuar  
16 nga z. Covey, Kouchner, Gjenerali Jackson, apo ndonjë vartësi  
17 i tyre? I është kërkuar z. Thaçi të bëjë ndonjë gjë nga këta  
18 persona dhe ai e refuzoi?

19 PË. Nuk di të them për këtë.

20 PY. Pra me sa dini, gjatë kësaj periudhe kohore, Thaçi shkon  
21 dënon dhunën, kështu?

22 PË. Publikisht foli për sulmet kundër serbëve.

23 PY. Ka folur disa herë.

24 PË. Po, po. Besoj se po.

25 PË. Në të njëjtën periudhë kohore nuk ka asnjë informacion

1 nga një person si ju që monitoronte të drejtat e njeriut, që  
2 z. Thaçi të ketë refuzuar diktimin apo zbatimin e kërkesave që  
3 vinin nga UNMIK-u, KFOR-i apo nga çdo vartës prej këtyre dy  
4 organeve.

5 PY. Unë nuk mund të flas për bisedat që ka pasur ai me UNMIK-  
6 un, me KFOR-in apo me çdo organizatë tjetër.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj një çast.

8 [Mbrojtja këshillohet]

9 Z. KEHOE: [Përkthim] E di që është shumë herë më shkurt  
10 se ç'kisha parashikuar në fillim, por thjesht dua të them, z.  
11 Abrahams, që nuk kam më pyetje.

12 PY. Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
14 fjala është për ju.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më jepni një çast sa të  
16 organizohem.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Për të mbrojtur z. Emmerson, unë i  
18 kisha thënë që do të më duhet shumë kohë, kështu që ndjej  
19 ndjen nevojën që ta justifikoj pak.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

21 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

22 Z. EMMERSON: [Përkthim]

23 PY. Z. Dëshmitar, dua t'ju bëj disa pyetje të përgjithshme  
24 për rolin e Human Rights Watch në situata ku ka konflikt, edhe  
25 rolin tuaj aktual, sa i takon trajnimit të hulumtueseve, sepse

1 supozoj mund të na tregoni diçka çfarë u thoni ju personave,  
2 si duhet të jetë një hetim i mirë për të drejtat e njeriut. Së  
3 pari, disa herë përshkruat punën e Human Rights Watch ku  
4 përfshihej edhe funksionit i advokacisë. A mund të na  
5 shpjegoni, çfarë nënkuptoni ju me funksion advokaci?

6 PË. Mandati ynë dhe synimi ynë është të promovojmë politika  
7 të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut.

8 PY. Politika juridike apo politika politike apo praktike  
9 politike në terren kur i zbaton goftë në nivel të OKB-së apo  
10 në nivel OJQ-sh apo në nivel qeveri.

11 PË. Të gjitha.

12 PY. Ngritja e alarmit, në një farë mënyre t'i biesh kabanave  
13 të alarmit, është një pjesë e procesit të advokacisë apo jo?

14 PË. Të njoftosh politikëbërësit publikë është pjesë e punës  
15 sonë.

16 PY. Kur thoni situata serioze për të drejtat e njeriut, e  
17 keni fjalën se ka shqetësime se mund të ketë shkelje të të  
18 drejtave të njeriut? Përmasa e tyre e kështu me radhë, apo  
19 doni të thoni që ju si organizatë keni përcaktuar se të  
20 drejtat e njeriut, të një sërë viktimash, janë shkelur nga një  
21 palë e konfliktit apo nga tjetra?

22 PË. Po përpiqem ta kuptoj pyetjen tuaj.

23 PY. Po e përsëris: "Situatat që lidhen me të drejtat e  
24 njeriut" është një shprehje shumë e vagullt, dhe unë po  
25 përpiqem të më shpjegosh çfarë nënkupton një situatë lidhur me

1 të drejtat e njeriut për të cilat do të donit të rrisnit  
2 ndërgjegjësimin e komuniteti ndërkombëtar. Nga një anë është  
3 informacioni i parë që keni marrë, diçka që një palë i bën një  
4 pale tjetër. Por është shumë e vështirë në këtë fazë që të  
5 vërtetosh në qoftë se informacioni është i saktë, duhet të  
6 bësh hulumtime të mëtejshme. Dhe këtu hynë në lojë hulumtimi.  
7 PË. Saktë.

8 PY. Dhe një pjesë tjetër e procesit mund të jetë një situatë  
9 kur ke informacion të mjaftueshëm që besoj që duhet të jetë  
10 shumë konkret, duhet të keni informacion të mjaftueshëm për të  
11 akuzuar një person për krime lufte, dhe ndonjëherë kërkohet  
12 edhe informacion -- jepet edhe informacion konfidencial  
13 organeve hetimore ndërkombëtare. Pra, a ju keni dhënë ju një  
14 listë me persona, personash, Zyrës së Lartë të Komisionerit të  
15 OKB-së, ose fundja edhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare? Keni  
16 dhënë ndonjë listë të tillë?

17 PË. Jo, jo. Ne mund të bëjmë një punë kaq konkrete, por për  
18 të bërë akuza ndaj individëve duhet të kemi standarde apo  
19 pragje shumë herë më të larta se kaq.

20 PY. Pra, ju nuk po bëni akuza kundër asnjë personi në këtë  
21 çështje gjyqësore, ju nuk po ngrini asnjë akuzë kundër ndonjë  
22 personi konkret që të ketë kryer ndonjë krim.

23 PË. Jo, jo. Nuk po e bëj këtë gjë.

24 PY. Kur u mësoni studentëve, z. Abrahams, lidhur me rolin e  
25 Human Rights Watch, a ju thonin ju siç na thatë edhe ne sot



1 paradite, që nuk jemi të përfshirë, nuk jemi gjykatë dhe as  
2 nuk bëjmë hetime penale?

3 PË. Saktë.

4 PY. Tani të shohim dallimin mes përfshirjes në një çfarë  
5 është një funksion gjyqësor dhe çfarë bëni ju konkretisht. Ta  
6 shohim konkretisht dallimin e këtyre të dyjave. Së pari, sipas  
7 jush Human Rights Watch ka funksione quasi gjyqësore?

8 PY. Jo.

9 PË. Ju si organizatë jeni të përgatitur të dilni me vendime  
10 të formës së prerë të kësaj forme?

11 PY. Nuk e di çfarë doni të thoni me të "formës së prerë".

12 PË. Ju jeni i gatshëm të thoni se sa i takon vitit 1998 dhe  
13 këtij konflikti, ju thoni që komandanti i zonës në liqenin  
14 Radoniq në zonën e Dukagjinit duhet ta ketë ditur për  
15 ekzekutimin dhe vendngjarjen e një ekzekutimi të rreth 30-40  
16 personave. Duhet ta ketë ditur.

17 Do ta tregoj unë pas pushimit të drekës, por e ke thënë.

18 PY. Po duhet ta shoh para se të përgjigjem.

19 PË. Kemi pushimin për dhjetë minuta, prandaj nuk doja ta  
20 tregoja tani, por pas drekës do ta tregoj unë. Pra me sa  
21 kuptoj unë ju i keni nënshkruar këto raporte, dhe pretendoni -  
22 - jo pretendoni, por e thoni si fakt, që komandanti i zonës së  
23 -- i regjionit të Dukagjinit, duhet ta ketë ditur atë që ju  
24 përshkruani si një nga masakrat më të mëdha që ka kryer UÇK-ja  
25 në vitin 1998. Konkretisht është bërë një ekzekutim aftër

1 [sipas përkthimit] Liqenit të Radoniqit në Dukagjin, ku janë  
2 vrrarë 30-40 persona.

3 PY. Kush është pyetja juaj?

4 PË. Pa e parë dokumentin s'ta bëj pyetjen, por dëgjoje këtë.

5 E kam referencën por unë po ta them -- merre për të mirëqenë  
6 që e ke thënë, më beso që e ke thënë, dhe unë dua të kuptoj  
7 nga ndryshon funksioni yt nga një funksioni gjyqësor. Pra a  
8 keni ju funksionin e një quasi gjyqësori, apo bëni ju një  
9 hetim penal? A pajtoheni ju me mua se çdo hetim që duhet kryer  
10 dhe që ta pranojë një gjykatë, ta autorizojë një gjykatë,  
11 duhet të fillojë me presumimin e pafajësisë, të respektohet  
12 fillimisht presumimi i pafajësisë.

13 PË. Po.

14 PY. Po, dhe të drejtat e njeriut janë një gjë e madhe për një  
15 gjyq të drejtë kështu që çdo gjë që është cenim i prezumimit  
16 të pafajësisë duhet të dënohet nga Human Rights Watch, në  
17 qoftë se do ta kishte bërë këtë një shtet.

18 PË. Po.

19 PY. Dhe të deklaroj që dikush është fajtor për një sërë  
20 krimesh, pa kurrfarë hetimi të fakteve dhe kur personi në fakt  
21 në të vërtetë është i pafajshëm, kjo është një shkelje e  
22 parimeve nga Human Rights Watch, këto parime që të cilat i  
23 mishëron kaq shumë dhe që i thekson kaq shumë?

24 PË. Do më duhet të shihja materialin të cilin ju po përmendni  
25 në mënyrë që të jap komente.

1 PY. S'është nevoja se e dhe përgjigjen, megjithatë, në këtë  
2 pak kohë që na ka ngelur, do të shoh mundësinë që ta shfaqim  
3 në ekran.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më duket se nuk është pranuar  
5 ende, nuk e kam marrë numrin e provës materiale, por i është  
6 treguar dëshmitarit. Është K036-0808 deri në K036-1247, dhe  
7 konkretisht është faqja ku është vula - 0935.

8 PY. Është tetori i një raporti -- i tetorit i vitit 2001, ku  
9 thuhet "Krimet e Luftës në Kosovë" dhe mbulohet i gjithë  
10 konflikti. Dhe këtu trajtohen edhe krimet që pretendohet se i  
11 ka kryer UÇK-ja në vitin 1998. Të shohim nëse ka dalë në  
12 ekran. Më duket se kjo nuk është faqja e saktë. Duhet të jetë  
13 faqja 0934, 0935. Do shohim pak më vonë 0934, por të shohim  
14 për një çast 0935, faqja 101. Është një paragraf këtu, të  
15 shohim dhe si ka ndryshuar me kalimin e kohës gjërat, por  
16 flasim për vitin 1998:

17 "Duke parë ndarjen rajonale brenda UÇK-së, një zinxhir  
18 komandimi ishte qendëruar, ishte e vështirë të krijohet. Edhe  
19 në zonat operative nuk ishte gjithmonë e qartë se sa kontroll  
20 kishin komandantët e ndryshëm..."

21 Do të fillojmë me këtë. Gjatë kësaj periudhe deri në fund  
22 të vitit 1998, ju po thoni që ka pasur ndarje rajonale dhe  
23 këtu ke ndarë edhe zonat e ndryshme. Saktë?

24 PË. Po saktë.

25 PY. Dhe ju po jepni edhe pikëpamjen tuaj që në vitin 1998

- 1 ishte e vështirë që të kishte që të dallohej një komandë  
2 qendrore. Saktë?
- 3 PË. Saktë.
- 4 PY. Po nuk ishte e vështirë në nivel rajonal?
- 5 PË. Më pak e vështirë.
- 6 PY. Po, pra, vështirë mbetej të merrej vesh në qoftë se ishte  
7 kryer një krim, me urdhër të komandantit të zonës, apo nën  
8 kompetencat e komandantit të zonës, ndoshta ndonjëherë edhe ka  
9 ndodhur, saktë?
- 10 PË. Varej nga --
- 11 PY. Nga rrethanat, e kuptoj. Po mbi komandantët e zonave, në  
12 vitin 1998, ju keni dalluar që të ketë pasur ndonjë komandë  
13 qendrore?
- 14 PË. Jo, nuk pajtohem.
- 15 PY. Do flasim për këtë pas drekës, por ama pajtoheni që ishte  
16 e vështirë të dallohej apo të kishte një komandë qendrore.  
17 Ishte e lehtë.
- 18 PË. Jo, ishte e vështirë.
- 19 PY. Se më duket sikur po përpiqeni t'i mbuloni disa nga  
20 gjërat, kështu që përpiquni thjesht t'i përgjigjeni pyetjeve  
21 të mia.
- 22 Z. TIEGER: [Përkthim] --
- 23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kam -- mund të shikoni pyetjen në  
24 faqen e fundit.
- 25 Z. TIEGER: [Përkthim] Komenti ishte krejt i panevojshëm.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Por unë dua thjesht t'i  
2 përgjigjet pyetjes.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Merru me  
4 pyetjet, mos bëni komentet.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim]

6 PY. Nëse shohim paragrafin më poshtë, kemi një situatë --  
7 paragrafin e fundit. Këtu e jepni si fakt që komandantët e  
8 zonave kryenin krime.

9 Paragrafi ku thuhet pavarësisht. I parafundit. I  
10 parafundit.

11 "Është e qartë që në disa raste, si në vrasjen e shtatorit të  
12 vitit 1998 nga forcat e UÇK-së të 34 personave pranë  
13 Gloxhanit, komandantët e zonave duhet ta kenë ditur, në mos e  
14 kishin urdhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë vrasjet." E shini  
15 këtë?

16 Që të jemi të qartë, tani duke pasur këtë informacion, do  
17 ta thoshit që -- një minutë -- sa e cilësoni ju këtë, pra do  
18 të doja të na e cilësonit?

19 PË. Jo, nuk mund ta cilësoj. Unë mund ta shpjegoj.

20 PY. Mirë, na e shpjego.

21 PË. Unë do të theksoja se "duhet ta kenë ditur".

22 PY. Unë do të thosha të gjithë fjalinë: "duhet ta kenë ditur,  
23 në mos i kanë urdhëruar vetë vrasjet."

24 Z. TIEGER: [Përkthim] Lejojeni dëshmitarin të mbarojë  
25 fjalinë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbaruat  
2 përgjigjen? Mbarojeni.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Ajo që dua të theksoj unë dhe që  
4 është relevante, është që duhet ta kenë ditur. Ka pasur  
5 dijeni. Dhe në qoftë se nuk kanë pasur -- dhe në mos -- në  
6 qoftë se nuk e kanë urdhëruar vetë vrasjet, ata patjetër që  
7 duhet të kenë pasur dijeni dhe për këtë ata janë përgjegjës.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim]

9 PY. A thoni ju, bazuar në këtë përfundim që ky ishte një  
10 vendngjarje e rregullt për ekzekutimet?

11 PË. Është bazuar në përfundimet tona se u gjetën 34 trupa në  
12 atë liqen ose afër atij liqeni.

13 PY. Ju e dini ama që 9 prej këtyre trupave, të këtyre  
14 personave, për herë të fundit kanë qenë të gjallë nën ruajtjen  
15 e serbëve. E dini këtë?

16 PË. Nuk jam në dijeni të identiteteve. Po, të viktimave.

17 PY. Dhe ju i thoni këto deklaratat pa pasur informacion dhe i  
18 qëndroni sepse këtë e keni përshkruar si ngjarjen më të rëndë  
19 që keni identifikuar ju si krim lufte të UÇK-së në vitin 1998.

20 PË. Duke ditur atë që dimë sot, mbase këtë fjalinë do ta  
21 kisha formuluar pak ndryshe.

22 PY. Po a nuk është ky një cenim i prezumimit të pafajësisë së  
23 një personi, që në fakt ishte i pafajshëm për këto krime?

24 PË. Nuk e di a është i pafajshëm.

25 PY. A s'e ke ndjekur gjykimin?

1 PË. E di që nuk u shpall fajtor.

2 PY. S'e ke lexuar aktgjykimin?

3 PË. Jo, nuk e kam lexuar.

4 PY. Nuk ishte ndërmarrje e përbashkët kriminale, sipas  
5 Gjykatës, nuk ka qenë vendngjarje ekzekutimi. Personat kishin  
6 hedhur trupat në lum dhe ai -- ajo e krijoji këtë situatë.  
7 Ishin hedhur trupat në lum dhe ajo e krijoji këtë situatë. Nuk  
8 e lidh asgjë atë që ka ndodhur me një ndërmarrje të përbashkët  
9 kriminale apo me komandantin e zonës.

10 PË. Nuk pajtohem me këtë vlerësim.

11 PY. Po a ke lexuar, apo s'e ke lexuar këtë. Se ka qenë një  
12 aktgjykim. Ke lexuar raportin e Dick Marty dhe ndryshove disa  
13 nga mendimet e tua bazuar në raportin e Dick Marty. S'e keni  
14 lexuar?

15 PË. E kam lexuar.

16 PY. A pajtoheni?

17 PË. Nuk pajtohem me faktin që unë paskam ndryshuar mendimet  
18 pasi lexova raportin e Dick Marty.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të  
20 bëjnë pushimin e drekës. Jeni dakord?

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Patjetër.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë  
23 pushimin e drekës dhe kthehemi në orën 14.30.

24 Faleminderit. Do ju shoqërojë Sekretarja e sallës së  
25 gjyqit.

1 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Dua të ngre një çështje.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Thjesht doja të njoftoj Trupin  
4 Gjykues dhe Prokurorinë që Mbrojtja e Thaçit dhe e Selimit  
5 kanë dorëzuar përgjigjet e tyre sa i takon kërkesës për  
6 videolidhjes dhe e kemi bërë një ditë më përpara. Kur të  
7 lexoni kërkesën tonë, do të shikoni që ka shumë problematika  
8 që mund të kërkojë nevojë -- mund të kërkojnë përgjigje nga  
9 Prokuroria. Dëshëm mundësinë që ta shihnit këtë gjatë pushimit  
10 të drekës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga ekipet e  
12 tjera të Mbrojtjes, ka ndonjë gjë tjetër, do të parashtroj  
13 njëri ndonjë kërkesë?

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk do të shtojmë asgjë tjetër.  
15 kemi lexuar raportin e -- kemi lexuar kërkesën e Mbrojtjes së  
16 Selimit dhe Thaçit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pajtoheni me  
18 kërkesën e tyre?

19 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Është një përgjigje e përbashkët  
20 Selimi dhe Thaçi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të  
22 jepni përgjigje apo kishim thënë që nuk do të shqyrtojmë  
23 kundërpërgjigje? Prokurori dëshiron t'i përgjigjet?

24 Z. TIEGER: [Përkthim] Me sa kuptova unë, z. Misetiç po na  
25 këshillonte dhe po na thoshte që e dorëzua para afatit të



1 caktuar në mënyrë që ta shohim dhe pastaj mund t'i përgjigjemi  
2 pyetjes së Trupit Gjykues.

3 --- Pauza fillon në orën 13.05

4 --- Seanca rifillon në orën 14.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshiroj të  
6 theksoj dy gjëra përpara sesa të vijë dëshmitari në sallën e  
7 gjyqit. Gjëja e parë dhe mbase më e rëndësishmja është që  
8 duhet të bëjmë një pauzë prej pesë sekondave ndërmjet pyetjeve  
9 dhe përgjigjeve sepse keni mbivendosje të vazhdueshme, kështu  
10 që bëhet shumë e vështirë për përkthyesit që t'ju ndjekin.  
11 Edhe unë vetë bëj të njëjtën gjë, kështu që thjesht dua që të  
12 gjithë të jemi të kujdesshëm. Ju lutem jini të kujdesshëm,  
13 bëni një pauzë përpara se sa të marshoni për të bërë pyetjen e  
14 radhës.

15 Pika e dytë është që kam një urdhër gojor për të bërë  
16 lidhur me kundërpërgjigjen e ZPS-së për parashtrimin e  
17 protokolluar F01678 [sipas përkthimit].

18 Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja e Thaçit dhe e Selimit iu  
19 përgjigj parashtrimin të protokolluar F017678 që është kërkesa  
20 e ZPS-së për dhënien e dëshmisë me video-konferencë për  
21 dëshmitarin e radhës, që është 3827.

22 Duke marrë parasysh faktin që dëshmitari 03827 duhet që  
23 të fillojë dëshminë e vet javën që vjen, Trupi Gjykues e  
24 urdhëron ZPS-në që të dorëzojë kundërpërgjigjen e vet deri të  
25 nesërmen, deri nesër, deri në mesditë.

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Do të  
2 dorëzojmë një kundërpërgjigje, por duke pasur parasysh disa  
3 prej çështjeve që janë ngritur në përgjigjen e Mbrojtjes, do  
4 kërkoja që të na jepni pak më shumë kohë, domethënë do e  
5 dorëzojmë nesër, por kërkojmë që ta zgjasim pak nesër.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thashë deri  
7 në mesditë, megjithatë mund ta zgjasim deri në orën 16.00.

8 Z. TIEGER: [Përkthim] Mirë atëherë, thatë që afati është  
9 16.00, apo jo?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull  
11 atëherë, ora 16.00. Le të fusim dëshmitarin në sallën e  
12 gjyqit, Sekretare.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Abrahams,  
15 mirë se erdhët.

16 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem dhe  
18 një herë që të flisni ngadalë, ju lutem flisni përpara  
19 mikrofonit dhe prisni që të jepni përgjigje, bëni një pauzë të  
20 shkurtër përpara se sa të jepni një përgjigje sepse ka pasur  
21 mbivendosje gjatë paradites dhe ka dalë si problem kjo gjë.

22 Ju kujtoj gjithashtu që jeni nën detyrimin për të thënë  
23 të vërtetën, sikurse u tha në betimin solemn.

24 Z. Emerson do të vazhdojë me kundërpyetjet e veta për  
25 ju.

1 Z. Emmerson, fjala për ju.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim]

3 PY. Z. Abrahams, kur morëm pushimin po ju flisnim, apo po ju  
4 pyesja, lidhur me raportin me titullin "Nën urdhra", që është  
5 një raport i cili është nxjerrë në 2001. Ju pyeta lidhur me  
6 një paragraf në faqen 101 të atij raporti, ku ju thoni, në  
7 gjysmën e dytë të paragrafit të parafundit, se:

8 "Pavarësisht këtyre strukturave, nuk ka raste të njohura  
9 që ushtarët e UÇK-së janë ndëshkuar për krime në forcat  
10 civile, aq më pak në luftime."

11 Kur e keni fjalën që nuk ka pasë raste, raste për të  
12 cilat ju keni pasë dijeni, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Nuk e keni pasë fjalën që nuk ka pasë fare raste?

15 PË. Po.

16 PY. Apo nuk e dini që dikush mund të kishte më shumë  
17 informacion se sa kishit ju, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Vazhdoni më tej duke thënë që:

20 "Është e qartë që në raste të caktuara, si në rastin e  
21 vrasjes së shtatorit 1998 nga forcat e UÇK-së të tridhjetë e  
22 katër vetave në afërsi të Gllogjanit, që komandantët vendorë  
23 duhet të kenë ditur edhe në qoftë se nuk e kanë urdhëruar këtë  
24 vrasje, do të kenë lidhur me ta."

25 Dhe ju vazhdoni të flisni për disa masa disiplinore nga

1 komandantët në rastin e gazetarëve, e kështu me radhë, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. A e pranoni që në fund të 2001, që është drejt fundit të  
4 kohës së raportimit, domethënë nga periudha e 1998, a  
5 pajtoheni se kur përpara sesa të bëni një deklaratë të tillë,  
6 është detyrë e juaja që së pari të vërtetoni faktin përpara se  
7 të dilni me këtë deklaratë, apo jo?

8 PË. Këtë deklaratë po e lexoj tani. E pranoj gjithsesi, se  
9 duhej që të bëhej formulimi ndryshe.

10 PY. Po, ju jam mirënjohës për këtë pranim, por gjithsesi  
11 çështja shkoi diçka përtej kësaj, sepse së pari ju i  
12 përshkruani vrasjet e shtatorit 1998 nga forcat e UÇK-së.  
13 Çfarë provash kishe ti që ka ndodhur vrasje nga UÇK-ja në  
14 shtator 1998?

15 PË. Është e vërtetë, në fakt duhet që të kisha shkruar  
16 "vrasjet e pretenduara" në vend të këtij formulimi.

17 PY. Këto janë pretendime nga serbët apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. E saktë?

20 PË. E saktë.

21 PY. Dhe ajo çfarë bëtë ju nuk është asgjë tjetër vetëm  
22 ricikluat propagandën serbe, apo jo?

23 PË. Duhet të ishte shkruar ndryshe.

24 PY. Por, ju këto pretendime i morët nga pala serbe, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe ju i keni marrë këto informacione në shtator, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. A keni intervistuar ju ndonjë dëshmitar sa i takon këtyre  
4 vrasjeve të pretenduara?

5 PË. Po.

6 PY. Kur thoni vrasje e shtatorit 1998, a je tani në dijeni të  
7 faktit që në atë aktakuzë nuk është vrarë askush, në shtator  
8 1998.

9 PË. Formulimi është i keq.

10 PY. Pra, në qoftë se doni ta përshkruani kështu, është në  
11 rregull, por në fakt nuk është vetëm e formuluar keq, por  
12 është tërësisht e gabuar. Njerëzit e zbuluar përfshirë këtu  
13 edhe nëntë viktimat të vrasjes së serbëve, nën ruajtje, pra  
14 janë përjashtuar nga aktakuza për të njëjtën arsye. Në të,  
15 përfshiheshin individë të cilët kishin vdekur në rrethana të  
16 ndryshme në vende të ndryshme dhe në kohë të ndryshme në të  
17 gjithë rajonin e Dukagjinit, por trupat e tyre u gjetën të  
18 hedhur bashkë me njëri-tjetrin në liqen. Pra, kur po flisnit  
19 për vrasjen e shtatorit nga forcat e UÇK-së, nuk ka pasur fare  
20 një vrasje të tillë, apo jo?

21 PË. E pranoj pikën tuaj.

22 PY. Jo vetëm që nuk është perifrazuar në mënyrë elegante, por  
23 është tërësisht e gabuar, apo jo?

24 PË. Unë nuk thashë që nuk është perifrazuar në mënyrë  
25 elegante.

1 PY. Ju thatë që "mund të ishte shkruar ndryshe", me një frazë  
2 ndryshe, apo jo?

3 PË. Tërësisht.

4 PY. Është tërësisht e gabuar, apo jo?

5 PË. Duhet ta kisha shkruar ndryshe.

6 PY. Është faktikisht si deklaratë fakti, është deklarim fakti  
7 që kjo është tërësisht e gabuar, apo jo?

8 PË. Po, nuk është e saktë. Pra, sa i takon vrasjeve të  
9 shtatorit 1998, kjo nuk është e saktë.

10 PY. Nuk është e vërtetë. Nuk ka pasur fare as vrasje nga  
11 burimet e UÇK-së, apo jo?

12 PË. Do thoja "vrasje e pretenduar," ndoshta do të ishte më  
13 mirë kështu.

14 PY. Tani do shikojmë pak procesin, domethënë nuk e kam fjalën  
15 këtu për rastin në Gllogjan. E kam fjalën midis opinioneve që  
16 ju ndiheni që mund t'i thoni lirisht edhe t'i dëshmoni këto  
17 përpara Trupit Gjykses, dhe atë çfarë ju tregon dhe çfarë ju  
18 mëson studentëve tuaj që nuk duhet të jeni rigorozë për  
19 çështje juridike, apo jo?

20 Z. TIEGER: [Përkthim] Po pres për pyetjen, në fakt, që të  
21 përfundojë.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po shpjegoj --

23 PY. Ajo çfarë po mundohem që të them është që mënyra sesi  
24 arrini në konstatime të tilla, sepse na thatë që jepni mësim  
25 për studentët, pra ju duhet të bëni dallimin ndërmjet një

1 vlerësimi forenzik edhe provave.

2 Të parashtroj se pjesa e vetme e saktë nga i gjithë ky  
3 paragraf është që janë gjetur trupa të vdekur në Gllogjan në  
4 shtator 1998, apo jo? Vetëm këtë pjesë mund të mbroni, apo jo,  
5 dëshmitar?

6 PË. Po, këtë e mbroj që këto trupa janë zbuluar dhe që  
7 pretendohej që UÇK-ja ishte përgjegjëse. Megjithatë, e pranova  
8 edhe më përpara që kjo fjali duhej të ishte shkruar,  
9 formuluar, ndryshe. Dhe e marr këtë parasysh.

10 PY. Dhe, pretendimet bëheshin nga serbët, kështu?

11 PË. Këto ishin pretendime që bëheshin nga zyrtarët serbë.

12 PY. Që ne tani e dimë që vetë ata kanë hedhur disa nga trupat  
13 në afërsi të asaj zone.

14 PË. Unë nuk e di këtë gjë.

15 PY. Ata i kanë lëvizur, i kanë çuar trupat nga një vend në  
16 tjetrin. Këtë e di ti apo jo?

17 PË. Unë mund të të flas për një rast tjetër për një pretendim  
18 për krime të kryera nga UÇK-ja në zonën e Kleçkës, për të  
19 cilën ne kemi hetuar.

20 PY. Për këtë do të pyes, por pas pak. Por, e keni fjalën që  
21 keni hetuar pak më tepër?

22 PË. Po, pak më tepër, në mënyrë pak më rigoroze.

23 PY. Pra, kjo është diçka e rëndësishme, sepse na keni thënë,  
24 na dëshmuat në deklaratën tuaj si dëshmitar se sa e  
25 rëndësishme ishte dhe se cila ishte procedura dhe metodologjia

1 me anë të të cilës bënit hetimet tuaja, ndërkohë që i takon që  
2 këtu nuk keni respektuar asnjë prej këtyre apo jo?

3 PË. Ne kemi identifikuar një rast këtu dhe kemi zbatuar  
4 standardet tona këtu.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.  
6 Tieger.

7 Z. TIEGER: [Përkthim] Z. Emmerson, nuk e di në qoftë se e  
8 ka si synim që të bëjë akuza apo jo, por nuk po e dëgjon  
9 dëshmitarin fare, nuk po dëgjon fare përgjigjet që jep  
10 dëshmitari.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e bën  
13 gjatë gjithë kohës këtë punë. Ka mbivendosje gjatë gjithë  
14 kohës.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, nuk është e  
16 qëllimshme. Do të përpiqem që të flasim me radhë.

17 PY. Ju nuk keni bërë hetime sa i takon pretendimeve të  
18 autoriteteve serbe, apo jo?

19 PË. Ne nuk kemi bërë hetime në thellësi.

20 PY. Nuk keni bërë fare asnjë hetim?

21 PË. Më lejoni të mbaroj. E kam përmendur këtë, por nuk është  
22 reflektuar në mënyrë të saktë. Kam përshtypjen që kjo është  
23 tek kapitulli që ka të bëjë me zinxhirin komandues, besoj.

24 Megjithatë kjo është e ndryshme nga prezantimi i tij dhe ne  
25 asnjëherë nuk kemi prezantuar rastin e Gllogjanit në liqenin



1 Radoniq fare.

2 PY. T'i marrim hap pas hapi. E para nuk keni bërë hetim fare,  
3 apo jo?

4 PË. Jo. Jo nuk është e saktë kjo. Ne u përpoqëm që të shkonim  
5 në terren për ta vizituar atë.

6 PY. Ju nuk keni shkuar atje, domethënë nuk arrite që të  
7 shkonit në vendngjarje, apo jo?

8 PË. U përpoqëm, por nuk arritëm.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e bëni  
10 prapë, po mbivendoseni, po flisni mbi njëri-tjetrin përsëri.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Këtë herë po e bën dëshmitari.

12 PY. Human Rights Watch nuk ka bërë hetime ndoshta mund të  
13 keni dashur, mund të jeni përpjekur, por fakti është që nuk  
14 keni bërë, kështu?

15 PË. Po luajmë me fjalët më duket këtu.

16 PY. Në rregull.

17 PË. Ne u përpoqëm, ne shkuam në vendin e krimit --

18 PY. Shkuat atje?

19 PË. Ne u përpoqëm që të shkonim në liqenin Radoniq. Me sa më  
20 kujtohet mua, në atë pikë që shkuam ne, trupat ishin larguar.

21 Nëse nuk gabohem, po mbaheshin në një hotel në një morg të  
22 sajuar. Dhe ne nuk ka u dha leja që të futeshim në hotel.

23 PY. Por ju nuk shkuat te liqeni, apo jo?

24 PË. Tek liqeni vetë? Nuk besoj se shkuam atje.

25 PY. Në vendin nga ku ishin marrë trupat e vdekur, kështu?

1 PË. Jo, ne shkuam te ky morgu i improvizuar.

2 PY. Pra nuk e keni parë vendin e krimit? Pra ju nuk keni qenë  
3 në gjendje të bënit gjërat që ju thatë në deklaratën tuaj të  
4 dëshmitarit që ishte procedura normale e bërjes së punës nga  
5 Human Rights Watch, apo jo?

6 PË. Ne nuk kemi bërë një hetim të thelluar, dhe nuk kemi  
7 thënë që kemi bërë një hetim të thelluar.

8 PY. Kam dy gjëra për t'ju pyetur lidhur me këtë pikë. Së  
9 pari, në deklaratën tuaj thuhet pa dyshim që ju nuk do bënit  
10 kurrë një deklaratë për ngjarje të caktuara në qoftë se nuk  
11 keni disa burime për ta mbështetur konstatimin tuaj. Pyetja  
12 ime është kjo, a keni përdorur ju burime të shumta për të  
13 provuar konstatimet tuaja lidhur me këtë incident.

14 PË. Lidhur me këtë incident, kjo deklaratë dhe referencat në  
15 Gllogjan mbështeteshin tek informacione që ne kishim në atë  
16 kohë. Unë në fakt e pranova dhe më herët që ne nuk kemi kryer  
17 një hetim të plotë as nuk kemi pretenduar se kemi kryer një  
18 hetim të tillë, kështu që e pranoj parashtrimin tuaj.

19 PY. Dhe ju e pranoni gjithashtu të paktën në një rast tjetër,  
20 në atë çfarë quhet incidenti i Kleçkës, pra që siç dolën  
21 gjërat gjatë hetimit, që ky ishte një krim i fabrikuar, i  
22 krijuar nga serbët, që bëhej fjalë për një skenë krimi të  
23 sajuar nga serbët.

24 PË. Do t'ju jap më shumë hollësi --

25 PY. Pra, juve thatë që në fillim fare, e cilësuat sa i takon

1 atyre se konstatimeve që në fillim fare na e bëtë të qartë,  
2 megjithatë ajo çfarë dua t'ju pyes është që ju e dinit që  
3 ishte praktikë e zakonshme e forcave serbe që t'i nxirrnin  
4 trupat fare nga Kosova duke gërmuar vende masive varresh dhe  
5 t'i çonin në Kosovë [sipas përkthimit] dhe besoj që njiheshit  
6 që ishte zakon për ta për të manipuluar për të ndryshuar  
7 vendet e krimit në mënyrë të tillë që të fajësonin UÇK-në për  
8 ato krime. Janë dy pyetje.

9 PË. Po. Ka dy pjesë të pyetjes. Për pjesën e parë të pyetjes,  
10 jam plotësisht dakord me ju. Pajtohem me ju që ekzistonte një  
11 fushatë e orkestruar mirë dhe sistematike nga forcat serbe për  
12 të hequr dhe për të larguar trupat e vdekur për t'i çuar nga  
13 Kosova në Serbi, dhe që të hiqnin fajësinë nga vetja e vet.  
14 Unë vetë kam dokumentuar raste kur janë hequr, janë lëvizur,  
15 trupat e vdekur. Për pjesën e dytë --

16 PY. E kam për operacionin fals.

17 PË. Në rastin e Kleçkës, rasti i Kleçkës është shumë  
18 shqetësues për ne. Unë nuk kam prova që ata kanë manipuluar  
19 largimin e trupave nga Kleçka. Mund ta kenë bërë serbët këtë  
20 gjë, megjithatë ajo çka besoj unë lidhur me Kleçkën është se  
21 provat e paraqitura -- kishin shumë të ngjarë që të ishin të  
22 vërteta. Kishin probabilitet të lartë.

23 PY. Do t'i kthehem kësaj për një çast. A jeni në dijeni të  
24 faktit që në gjykimin kundër Haradinajt doli në pah se forcat  
25 serbe ishin pajisur në mënyrë të qëllimshme me municion kinez

1 për t'u dukur sikur ishin bërë sulme nga UÇK-ja? Domethënë u  
2 jepnin municione kineze dhe ia hidhnin fajin UÇK-së.

3 PË. Jo, e dëgjoj këtë për herë të parë këtu.

4 PY. Duhet ta marrësh të mirëqenë këtë që them që ka pasur  
5 prova të qarta lidhur me këtë. Në fakt, ekzistojnë urdhra të  
6 forcave serbe që funksiononin në zonë me atë synim që e kishim  
7 si qëllim të veçantë këtë gjë. Jam i sigurt që jeni në dijeni,  
8 që keni dëgjuar, për këtë kamionin me trupa të civilëve  
9 shqiptarë që është gjetur në fund të Danubit, besoj e keni  
10 dëgjuar këtë gjë apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe, një numër goxha i madh i trupave shqiptarë që janë  
13 gjetur në një kompleks policor ushtarak, brenda Serbisë në PJP  
14 -- besoj e keni dëgjuar dhe këtë?

15 PË. Po.

16 PY. Me zhvillimin e luftës, pra në fund të fund të 1998, duke  
17 filluar pastaj me fillimin e 1999, në fakt ka pasur një qasje  
18 tërësisht të bashkërenduar për të spastruar vende te krimin në  
19 të gjithë Kosovën, apo jo?

20 PË. Hetimet e mia lidhur me këtë konfirmojnë -- pra  
21 operacioni ka qenë në qershor 1999, për këtë mund të flas.  
22 Ishte sistematik operacioni.

23 PY. A ka pasë emër ky?

24 PË. E keni fjalën për operacionin e spastrimit?

25 PY. Po.

1 PË. Mbase, por nuk më kujtohet. Me siguri do ketë pasur.

2 PY. Por, është dokumentuar që ishte politikë ushtarake e  
3 zakontë e Serbisë që të hiqnin sa më shumë trupa shqiptarë të  
4 ishte e mundur, që t'i ngarkonin diku në një kamion apo diku  
5 edhe t'i hidhnin diku tjetër.

6 PË. Kam lexuar lidhur me këtë, dhe e konsideroj këtë si një  
7 krim në vazhdim ku ka pasur një mungesë të jashtëzakonshme  
8 përgjegjshmërie.

9 PY. Atëherë, të kalojmë te fjalia e fundit për herë të  
10 fundit. Që ju thatë që kjo është një fjali që duhet të ishte  
11 formuluar ndryshe prej jush. A pajtoheni me mua se edhe kur  
12 ishit ju përgjegjës Human Rights Watch mund të ndodhte që  
13 gjërat t'i merrte tërësisht gabim?

14 PË. E pranova që kjo fjali duhej të ishte shkruar ndryshe.

15 PY. Sigurisht që po të dije atëherë çfarë di sot, nuk besoj  
16 se do shkruaje lidhur me këtë, apo jo?

17 PË. Do kisha shkruar që:

18 "Komandanti vendor duhej të kishte dijeni për praninë e  
19 trupave."

20 Por se unë besoj --

21 PY. Çfarë besoj?

22 PË. Unë mendoj se kur 34 trupa njerëzish hidhen mbi njëri-  
23 tjetrin, pavarësisht rrethanave, ka shumë gjasa, nuk po them  
24 që duhet ta kisha ditur patjetër, por ka shumë gjasa që ai  
25 duhet ta dinte.

1 PY. Ju thoni që duhet ta kishte ditur.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Kishte pak  
3 mbivendosje, ju kërkoj ndjesë. E di, jam i predispozuar që të  
4 mos flasim mbi njëri-tjetrin, por ndonjëherë ndodh.

5 PY. Tani a e di, ose atëherë e ke ditur, që të gjithë këta  
6 persona janë gjetur, zbuluar, në pjesë të ndryshme? Ju kërkoj  
7 ndjesë. Janë dërguar, apo janë zhdukur në pjesë të ndryshme të  
8 rajonit të Dukagjinit, dhe koha kur janë hedhur ata te pjesa e  
9 kanalit ka qenë komplet e ndryshme.

10 PË. Nuk e di këtë gjë, nuk di hollësitë e kësaj çështjeje.

11 PY. Por, përderisa e ke thënë këtë gjë që komandanti duhet të  
12 kishte njohur, besoj që duhet të kishte pasë njohuri edhe  
13 tjetër?

14 PË. Unë dhe them që duhet të kishte ditur.

15 PY. "Duhet të kishte ditur" po thua tani.

16 PË. Besoj se thashë që "duhej që ai të kishte ditur".

17 PY. Pra këtë ke thënë, që "duhet të kishte ditur".

18 PË. Po them që çfarë po them tani, që duhet -- me gjasa duhet  
19 të dinte.

20 PY. Ju lutem, a mund ta thoni se ku e bazoni ju këtë? Se  
21 cilët janë elementët mbi të cilët mbështeteni për ta thënë  
22 këtë gjë?

23 PË. Kompetenca, pushtetin e komandantëve krahinorë, njohuritë  
24 që kishin ata për veprimtaritë në zonat e tyre të komandës. Që  
25 nuk ishte njohuri absolute. Dhe për këtë arsye them që duhet

1 të kenë ditur.

2 PY. Ta lëmë hipotezën mënjanë, nuk ka pikë prove që dikush që  
3 ishte pjesë e atij kanali ishte vrarë nga UÇK-ja. E kundërta  
4 është e vërtetë në fakt që këta persona ishin vrarë në vende  
5 të ndryshme. Presumimi i njohurisë në rastin tuaj mbështetet  
6 në fakte hipotetike që ju nuk e dini fare a kanë ekzistuar apo  
7 jo, kështu?

8 PË. Mbështetet në analizën time të situatës. Por nuk e kam  
9 hetuar rastin, dhe mbase duhet ta sqaroj këtë gjë. Ka një  
10 dallim midis asaj që në qoftë se mua do më duhej që ta  
11 rishkruaja këtë fjali tani do ishte ndryshe. Është ndryshe  
12 tani dhe ndryshe në qoftë se unë do të duhej që të shkruaja  
13 dhe të botohej ai paragrafi atëherë. Nuk e di në qoftë se më  
14 kupton apo jo?

15 PY. Po, po. E kuptoj. A pajtoheni me mua se në qoftë se do të  
16 duhet që ta shkruanit këtë fjali sot, a duhet që të  
17 zëvendësoni fjalën "duhet" me fjalën "mund"?

18 PË. Po, pajtohem.

19 PY. Në rregull. A pajtoheni që gjykata është ajo e cila jep  
20 një verdikt, apo jo?

21 PË. Unë e kuptoj këtë gjë, dhe kini parasysh që ne përmendim  
22 pikat e trajnimeve dhe mësimdhënien dhe për shembull një ndër  
23 pikat që unë u mësoj studentëve të mi është që të jenë të  
24 hapur ndaj kritikave dhe ta pranojnë kur diçka mund të  
25 përmirësohet. Kjo është një prej elementëve kryesorë të të

1 qenit i saktë dhe profesional dhe ky është një prej gjërave  
2 kryesore të gazetarisë së saktë dhe profesionale.

3 PY. Absolutisht, e pranoj këtë gjë që pjesa e gabimeve është  
4 e rëndësishme për t'u mësuar. Megjithatë, a e keni përmendur  
5 ndonjëherë këtë shembull ju si material mësimor kur i mësoni  
6 studentët?

7 PË. Jo, deri tani.

8 PY. Po në të ardhmen, do ta përdorni?

9 PË. Po, me kënaqësi. Mund ta marr si rast studimor në të  
10 ardhmen për studentët e mi.

11 PY. Në fakt, krimet duken në të gjitha raportet apo jo?  
12 Raporti, që nga fillimi në raport ju përmendni vetëm  
13 pretendime, që në fakt ju janë dhënë nga serbët, apo jo?

14 PË. E keni fjalën për Gllogjanin?

15 PY. Po. Dhe ju e përmendni këtë në raportin e parë, e  
16 përdorni gjithashtu edhe në shkelje të të drejtës humanitare,  
17 e përdorni gjithashtu edhe në raportin "Nën urdhra". Por edhe  
18 në deklaratën që i keni dhënë Prokurorisë përpara Trupit  
19 Gjykues ju dhatë dy shembuj të dy krimeve shumë të rënda.  
20 Njëri prej tyre është ky që diskutuam dhe tjetri është Kleçka.

21 Do t'i kthehemi çështjes së Kleçkës për pak sekonda. Por  
22 do t'i kërkoja për momentin Sekretares që të paraqesë [E  
23 pakuptueshme]. Ndërkohë që jemi tek kjo temë, do të doja që të  
24 shohim një paragraf tjetër. Dua që të shohim paragrafin tek  
25 faqja 4, një temë tjetër, por i njëjti dokument, dua që të



1 shohim një paragraf.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të shohim dokumentin 935  
3 në fillim fare? Është një faqe përpara kësaj që kemi përpara  
4 në ekran.

5 PY. Dëshiroj që t'ju pyes për disa aspekte të caktuara --

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e dhashë gabim  
7 numrin e faqes. Është faqja 934.

8 PY. Në qoftë se do shikojmë paragrafin e dytë të kësaj  
9 faqeje, thuhet:

10 "Gjatë gjithë fillimit të 1999, UÇK-ja kryesisht ishte  
11 një grupim i çorganizuar i fshatarëve të armatosur, shpesh e  
12 ndërtuar mbështetur në strukturat familjare pa një zinxhir të  
13 qartë komandues."

14 Pajtoheni me këtë?

15 PË. Po, kryesisht po. Dhe kjo ishte e vërtetë për fillimin e  
16 1998.

17 PY. Dhe kjo sa ka zgjatur, deri në qershor, deri në korrik?

18 PË. Po. Do e thoja kështu. Deri nga korriku, gushti.

19 Operacion i madh ishte në korrik në Rahovec.

20 PY. Do diskutojmë edhe për Rahovecin për pak. Vazhdoni në  
21 raport dhe thuhet më tej që:

22 "Rajonalizimi i fortë dominonte në organizatë dhe zonat  
23 operative..."

24 Dhe e kam fjalën këtu që e kishit për zonat operative,  
25 apo jo?

1 "I mblidhnin fondet e veta dhe blinin armët e veta".

2 Pra këtu në fund të paragrafit, ju lutem përqendrohuni.

3 PË. Po.

4 PY. A mund të them që ju pajtoheni që gjatë asaj periudhe,

5 dhe e dimë nga provat e tjera që komandantët e zonave,

6 komandantët e parë të zonave janë caktuar nga qershori. A

7 është vlerësimi juaj që komandantët e zonës kishin shumë

8 autonomi vendimmarrëse brenda zonave të tyre operative, a e

9 mendoni kështu apo jo?

10 PË. Po. Kështu e kuptoj unë. Kështu e kam kuptuar në kohën

11 kur është shkruar ky paragraf në raportin "Nën urdhra".

12 PY. Do të kthehem më pas sa i përket mendimit që kishit për

13 atë të urdhrave. Si kanë ndryshuar pastaj në vijim për sa i

14 përket pikëpamjes suaj për nivelin e lartë të operacionit në

15 nivel vendor.

16 PË. Kjo është e saktë, dhe marrëdhënia e tyre me ndonjë

17 autoritet qendror në atë kohë ishte e paqartë. Të paktën për

18 mua ishte e paqartë.

19 PY. Pastaj, menjëherë në një kohë të shkurtër pas kësaj

20 periudhe, qershor-korrik, është ofensiva e madhe serbe që

21 shkatërroi UÇK--në. Është e saktë?

22 PË. Po. Në korrik 19 deri më 21 në qoftë se nuk gabohem.

23 PY. Po ashtu vazhdojmë pastaj deri në shtator, saktë?

24 PË. E saktë, po.

25 PY. Dhe të gjitha qendrat e UÇK-së, siç është ajo në zonën e

1 Dukagjinit, UÇK-ja u shpërnda, kishin humbur edhe ato  
2 strukturat bazike të komandës që ishin në atë kohë, u  
3 shkatërruan pra, si rezultat i ofensivës serbe?  
4 PË. Sigurisht që u shpërndanë, tani se si ofensiva serbe  
5 jugosllave ndikoi në strukturën komanduese është e paqartë për  
6 mua.  
7 PY. Kuptoj. Keni thënë gjëra në të kaluarën që do t'u kthehem  
8 më vonë.

9 Por në qoftë se shkojmë pak në vijim të këtij paragrafi,  
10 në mes të këtij paragrafi vijues thuhet fjalia:

11 "Për ju dhe armëpushimi nga dhjetori 1998 në mars 1999, u  
12 përdor për të përforcuar komandën qendrore dhe për të  
13 riorganizuar operacionet."

14 E shihni këtë?

15 PË. E shoh.

16 PY. "Nga marsi 1999, UÇK-ja ishte forcë rebele e organizuar  
17 më mirë megjithëse me personalitete të fuqishme në rajonet e  
18 ndryshme, të cilët nuk pajtoheshin me njëri-tjetrin".

19 E shihni dhe këtë?

20 PË. Po, e shoh.

21 PY. Pra, me sa duket këtu thoni se niveli i çorganizimit dhe  
22 mungesa e komandës qendrore, është rregulluar -- është  
23 korrigjuar në një farë mënyre vetëm nga marsi 1999.

24 PË. Sipas meje kjo do të thotë që është përforcuar gjatë  
25 kësaj periudhe kohore. Përpara kësaj periudhe ka ekzistuar një

1 farë mase, por që është formalizuar më shumë nga marsi 1999.

2 PY. Dhe kjo është 24 marsi kur filloi bombardimet e NATO-s.

3 PË. E saktë.

4 PY. Dhe po ashtu e dimë nga provat është momenti kur fushata

5 e krimeve serbe kundër njerëzimit në gjithë Kosovën filloi,

6 dhe kjo është vërtetuar në gjykimin Milutinovic dhe Djordjevic

7 ku keni dhënë dëshmi?

8 PË. Dhe Miloshevic.

9 PY. Periudha më intensive e krimeve sistematike u zhvillua,

10 rreth 10.000 vetë u vranë, shqiptarë, humbën jetën në këtë

11 periudhë kohore?

12 PË. E saktë. Kjo është numri i vlerësuar.

13 PY. Dhe kjo ndodhur menjëherë pasi ju thoni që UÇK-ja u

14 riorganizuar.

15 PË. E keni fjalën për periudhën kohore të ofensivës serbe?

16 PY. Nuk po e ndjek këtë unë. Bombardimet e NATO-s filluan në

17 mars 1999, të cilat shkaktuan menjëherë një fushatë spastrimi

18 etnik të menjëhershme, që ishte baza e ndjekjeve penale dhe në

19 rastin e Milutinovic, Djordjevic, Milosevic, kur aktet

20 armiqësore, lufta u përkeqësua, duke shënjestruar kryesisht

21 civilët. Dhe duke shkaktuar atë që njerëzit përdorin shprehjen

22 -- patkoi, të cilët e referoj. Pra nga verilindja e Kosovës që

23 shtyeshin masivisht njerëzit që iknin në drejtim të

24 Maqedonisë, Shqipërisë, dhe pak më pak në Mal të Zi.

25 PË. Pajtohem me këtë.

1 PY. Pra, fushata e kryer kundër njerëzimit, serbe, filloi në  
2 momentin kur ju thoni që UÇK-ja ishte më e mirorganizuar.

3 PË. Periudha kohore është e njëjtë, po.

4 PY. Dhe është e rëndësishme që të kuptojmë kontekstin e  
5 riorganizimit, ju thoni në mars UÇK-ja ishte forcë rebele më e  
6 mirorganizuar:

7 "Megjithëse kishte personalitete të fuqishme në rajonet e  
8 ndryshme të cilët nuk pajtoheshin gjithmonë me njëri-tjetrin."

9 Saktë?

10 PË. Saktë.

11 PY. Personalitetet e fuqishme në rajonet e ndryshme, e keni  
12 fjalën për komandantët e zonave apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, komandantët e zonave nuk pajtoheshim me njëri-  
15 tjetrin lidhur me veprimet që duhet të merreshin, sipas kësaj,  
16 është kështu?

17 PË. Po. Sipas mendimit tim kishte mosmarrëveshje. Nuk ishin  
18 gjithmonë pajtim për sa i përket politikave, strategjisë.

19 PY. Dhe mosmarrëveshja më e madhe ishte në Rambuje pastaj,  
20 kur ata që përfaqësonin UÇK-në u përpoqën që të nënshkruanin  
21 marrëveshjen që do të shtynte zgjidhjen përfundimtare të  
22 statusit të Kosovës për tre vjet? E kam fjalën do tejkaloj  
23 kompetencat e mia. Ky ishte delegacioni që udhëhiqej nga z.  
24 Thaçi, ku përpiqej që të gjente një marrëveshje paqësore dhe  
25 që t'i jepte fund dhunës. Por do të shtynte zgjidhjen

1 përfundimtare të çështjes së Kosovës dhe pavarësisë së saj.

2 PË. Është e saktë kështu.

3 PY. Dhe ju e dini që komandantët e zonave e kundërshtuan këtë  
4 fuqishëm, nuk e pranuan që të ndodhte.

5 PË. Me sa kuptova unë që kishte mosmarrëveshje sepse  
6 nënshkrimi i marrëveshjes së Rambujesë do të thonte autonomi  
7 që në fakt ishte më pak se sa pavarësi e plotë.

8 PY. [Nuk ka përkthim]

9 PË. Dhe nuk mund të them që kishte dhunë -- nuk e di këtë,  
10 por kishte sigurisht mosmarrëveshje, që kërkuan që z. Thaçi  
11 dhe të tjerët të ktheheshin në Kosovë dhe të bisedonin, të  
12 konsultoheshin.

13 PY. Sepse nuk kishin autoritetin që të nënshkruanin një  
14 marrëveshje sepse komandantët e zonave, këta personalitetet e  
15 fuqishme, që kontrollonin kaq fuqishëm individët e tyre, ishin  
16 kundra.

17 PË. Mund të përgjigjem ju lutem? Vlerësimi im, dhe kjo është  
18 një analizë, është që vendimi për të nënshkruar marrëveshjen e  
19 Rambujesë ishte shumë domethënëse, ishte moment ndryshues në  
20 historinë e Kosovës. Kishte tregues të qartë se kishte  
21 mosmarrëveshje. E kam kuptuar gjithmonë që z. Thaçi dhe  
22 delegacioni u kthyen dhe kishin -- për shkak të nevojës për  
23 t'u konsultuar.

24 PY. Dhe ju e dini që versioni i ndryshuar u negociua nga  
25 delegacioni i UÇK-së në UÇK [sipas përkthimit] i kësaj

1 marrëveshjeje kishte akoma përçarje, ndarje, mendime të  
2 ndryshme në nivel të komandantëve. Adem Demaçi i cili deri  
3 atëherë ishte shefi i zyrës politik të UÇK-së në Prishtinë  
4 kishte dhënë dorëheqjen për shkak të kësaj mosmarrëveshjeje. E  
5 dini këtë?

6 PË. Jam i vetëdijshëm, e di që jo të gjithë pajtoheshin me  
7 nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Nuk ishin dakord pra me  
8 këtë.

9 PY. A mund të vazhdojmë tani? Shqetësimi ynë tani për këto  
10 pyetje ka të bëjë me -- të shohim se si e shihnit ju komandën  
11 në atë periudhë kohore, në 2001.

12 Kalojmë tek paragrafi i dytë në faqen 0935, në fillim të  
13 faqes. E shohim shkurtimisht pra është në kontekstin e pjesës  
14 së mëparshme.

15 "Duke pasur parasysh përçarjet rajonale brenda UÇK-së,  
16 zinxhiri komandues qendror ishte ndonjëherë i vështirë të  
17 dallohej. Edhe brenda zonave operative nuk ishte gjithmonë e  
18 qartë kush ishte në kontroll të komandantëve -- çfarë  
19 kontrolli kishin komandantët e ndryhem mbi trupat e tyre."

20 Kjo ishte situata pra deri në periudhën mars 1999, apo  
21 jo?

22 PË. E saktë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani po shihja nja dy përgjigjet  
24 tuaja në gjykimin Djordjevic ku keni qenë dëshmitar i  
25 Prokurorisë, për sa i përket periudhës 1998. Mund ta paraqisni

1 në ekran ju lutem, dokumentin e shënuar si ERN-IT-05-87\_1 ose  
2 P00740.

3 Kërkoj ndjesë, ka një dallim sa i përket referencave  
4 sepse njëra është dokument në versionin PDF. Pra në versionin  
5 PDF në sistem është faqja 77 në këtë version pra, kështu po më  
6 thonë.

7 Faqja në vijim, mendoj. Po, kështu duket.

8 PY. Mund të vazhdojmë, të fillojmë me rreshtat 4 deri në 10.

9 Pyetja, "Faleminderit." Kjo është dëshmia juaj.

10 "A keni ndonjë informacion?"

11 PË. [Nuk ka përkthim]

12 PY. Pra, pyetja është:

13 "Faleminderit. A keni ndonjë informacion - bëhet fjalë  
14 për 1998 -- sa i takon fuqisë së UÇK-së. Sa pjesëtarë kishte,  
15 si ishin të organizuar?"

16 Përgjigjja juaj:

17 "Në cilin muaj të 1998?"

18 "PY. Bëhet fjalë për muajin qershor, korrik, gusht."

19 Dhe ju përgjigjeni:

20 "Në atë kohë UÇK-ja ishte akoma një grup i organizuar në  
21 mënyrë të shpërndarë, me sa kam kuptuar në atë kohë dhe nga  
22 hulumtimet në vijim, ka qenë me pushtet të decentralizuar dhe  
23 me një komandë qendrore, por autoriteti ishte në shkallë të  
24 gjerë, tek komandantët rajonalë."

25 Pra -- autoritet shumë i decentralizuar ku autoriteti



1 gjendej në shkallë të gjerë te komandantët vendorë.

2 PË. Besoj që është e saktë.

3 PY. Në qoftë se shohim pak më poshtë, rreshtat 10-13 --  
4 kërkoj ndjesë më duket që e lexuam këtë pjesë apo jo?

5 [Mbrojtja këshillohet]

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

7 PY. Mund të shikojmë si e keni përshkruar ju në shënimet  
8 tuaja të intervistës me Prokurorinë, deklaratën që i keni  
9 dhënë Prokurorisë.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] 07552 [sipas përkthimit] deri në  
11 0057558 [sipas përkthimit]. Pra, fillon me 075552, dhe deri në  
12 075578. Nëse kalojmë tek faqja, kam shënuar paragrafin 103-  
13 104. Faqja 22.

14 PY. Këtu po flisni për periudhën pas qershorit të 1999, për  
15 periudhën dhe dhunën që ndodhi, ku njerëzit mund të merrnin  
16 një uniformë të UÇK-së me simbol të UÇK-së dhe të kryenin  
17 krime apo veprime të dhunshme. Duhet të shohim pjesën ku ju  
18 përshkruani situatën lidhur me autonominë e komandantëve të  
19 zonave në atë kohë.

20 "Dhe pse është e arsyeshme ndonëse çdokush mund të vërë  
21 një baxh në uniformë, nuk besoj që në atë kohë dhe nuk e besoj  
22 tani që kjo shpjegon gjithë situatën se si ishte. Pikëpamja  
23 ime është që shpeshësia dhe shtrirja e këtyre krimeve do të  
24 kishte qenë e mundur pa të paktën pëlqimin e komandantëve të  
25 UÇK-së vendorë, të cilit kishin pjesën më të madhe të

1 kontrollit efektiv mbi aktivitetet në zonat e tyre respektive  
2 të përgjegjësisë, dhe se këta komandantë mund të kishin  
3 zvogëluar këto krime në sasi domethënëse.”

4 E lexoni këtë?

5 PË. Po.

6 PY. Pra po flasim për njerëzit që kthehen në Kosovë pas  
7 marrëveshjes së Kumanovës në 12 qershor, menjëherë pas saj,  
8 kur janë kryer shumë krime që ju i përshkruani, si krimet e  
9 kryera kundër serbëve, dhe bisedën që keni patur me z. Thaçi  
10 lidhur nëse bëhej fjalë për njerëz që merrni uniformën e UÇK-  
11 së vetëm për të kryer këto krime.

12 Por në deklaratën tuaj që u mor parasysh në këtë gjykatë,  
13 thoni që komandantët e UÇK-së vendorë që vazhdonin të kishin  
14 kontrolle efektive të aktivitetit, në zonat e tyre të  
15 përgjegjësisë respektive, mund të kishin parandaluar këto  
16 veprime po të kishin dashur.

17 PË. I qëndroj kësaj deklaratë, me një përgjigje ndaj komentit  
18 tuaj. Besoj që thatë --

19 PY. Të paktën minimalisht në nivel të komandantëve vendorë.

20 PË. Kjo do të thotë që unë besoj që komandantët vendorë do të  
21 mund të kishin ndërmarrë hapa. Dhe këto do të thotë këtu në  
22 fakt, mund të kishin ndërmarrë hapa.

23 PY. Nuk akuzoni askënd në këtë sallë gjyqi që kishte  
24 përgjegjësi komanduese që mund apo që ka kryer krime mbi atë  
25 bazë? Pra, mund të themi që nuk mund të thoni asgjë më shumë

1 se sa fakti që komandantët vendorë mund të kishin parandaluar  
2 këtë, sipas mendimit tuaj.

3 PË. Ky është mendimi im.

4 PY. Në paragrafin vijues 104 ju flisni për konfliktet  
5 pronësore, që kanë ekzistuar.

6 PË. Një kohë të gjatë dhe probleme të rënda kur njerëzit  
7 kishin zënë shtëpitë e të tjerëve. Konfliktet pronësore që  
8 ekzistojnë për një kohë të gjatë kanë qenë një ndër fakteve që  
9 u shfaq edhe më shumë kur u kthyen refugjatët?

10 PË. Konfliktet pronësore kanë qenë një ndër çështjet që ishin  
11 parësore, të mëdha.

12 PY. Konfliktet e vjetra që kishin filluar që përpara luftës.

13 PË. Nuk mund ta di për këtë, nuk di për çfarë lloj konfliktet  
14 bëhet fjalë për të gjitha këto. Por ajo që di është që --  
15 sepse jam informuar për raste në atë kohë, ku familje serbe  
16 ishin larguar kishin ikur, kishin lënë apartamentet e tyre dhe  
17 këto apartamente janë zënë dhe ndonjëherë ka rezultuar që ka  
18 pasur konfliktet se kush do të mund të jetonte në këto prona.  
19 Këto lloj konfliktesh ishin të shpeshta.

20 PY. Dhe me gjithë ato armë që ishin aty shpesh kanë  
21 përfunduar në vrasje.

22 PË. Nuk jam i informuar për raste konkret që kanë përfunduar  
23 në vrasje, por është e vërtetë që ka pasur armë dhe tensionet  
24 kanë qenë në rritje dh kanë shkaktuar dhunë.

25 PY. Me gjithë respektin dhe dëshirën tuaj për të ndihmuar

1 gjykatën për mendimin tuaj e konsideroni që ka shumë gjasa që  
2 kur megjithatë ato armë në qarkullim konfliktet të tilla mund  
3 të kishin çuar në vrasje?

4 PË. Mund të kishin çuar, po.

5 PY. Po të shohim pak më larg, thuhet:

6 "Këto konflikte pronësore ishin të shpeshta në Prishtinë  
7 sepse disa shqiptarë kishin zënë shtëpitë e serbëve që ishin  
8 larguar pas kërcënimeve. Kanë shkuar tek komandantët e UÇK-së  
9 për të marrë leje për të hapur biznese.

10 Pra, edhe këtu po flisni për komandantët e zonave dhe të  
11 nënzonave.

12 PË. Po. Këtu po flas konkretisht për Prishtinën.

13 PY. Po.

14 PË. Këtu pra bëhet fjalë për komandantët që kanë pasur  
15 autoritet mbi këtë zonë.

16 PY. Por kjo nuk ka ndodhur vetëm në Prishtinë?

17 PË. Kanë ndodhur edhe tjetërkund por njoh më mirë atë që ka  
18 ndodhur në Prishtinë.

19 PY. Është koment i arsyeshëm. Përpara se të kaloj te një temë  
20 tjetër, na thuaj në mënyrë të përmbledhur, na trego për  
21 pretendimet e furrës së djeg -- ku janë djegur mbetjet mortore  
22 të viktimave të UÇK-së. Tani na trego historinë lidhur me  
23 përfshirjen e gjykatësit serb dhe përfundimet tuaja.

24 PË. Unë kam dëgjuar për herë të parë këtë akuzë në shtator,  
25 kur isha në Kosovë. Shteti serb pretendonte që kishte zbuluar

1 në një varr krime të kryera nga UÇK-ja, dhe që ishin zbuluar  
2 trupa në këtë që nuk është qytet, në Kleçkë.

3 Ne e kemi hulumtuar këtë dhe zbuluam që pretendimet serbe  
4 ngrinin shqetësime, dyshime, pikëpyetje. Nuk mund të them që  
5 nuk janë kryer krime aty, nuk mund të them që UÇK-ja nuk është  
6 përgjegjëse për dhunë ndaj njerëzve që janë gjetur aty, por  
7 ajo që mund të them është që paraqitja e versionit serb linte  
8 shumë dyshime.

9 Për shembull -- në qoftë se dëshiroj që të vazhdoj më  
10 tej, mund të vazhdoj. Ata, serbët pra, besoj që edhe kanë  
11 sjellë një ose dy, nuk jam i sigurt, por të paktën një  
12 individ, sollën atë që të dëshmonte para mediave. Ky person u  
13 mor në pyetje nga një gjykatës hetues në Prishtinë, e cila  
14 ishte shumë e njohur, Danica Marinkovic. Që njihej që kishte  
15 qenë Prokurore në rastin ku bëhej fjalë për të burgosur  
16 politikë, tortura, dhe unë i kam evidentuar, dokumentuar,  
17 shumë nga këto raste. Ajo mori në pyetje këtë individ përpara  
18 mediave që natyrisht për neve s'ka nevojë të thuhet se është  
19 shumë e dyshimtë.

20 PY. A mund të themi dhe nuk kemi nevojë që të lexojmë  
21 paragrafët përkatës, mënyra sesi e përshkruani ju që në fillim  
22 të raportit që ky ishte pretendim për të cilin kishte shumë  
23 dyshime për sa i përket autoriteteve serbe, që ishte i  
24 orkestruar nga autoritetet serbe.

25 PË. Mënyra sesi e paraqitëm ne donim të qartësonim

1 pikëpyetjet që kishim, të jepnim përgjigje lidhur me këto  
2 pretendime.

3 PY. Pra, dy shembuj që ju i keni cituar në deklaratën tuaj si  
4 dëshmitar, janë si krimet më domethënëse të kryera nga UÇK-ja  
5 dhe pse njërin prej tyre e cilësoni si të tillë, ua bëtë të  
6 qartë që në fillim se hetimin e liqenit të Radoniq nuk është  
7 bërë, por nuk duet të jemi të pasjellshëm. Por keni bërë  
8 riciklim të propagandës serbe në njëfarë mënyre.

9 PË. Do të kërkoja që të shoh ku në deklaratën time i përmend  
10 këto gjëra që ju sapo thatë.

11 PY. Më jepni një çast ju lutem. Më duket -- një sekondë ju  
12 lutem, do t'i kthehemi kësaj teme. Në fakt mund të fillojmë me  
13 raportin mbi shkeljet e së drejtës humanitare. Raporti 0364783  
14 - 0364787.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të përsërisni  
16 numrin e referencës së dokumentit?

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, është "Shkelje të së drejtës  
18 humanitare në Kosovë". 0634783, K0364 -- tani paska numër që  
19 filloka me "P", P38.

20 PY. Është pjesa ku ju trajtoni këto dy incidente së bashku në  
21 qoftë se fillojmë në faqen 76 të raportit, 3685. Po, këtu  
22 jemi. Këtu kemi titullin "Shkelje të rregullave të luftës..."  
23 keni dhënë komentet e përgjithshme. Në qoftë se kalojmë tek  
24 866 faqe në vijim. Shohim citimet nga deklaratat publike të  
25 UÇK-së, dhe kur trajtoni detajet, kaloni tek hollësitë e

1 rastit, në faqen 877 fillimisht trajtoni rastin e liqenit  
2 Radoniq, pastaj pretendimet më të rënda kundër UÇK-së përpara  
3 shpalljes së shtatorit në fshatin -- ishte akuza e qeverisë  
4 jugosllave në fshatin Kleçklë ku UÇK-ja kishte ekzekutuar 22  
5 civilë përfshirë gra dhe fëmijë dhe djegur trupi. Policia  
6 pretendonte se kishte zbuluar mbetje mortore në një furrë që  
7 përdorej për të djegur trupa kur ata kanë marrë përsëri  
8 kleçkën në 27 gusht. Detajet e vrasjeve në mënyrë ekzekutimi  
9 janë dhënë nga dy shqiptarë etnikë të cilët autoritetet serbe  
10 thonë që ishin luftëtarë të UÇK-së. Mazrekut nuk iu lejua të  
11 fliste në mënyrë të pavarur gazetarëve, sipas gazetës New York  
12 Times "një person, marrja në pyetje e të cilit e  
13 videoregjistruar u vu në dispozicion të New York Times sot, ka  
14 treguar se kjo nuk kishte kuptim dhe që nuk mund të  
15 mbështesnin atë që thotë policia".

16 Zëdhënësit UÇK-së hodhën poshtë këto pretendime për këto  
17 akuza duke thënë që UÇK-ja nuk kishte vrarë asnjë serb civil.

18 Këto janë deklaratat tuaja pra, megjithatë ka dyshime të  
19 mirëbazuara që këto krime kanë ndodhur dhe se atëherë ishte  
20 diçka e inskenuar.

21 PË. [Nuk ka përkthim]

22 PY. Po, këtu është dhe referenca këtu e 9 shtatorit për një  
23 deklaratë që është bërë në të njëjtën ditë kur janë gjetur  
24 edhe trupat nga serbët. E shihni?

25 PË. Po, besoj që është lart.

1 PY. Po, janë bërë dy deklaratat nga autoritetet serbe në të  
2 njëjtën ditë: Një e furrës së gëlqeres në Kleçkë, krematori i  
3 pretenduar, dhe një ishte deklarata se ishte zbuluar një  
4 vendngjarje e UÇK-së me 34 trupa. Të dyja u shpallën në të  
5 njëjtën ditë. Dhe ju shkuat, po do ta shihnit situatën në  
6 Kleçkë, por jo në Gllogjan?

7 PË. Nëse më lejoni, shkoni pak më lart, më duket se ishte  
8 faqja 77, në kopjen fizike të këtij materiali do të shohim  
9 faqen 77. E këtu do të shihni paragrafin e parë për  
10 pretendimet e Gllogjanit.

11 PY. Dhe kjo është -- këtu është thënë që është -- pra është  
12 një deklaratë nga policia. Dhe ju në fakt e keni shitur si  
13 fakt këtë në 2001.

14 PË. Këtu është prezantuar në formë të cilësuar, edhe  
15 pretendimet e Kleçkës në të njëjtën formë. Por ama kishte më  
16 shumë hollësi asokohe për pretendimet lidhur me Kleçkën të  
17 cilat i konsideronim problematike.

18 PY. Keni lexuar dhe opinionet e personave të tjerë më duket,  
19 që mbase i janë dhënë edhe tek New York Times që janë  
20 konsideruar si problematike.

21 PË. Me sa duket.

22 PY. A ka peshë një opinion i New York Times?

23 PË. Por artikujt në media i kemi pjesë të mozaikut nëse mund  
24 të përdor këtë fjalë, apo këtë term. Por sigurisht ne nuk  
25 mbështetemi tek to, por i përdorim në një formë që na ndihmon



1 ne ta kuptojmë.

2 PY. Çfarë nuk kuptoj unë? Ju e cilësoni shumë mirë këtë  
3 pretendim për sa i takon të paktën liqenit të Radoniqit, e  
4 raportoni atë -- ishte një pretendim i paverifikuar, i  
5 pabazuar, dhe u shpall nga serbët ditën e nesërme.

6 PË. Ne thjesht renditëm faktet.

7 PY. Por çfarë ndryshoi nga ky raport në 2001 që ishte fakt i  
8 njohur, edhe që ju keni thënë që komandantët e zonës e dinin  
9 ose duhet ta kenë ditur? Çfarë ndryshoi? Ju thatë që s'bëtë  
10 ndonjë hetim. A ndryshoi mendja? Ndryshove gjuhën, nuancimet e  
11 gjuhës, ngjyrimet e gjuhës? Ju e shihni besoj dallimin, e  
12 shihni që ka një dallim.

13 PË. Po, e shoh dallimin.

14 PY. Po pse është ndryshe?

15 PË. Nuk ta them dot këtë.

16 PY. Mos e sajove? Ndryshove mendje, deshe thjesht të  
17 mbështesje këto pretendime?

18 PË. Jo, nuk e sajova. Por fjalinë do ta kisha shkruar ndryshe  
19 në qoftë se do të kisha pasur mundësi.

20 PY. Jo, jo, nuk po të them unë -- nuk dua të thuash këto  
21 fjali unë. Unë dua që gjykatësit të analizojnë cilësinë e  
22 materialeve tuaja dhe peshën që duhet t'u japin opsioneve  
23 tuaja. Dhe kështu e keni thënë ju shumë saktë në 1998, në  
24 raportin e 2001 ama, në mënyrë kategorike e përshkruani si  
25 vrasje nga UÇK-ja në shtator 1998. Jo të raportuara, por në

1 shtator 1998 dhe thoni komandantët e zonave i kanë ditur ose i  
2 kanë autorizuar.

3 Çfarë ndryshoi? Çfarë mësove ti në periudhën mes këtyre  
4 raporteve që ndryshoi qëndrimin tuaj? Po, edhe ju më pas në  
5 raportin e dytë e jepni si fakt.

6 PË. Nuk kam dijeni të kem ndryshuar mendje. Pra, unë mund të  
7 them që unë fjalitë në qoftë se do të kisha mundësi do t'i  
8 kisha formuluar ndryshe.

9 PY. Më vjen keq, por nuk po i përgjigjeni pyetjes sime. Keni  
10 bërë një gabim shumë të madh faktik. A ka mundësi që të mos  
11 ketë ndryshuar asgjë?

12 Z. TIEGER: [Përkthim] E kundërshtoj, pyetja është bërë  
13 dhe përgjigja është dhënë disa herë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është bërë  
15 pyetja dhe është marrë përgjigja.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] S'ka ndryshuar gjë?

17 Z. TIEGER: [Përkthim] E bëtë kundërshtimin, besoj se u  
18 mor vendim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni pyetur  
20 disa herë, ju lutem ndalojeni. Kundërshtimi pranohet.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull.

22 PY. Tani, tema këtu është të zbulojmë kush është dallimi si  
23 ja mëson ti studentëve këto proceset? Si hetoni, si dilni në  
24 përfundime, dhe çfarë ndodh në gjykatë? Sepse dëshmia juaj po  
25 u paraqitet Trupit Gjykses që t'i ndihmojë ata me vendimin e

1 vet.

2 Z. TIEGER: [Përkthim] A ka mundësi të mos bëjë deklaratata  
3 tendencioze?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëni pyetje  
5 në mënyrë të mirëfilltë ju lutem.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atë do bëja.

7 PY. Desha t'ju pyes -- në fakt do të lexoj një analizë që  
8 është bërë në çështjen Haradinaj për vrasjet që ju keni dhënë  
9 dëshminë që ju nuk keni ditur gjë që vrasjet që iu atribuuan  
10 UÇK-së të jenë hetuar, pra nuk dini që të jenë hetuar këto  
11 vrasje që i atribuohen UÇK-së. Këtë keni thënë.

12 PË. Jo. Ne nuk e kemi hetuar.

13 PY. Jo, ju keni thënë që ju nuk keni dijeni që UÇK-ja t'i  
14 ketë hetuar këto vrasje. E keni thënë këtë, e keni theksuar  
15 këtë.

16 PË. Mesa di unë, jo.

17 PY. Duroni vetëm një çast. Do ju lexoj dy paragrafë të  
18 shkurtër nga gjykimi në këtë çështje gjyqësore dhe më pas do  
19 ju kërkoj të komentoj, referenca është IT-04-84, është  
20 aktgjykimi i 3 prillit 2018.

21 PY. "Trupi Gjykes ka marrë prova të konsiderueshme  
22 veçanërisht për kryesit dhe rrethanat lidhur me vdekjen e  
23 vetëm një prej vrasjeve të pretenduara, që ishte Sanije Balaj.  
24 Këtu tregohet kujdesi sesi e ka shqyrtuar Trupi Gjykes rastet  
25 që kanë ndodhur kur ka pasur zhdukje apo kidnapime të

1 personave dhe kur është zbuluar një trup personi në liqenin e  
2 Radoniqit.”

3 Ky është paragrafi 159.

4 “Në qoftë se Trupi Gjykues nuk do të kishte marrë dëshmi  
5 më të hollësishme sa i takon vrasjeve të pretenduara të Sanije  
6 Balajt, atëherë ky incident do ishte menduar ta kishte bërë  
7 UÇK-ja në qoftë se nuk kishte marrë rrethanat e nevojshme. Të  
8 gjitha elementet duket se janë të pranishme: një arrestim nga  
9 ushtarët e UÇK-së. Përfshirja e Sanije Balajt në atë çfarë  
10 quhet -- në listën e personave të kërkuar nga ushtarët,  
11 transportimi dhe marrja në pyetje në zyrat e UÇK-së, dhe më  
12 pas gjetja e mbetjeve trupore në liqenin e Radoniqit. Edhe kjo  
13 ishte rrethana të cilat mori parasysh Trupi Gjykues për të  
14 dalë në përfundim sa i takon personave që janë vrarë, nën  
15 ruajtjen e UÇK-së. Sidomos, në këtë rast, rrethanat se si  
16 është vrarë Sanije Balaj, duket se përfundimet kanë qenë të  
17 gabuara.”

18 Pra përfundimet e para kanë qenë të gabuara. Pra ju e  
19 pranoni që ndodh në rrethana të tilla që ndonjëherë dalim në  
20 përfundime krejt të kundërta kur s’i kemi të gjitha të dhënat,  
21 a e pranoni këtë? Dhe ju keni komentuar për këtë çështje?

22 PË. Unë po e kam pak të vështirë të kuptoj këtë që po pyesni  
23 ju.

24 PY. Unë po ju them, kur bëhet një shqyrtim i duhur në  
25 rrethana kritike, dhe vlerësohen siç duhet prova, çon pastaj

1 ndonjëherë në një përfundim të kundërt, biles në një përfundim  
2 të kundërt nga ai që kishit zgjedhur të thonit ju.

3 PË. Hetimi më i mirë është të ekspozohen të gjitha faktet.

4 PY. Në paragrafin 475, thuhet:

5 "Sa i takon vrasjes së Sanije Balajt, dhe Istref dhe  
6 Nurie Krasniqit, Trupi Gjykses ka dalë në përfundimin se  
7 alternativa të arsyeshme sa i takon përfshirjes së UÇK-së në  
8 krime, gjegjësisht se tri personat janë vrarë nga personat që  
9 nuk ishin pjesë e UÇK-së apo nuk zbatonin politikat e UÇK-së."

10 Ky është përfundim faktik.

11 "Sa i takon -- Trupi Gjykses doli në përfundimin, sa i  
12 takon Sanije Balaj, se Ramush Haradinaj ka këmbëngulur që të  
13 bëjë një hetim për vrasjen e saj dhe në fakt hetim i tillë u  
14 bë."

15 Pra, është e qartë, është një përfundim i qartë, ka pasur  
16 prova se hetimet kryheshin.

17 PË. Ju besoj.

18 PY. Por kur thoni ju në mënyrë të vazhdueshme që nuk ka pasur  
19 hetime nga UÇK-ja me sa dimë ne, atëherë kjo keqkuptohet.  
20 Keqkuptohet sikur komandanti i zonës së UÇK-së nuk hetonte  
21 vrasje.

22 PË. Nuk thashë që nuk ka pasur hetime, thamë që nuk jemi në  
23 dijeni.

24 PY. Po e kuptoni ju pasojat që ka një deklaratë e tillë? Si e  
25 një përfaqësuesi të të drejtave të njeriut, ju i kuptonit

1 pasojat që ka një deklaratë e tillë, kur thoni ju që nuk janë  
2 kryer hetime të tilla?

3 PË. Jo, nuk e pranoj këtë. E kemi thënë qartazi, kemi dashur  
4 të përcjellim mesazhin që ne nuk jemi në dijeni, por mund të  
5 ketë raste të tjera për të cilat ne nuk kishim pse të kishim  
6 dijeni. Nuk kemi dijeni.

7 PY. Shohim raportin për shkeljen e të drejtës ndërkombëtare  
8 humanitare.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shohim materialin përkatës. Duhet  
10 të gjej, duhet të shohim provën materiale 380.

11 Por para se të dalë në ekran, dua të diskutojmë disa  
12 aspekte të tjera.

13 Veç këtyre dy rasteve, shumica e raporteve si raporti  
14 "Nën urdhra", më shumë vërtetojnë krimet serbe, kështu?

15 PË. Saktë. Serbë e jugosllavë.

16 PY. Po, serbë dhe jugosllavë, na e shpjeguat. Se ishin një  
17 numër shumë herë më i madh personash. Megjithatë nuk është kjo  
18 çështja që na intereson ne këtu.

19 Përveç këtyre dy rasteve të cilët ne i pamë, shembuj të  
20 tjera që ju paraqisni në raport, citohen të gjitha në Qendrën  
21 Juridike Humanitare. Pra të gjithë shembujt, si rrëmbimi i  
22 serbëve, e të tjera, citohen në raportet e Qendrës Juridike  
23 Humanitare, Humanitarian Law Centre. Citohen pra në raportet e  
24 kësaj qendre.

25 PË. Unë kam dy pjesë të përgjigjes në qoftë se më lejoni ta

1 përfundoj. E para, ky raport, "Shkelja e të drejtave të  
2 njeriut në Kosovë", kryesisht përqendrohet në krimet serbe dhe  
3 jugosllave. Burimet tona ishin kryesisht të fokusuara në këtë  
4 pjesë. Në të njëjtën kohë, menduam se ishte e rëndësishme të  
5 përfshinim dhe të përmendnim dhe të raportonim edhe cenimet,  
6 shkeljet që po bënin të gjitha palët gjatë konfliktit. Ju  
7 lutem më lejoni të përfundoj. Dhe pjesë e kësaj është edhe t'u  
8 kujtosh palëve në konflikt për detyrimet që kanë dhe të  
9 ngrinim atë që ne e konsideronim pretendime të besueshme.

10 Kjo është një arsye pse ky raport mbështetet në burimet  
11 dytësore të besueshme të mbështetura nga atmosfera në Kosovë  
12 asokohe, përshirë shqetësimet lidhur me sigurinë të cilat e  
13 bënin më të vështirë punën, pra që të hetoje krimet e  
14 pretenduara nga UÇK-ja sepse personat nuk ishin të gatshëm të  
15 flisnin në lidhje me këto.

16 Tani, arsyeja pse e kemi përfshirë në një kapitull dhe  
17 menduam që kishim përmbushur një standard, nuk është  
18 [mikrofoni çaktivizuar] por thjesht që të kishim një gamë  
19 provash, një numër provash të cilat ne besuam se ishin të  
20 besueshme, ne menduam se ishin të besueshme. Më falni. Ne kemi  
21 thënë dhe kush ishin dhe burimet, dhe deshëm thjesht që të  
22 bënim një farë njoftimi në lidhje me këtë.

23 Ky ishte konteksti i raportit. Dhe pjesa e dytë e  
24 përgjigjes time, nëse më lejoni shkurtimisht, dua të bëj një  
25 dallim mes raportimit që bëjmë ne për shpërdorimet e UÇK-së

1 përgjatë kësaj kohe, dhe kjo është relevante, sepse kryesisht  
2 ishin nga forcat shtetërore abuzimet, dhe ne atje kishim  
3 fokusin.

4 Më pas, kishte raportime për arrestime dhe abuzime, dhe u  
5 bë një raport "Ndalimet dhe abuzimet"; që ndiqte të njëjtën  
6 trajektore. Edhe këtu jemi mbështetur në burimet dytësore. Por  
7 me kalimin e kohës kjo ndryshoi dhe unë besoj se duhet bërë  
8 dallimi, veçanërisht sa i takon raportit "Abuzimet kundër  
9 serbëve dhe romëve në Kosovën e re". Konteksti është komplet  
10 ndryshe, është periudha pas Kumanovës, por metodologjia është  
11 krejt e ndryshme.

12 Dhe për këtë raport vizitua shumë vende, intervistua  
13 shumë dëshmitarë, viktime. Shkuam nëpër vendngjarje, kolegu im  
14 madje pa edhe trupa. Pra ka një dallim që duhet theksuar.

15 PY. Po do flasim edhe për këtë periudhë kohore, sepse është  
16 qershori 1999 që është pas Kumanovës. Por këtë do ta bëjmë  
17 nesër. Por unë s'po të pyes për punën që ka bërë Ben Ward. Më  
18 duket se Ben Ward ka qenë personi që ka bërë këtë raport?

19 PË. Kryesisht, por jo vetëm ai. Janë bërë edhe intervista.

20 PY. Do flasim edhe për këto. Dhe gjërat që keni thënë në të  
21 shkuarën, por këtë do ta bëjmë nesër.

22 Por unë ju bëra një pyetje shumë më të thjeshtë. Pjesa e  
23 mbetur e këtij seksioni ku ju përshkruani rrëmbimet e  
24 pretenduara nga UÇK-ja, dhe ka raste specifike, nuk është  
25 praktikë kjo. Kjo nuk ishte praktikë, nuk mund të thoni që ne



1 pamë Qendrën Juridike Humanitare, na pëlqyen, janë të  
2 besueshme, prandaj dalim në këtë konstatim. Por citimi në  
3 poshtëshënim është i një raporti që kishte publikuar  
4 Humanitarian Law Centre, kur publikuar dhe ju raportin tuaj.

5 Tani unë e kuptoj që fokusi juaj kryesor ishte krimet  
6 serbe, dhe e kuptoj që ju kishit edhe nevojën që të rishikonit  
7 edhe pak këto pretendimet lidhur me UÇK-në. Por përveç këtyre  
8 të dyja që diskutuam, që është incidenti i Glloganit dhe i  
9 Kleçkës, çdo gjë tjetër që citohet është në raportin e  
10 Humanitarian Law Centre. E pranoni ju këtë në qoftë se  
11 shikojmë të gjitha poshtëshënimet një për një?

12 PË. Për të kursyer kohë, e besoj këtë që po thoni.

13 PY. Ju mund ta verifikoni në qoftë se e kam gabim. Tani ne  
14 folëm për prezumimin e pafajësisë dhe të mos bëjmë deklaratë  
15 për persona sepse kjo është një nga garancitë kryesore për një  
16 hetim të drejtë dhe për një gjykim të drejtë. Por ju e pranoni  
17 që ka një dallim fundamental mes këtij raportimi dhe  
18 shqyrtimit apo kontrollit, ekzaminimit të duhur të këtyre  
19 fakteve. Në mënyrë që të vlerësohet besueshmëria e  
20 informacionit.

21 Tani, Qendra Humanitare Juridike, Humanitarian Law  
22 Centre, a adopton të njëjtën qasje sa i takon nxjerrjes së  
23 identiteteve dhe deklaratave të dëshmitarëve sikurse dhe Human  
24 Rights Watch?

25 PË. A japin burimet? Më duhet ta shikoj këtë gjë. E di

1 Humanitarian Law Centre dhe e njoh shumë mirë këtë qendër,  
2 këtë organizatën pra.  
3 PY. Ishte Natasha Kandic drejtoresha e kësaj qendre?  
4 PË. Ajo ishte dhe më duket se ende është drejtoreshë e kësaj  
5 qendre. E njihja, i njihja hulumtuesit e saj në Kosovë dhe i  
6 respektoja shumë. Duhet ta them këtë jo vetëm se unë i  
7 pëlqeja, nuk po them se i pëlqeja, por e njihja metodologjinë  
8 e tyre, ne diskutonim bashkë si të kryenim një hulumtim. Ne  
9 ndanim informacione për pista të ndryshme dhe qasje të  
10 ndryshme sa i takon hetimeve dhe unë e konsideroja  
11 metodologjinë e tyre si një metodologji të mirë, profesionale.

12 Prandaj, unë nuk mund të them që unë mbështetësha në  
13 raportet e tyre. I kam cituar raportet e tyre bazuar në  
14 përvojën e dorës së parë që kisha unë dhe duke e ditur që ata  
15 ishin shumë seriozë në mënyrë se si kryenin punën.

16 PY. E kuptoj që i respektoje ata dhe i shihje si një OJQ e  
17 besueshme pavarësisht faktit se kishin qendrën në Beograd, në  
18 Serbi, por nuk po e kontestoj këtë. Ne e dimë që kanë  
19 raportuar nga të dyja anët, me të njëjtën vendosmëri, nuk po e  
20 them këtë. Por, qartazi përpara se të deklaroni se ka ndodhur  
21 diçka, duhet të kesh disa burime, duhet të siguroheni që e  
22 keni verifikuar informacionin, ta mbështesni informacionin.  
23 Asnjëherë nuk mbështetësh në një informacion të vetëm, dhe  
24 pastaj duhet ta vleftësosh një informacion duke intervistuar  
25 personin. A keni takuar ndonjë nga personat që ua ka dhënë

1 këtë informacion, i keni intervistuar ata?

2 PË. Unë personalisht?

3 PY. Po, ju personalisht.

4 PË. Unë e bëra vlerësimin e besueshmërisë së intervistave.

5 PY. Pra, keni bërë vlerësimin e besueshmërisë së dikujt që ka

6 përshkruar ngjarje bazuar në dëshmitarët që kishin

7 intervistuar ata?

8 PË. Saktë.

9 PY. Dhe më pas ju e vlerësuat si të besueshme sepse ju e  
10 konsideronit vlerësuesin si person të besueshëm dhe pastaj

11 këto i renditët si fakte?

12 PË. Po edhe jo, sepse çelësi është të bëjmë dallimin mes  
13 dokumentimit të çështjeve individuale dhe gamës në tërësi të

14 këtyre çështjeve. Dhe ky është dallimi që diskutojmë ne në

15 trajnimet tona, se është barra e provës për çështje

16 individuale dhe barra e provës kur ka një praktikë. Se këtu po

17 flasim për disa raste, raste të shumëfishta. Edhe kemi

18 praktika abuzimi që përputhen me njëra tjetrën. Të marra në

19 tërësinë e tyre, ne besonim se çështja ishte e besueshme, e

20 cila duhej raportuar publikisht.

21 PY. Të shohim tani si ka rezultuar kjo. Shohim K036 [sipas

22 përkthimit] që është faqja e fundit, që e pamë një herë kur po

23 përshkruanit pretendimet për furrën e gëlqeres në Kleçkë, dhe

24 menjëherë pas kësaj mund të shohim edhe titullin "Rrëmbimi i

25 serbëve etnikë", personave me etni serbe.

1 Dhe më pas përshkruani që Humanitarian Law Centre, qendra  
2 humanitare pra, kishte dokumentuar zhdukjen e disa individëve,  
3 39 prej të cilëve ishin parë në ruajtjen e UÇK-së. Po ashtu  
4 kishte dokumentuar tri raste të shqiptarëve. Më pas shkojmë në  
5 faqen tjetër.

6 Kemi 79 rrëmbime. Thuhet ka pasur 79 rrëmbime në Rahovec.  
7 Përshkruani shembullin, duke iu referuar Humanitarian Law  
8 Centre, pra Qendrës Juridike Humanitare. Pra siç e shikoni  
9 këtu, e shikoni këtë?

10 PË. Cilit poshtëshënim po i drejtoheni?

11 PY. Poshtëshënimi 138, 134, ku bëni edhe pretendime më të  
12 përgjithshme.

13 Shkojmë në faqen tjetër. 4870, rasti i Jovan Lukic. Edhe  
14 këtu ju i referoheni Agjencisë Tanjug dhe Qendrës Juridike  
15 Humanitare. Tanjug desha ta thoja. Pra citoni këto dy organe.  
16 Nëse shohim faqen 81, më falni është faqja 871, merr rastet  
17 konkrete të Ratko dhe të Branko Staletic, Vojko dhe Ivan  
18 Bakrac, dhjetë -- edhe vazhdon.

19 Pra, ka shumë raste individuale që i keni prezantuar, ju  
20 i keni prezantuar, por këtë e keni bërë pa pasur vetë ju  
21 mundësinë të verifikoni besueshmërinë e provave që ju kishin  
22 dhënë, por thjesht jeni mbështetur në vlerësimin e një personi  
23 të tretë. A është kështu?

24 PË. Unë nuk do ta kategorizojta kështu.

25 PY. Mirë atëherë. A i lexuat të paktën deklaratat e tyre?

1 PË. Jo, nuk më kujtohet.

2 PY. Por s'do kishte qenë problem për ty kjo, në qoftë se s'do  
3 kishe parë prova s'kishe si ta lexoje?

4 PË. Po, por ne ishim në kontakte të rregullta me kolegët e  
5 Humanitarian Law Centre, dhe këtu përfshihen edhe raste  
6 individuale.

7 PY. Shohim rastin e Sanije Balaj, në çështjen gjyqësore  
8 Haradinaj që siç doli -- se fillimisht ishte thënë që ishte  
9 vrarë nën ruajtjen e UÇK-së. Apo si u shqyrtuan siç duhet  
10 rrethanat doli që nuk ishte kështu, doli me përfundim tjetër,  
11 prandaj. Unë po ju bëj një pyetje: pse i keni renditur këto  
12 raste në raportin tuaj kur ju nuk ia keni haberin kush janë  
13 dëshmitarët, përveç faktit -- e vetmja gjë që dini ju është që  
14 këtë detyrë e ka kryer dikush tjetër dhe ju i besonit ata.

15 Z. TIEGER: [Përkthim] E kundërshtojmë. Është bërë pyetja,  
16 është dhënë përgjigjja. Argumenti është tepër i gjerë.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë atëherë do të doja që  
18 Gjykatësi të merrte vendim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thashë që e  
20 pranoj kundërshtimin e Prokurorisë.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dua të bëj një koment të  
22 përgjithshëm.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju keni marrë  
25 vendim lidhur me këtë provë dhe pesha dhe besueshmëria do të

1 vlerësohet nga Trupi Gjykses në fund. Por të më kufizoni mua  
2 mënyrën se si e marr në pyetje një dëshmitar për besueshmërinë  
3 dhe për peshën nuk është mënyra e duhur se si po e bëni. Duhet  
4 të më lejoni.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
6 çaktivizuar] Mendojeni dhe një herë pyetjen dhe të paktën  
7 bëjeni në një mënyrë më të kuptueshme.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim]  
9 PY. A e pranoni se nëse përfshin në raport raste bazuar në  
10 një vlerësim besueshmërie nga një organizatë tjetër, ju po  
11 angazhoheni, siç ju thashë më herët, ju thjesht po i bëni  
12 jehonë gjetjeve të një organizate tjetër? Ua thashë dhe më  
13 herët këtë.

14 PË. Nuk e pranoj.

15 PY. Por, çfarë vlere të shtuar pati raporti i Human Rights  
16 Watch për sa i takon vlerësimin të besueshmërisë? Pra -- si e  
17 konsideroni ju këtë të besueshme përveç faktit që ju thoni që  
18 këtë e ka përgatitur një OJQ tjetër, sepse janë të besueshëm  
19 këta?

20 PË. Kjo është një OJQ që e njihnim mirë dhe ishim partnerë me  
21 ta, bashkëpunonim, dhe ne mendonim se ata ishin shumë të  
22 besueshëm. Së dyti, ne kemi vendosur dhe burimet.

23 Z. TIEGER: [Përkthim] Po numëroj unë deri në tre për z.  
24 Emmerson në qoftë se është nevoja, por po ndodh e njëjta gjë,  
25 po flasim njëkohësisht folësit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
2 përpiquni të flisni me radhë.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më vjen keq.

4 PY. Ju keni cituar organizatën, nuk na keni thënë burimet.

5 PË. Për këtë e kisha fjalën kur thashë burimet. Burim është.

6 Mbase mund të mos jetë i besueshëm, por ama në fund të fundit  
7 është burim. Dhe ne i kemi përfshirë aty, e kemi vendosur aty,  
8 që lexuesi të ketë mundësi të vlerësojë materialet vetë.

9 Prandaj, kemi thënë dhe jemi të qartë, e kemi bërë të qartë  
10 nga vjen. Dhe kjo është mbështetur me informacione të

11 rëndësishëm nga organizata të tjera Kryqi i Kuq Ndërkombëtar,  
12 që ka folur për personat e zhdukur.

13 Por parimi që po përpiqem të vë unë në dukje dhe mbase --  
14 më ndaloni në qoftë se e kam thënë një herë --

15 PY. Nuk mund të të ndaloj unë se më ndalojnë mua po të  
16 ndalova ty.

17 PË. Po i flisja Trupit Gjykses. Por thelbi i kësaj pune ishte  
18 të fokusoheshin te forcat serbe dhe jugosllave, por menduam se  
19 është e rëndësishme për mbrojtjen civile të vinim në dukje  
20 rastet që ne i konsideronim të besueshme. Kemi thënë çfarë  
21 dinim për këto raste dhe kemi dhënë burimet, qoftë kjo  
22 Humanitarian Law Centre. Këtë e bëmë që ta bënim të qartë që  
23 detyrimet janë për të gjitha palët.

24 PY. Po, kjo ishte e qartë. Ky Trup Gjykses nuk i ndalon  
25 provat dytësore. Por ama ka një dallim mes provave dytësore

1 primare dhe provave dytësore të shumta. Dhe ju si advokues apo  
2 avokat i gjykimit të drejtë e njihni dallimit dhe ju e pranoni  
3 se kështu jeni se ju promovoni gjykime të drejta. Dhe ju e  
4 kuptoni që një nga garancitë për gjykim të drejtë është  
5 mundësia për të ekzaminuar besueshmërinë e burimit fillestar.  
6 A e pranoni këtë?

7 PË. Mendoj se çdo Trup Gjykues do të vlerësojë dëshmitarët  
8 dhe duhet të ekzistojnë procese ligjore të cilat e mundësojnë  
9 këtë.

10 PY. Dhe dëshmitari në këtë rast është personi që dha dëshminë  
11 i pari apo kush?

12 PË. Po mund të flasë organizata vetë për metodologjinë dhe  
13 për informacionet dhe mbase ata mund të kenë një politikë  
14 tjetër dhe të mund të ndajnë shënimet e tyre, unë nuk mund të  
15 flas në emër të Humanitarian Law Centre apo për vetë  
16 individët, sepse sigurisht që duhet gjetur kush është burimi  
17 fillestar dhe duhet t'i afrohem sa më shumë burimit  
18 fillestar.

19 PY. Ndonjë gjykim të drejtë po. Ju thoni që Human Rights  
20 Watch promovon gjykime të drejta.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Kundërshtoj.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbaroi dita  
23 për sot. Jemi në fund të ditës për sot. Ju lutem rifillojeni  
24 këtë nesër.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do ta lë, por kam edhe një pyetje



1 të fundit. Pra ju me përgjigjen tuaj po thoni që personi që  
2 duhet të ishte ardhur për të dëshmuar për këtë duhet të kishte  
3 qenë Natasha edhe dikush tjetër nga Human Rights Centre, dhe  
4 jo ti, këtë po thoni?

5 PË. Unë nuk po thoja që është personi i duhur apo është  
6 personi i gabuar. Unë dhe mendoj se edhe unë kam diçka për të  
7 dhënë, por nëse persona të tjerë mund të thirren për të dhënë  
8 dëshmi, sigurisht çfarëdo që të mund të hedhë dritë mbi fakte,  
9 do të shërbente.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Abrahams,  
11 përfunduar për sot. Do ju shoqërojë Asistentja jashtë sallës  
12 së gjyqit. Do të rifillojmë nesër në orën 9.00 dhe do të  
13 vazhdojmë me dëshminë tuaj.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
16 Na tregoni pak për dëshmitarët e javës tjetër, Prokuroria?

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Më fal, duhet ta kisha pasur  
18 informacionin. Nuk e kam aktualisht. Më duhet të pyes kolegët  
19 tani, prandaj ju lutem më jepni një çast.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj se kemi dëshmitarin 3827, që  
21 do të shfaqet me videolidhje, ndërsa dëshmitarët e tjerë mund  
22 t'jua japim nesër në qoftë se është e mundur. Vetëm këtë kemi  
23 për sot.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis,  
25 kishit diçka për të shtuar?

1           Z. ELLIS: [Përkthim] Unë thjesht doja t'ju thoja sa kohë  
2 do më nevojitet. Besoj do më nevojiten -- kisha kërkuar tre  
3 orë për këtë dëshmitar, nuk ka të ngjarë që ta përdor kohën.  
4 Besoj do të më nevojitet vetëm një orë.

5           Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë, besoj se maksimumi një  
6 orë do më nevojitet mua me këtë dëshmitar.

7           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8           Z. EMMERSON: [Përkthim] Besoj se unë kisha kërkuar tri  
9 orë, besoj se nesër do mbaroj para se të bëjmë pushimin e  
10 parë.

11          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12          Faleminderit të gjithëve për sot. Seanca mbyllet deri në  
13 nesër në orën 9.00.

14                         --- Seanca mbyllet në orën 16.05

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25